International Partnerships Austria

Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

# Me çfarë kostoje?

## Vlerësimi i kostos së shërbimeve të specializuara për trajtimin e dhunës me bazë gjinore në Shqipëri

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2026
©Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Autore: Elona Gjika, Mirela Arqimandriti dhe Rudina Rama
Redaktimi: Nicole Farnsworth

Shtypur me teknologji miqësore ndaj mjedisit nga:

Dizajni grafik: Jolin Matraku

Ky botim u realizua me mbështetjen financiare të Agjencisë Austriake për Zhvillim. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autoreve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Agjencisë Austriake për Zhvillim.

## Tabela e përmbajtjes


**MIRËNJOHJE ..... 5**
**SHKURTIME ..... 6**
**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE ..... 8**
**HYRJE ..... 10**

CFARË PËRMBAN KY RAPORT? ..... 18

**KAPITULLI 1. ANALIZA LIGJORE ..... 19**

STANDARDET NDËRKOMBËTARE ME NDIKIM NË FINANCIMIN E SHËRBIMEVE ..... 19

*Konventa e Stambollit ..... 19*
*Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave ..... 20*
*Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës ..... 21*
*Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ..... 22*
*Karta Sociale Evropiane e Rishikuar ..... 22*
*Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ..... 23*
*Konventa nr. 190 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për dhunën dhe ngacmimin ..... 23*

KUADRI LIGJOR SHQIPTAR DHE DETYRIMET FINANCIARE PËR SHËRBIMET NDAJ VIKTIMAVE TË DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE ..... 24

*Ligji nr. 64/2025 "Për barazinë gjinore" ..... 25*
*Ligji nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje" ..... 27*
*Ligjet sektoriale me ndikim të drejtpërdrejtë financiar ..... 32*
*Strategjitë kombëtare dhe financimi i masave kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje ..... 36*
*Detyrimet ligjore për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në financimin e masave kundër dhunës me bazë gjinore ..... 43*
*Angazhimet buxhetore afatmesme për adresimin e dhunës me bazë gjinore ..... 51*
*Ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor: Mundësitë për të ndikuar në procesin buxhetor ..... 49*

**KAPITULLI 2. NË PËRMBLEDHJE: KOSTOT E SHËRBIMEVE TË SPECIALIZUARA PËR TRAJTIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE ..... 51**

LINJA E KËSHILLIMIT PËR GRA E VAJZA ..... 57
QENDRA E KRIZËS PËR VIKTIMAT E PËRDHUNIMIT DHE QENDRA E REFERIMIT ..... 66

**STREHËZAT ..... 73**

GRUAJA TE GRUAJA ( STREHËZ EMERGJENTE) ..... 74
QENDRA VATRA (STREHËZ AFATGJATË) ..... 81
QENDRA "TË NDRYSHËM & TË BARABARTË" (STREHËZ AFATGJATË) ..... 90
QENDRA KOMBËTARE PËR TRAJTIMIN E VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE NË KAMËZ ..... 100
KOSTOT E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË SPECIALIZUARA SIPAS KËRKESAVE TË KONVENTËS SË STAMBOLLIT 2026–2028 ..... 108
REKOMANDIME ..... 111
PËRFUNDIME ..... 114
ANNEX 1. LIST OF RESEARCH PARTICIPANTS ..... 119


## Lista e tabelave


Tabela 1. Koherenca dhe plotësueshmëria ndërmjet strategjive ..... 41
Tabela 2. Vlerësimi i konsoliduar ..... 41

Tabela 3. Vlerësim i përgjithshëm....48
Tabela 4. Alokimet për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në PBA....52
Tabela 5. Shpenzimet për dy shërbime të lidhura me DhBGj-në, të financuara nga Shërbimi Social Shtetëror....54
Tabela 6. Shpenzimet e lidhura me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, të financuara nëpërmjet Fondit Social....55
Tabela 8. Vlerësimet buxhetore të Linjës së Këshillimit për periudhën 2026–2028, në lekë....61
Tabela 9. Kostot shtesë të vlerësuara për Linjën e Këshillimit për vitin 2026....64
Tabela 10. Buxheti i vlerësuar për Linjën e Këshillimit, duke përfshirë kostot shtesë të nevojshme për periudhën 2026–2028, në lekë....65
Tabela 11. Nevojat për një Qendër Krize për Viktimat e Përdhunimit në Shqipëri....66
Tabela 12: Numri faktik dhe i parashikuar i përfitueseve....68
Tabela 13. Parashikimi i kostove shtesë për Qendrën Lilium (2026–2028)....72
Tabela 14. Vendet familjare në strehëza: nevojat kundrejt kapaciteteve ekzistuese sipas qarqeve....73
Tabela 15. Përllogaritjet buxhetore për periudhën 2025–2028, në lekë....77
Tabela 16. Kostot shtesë të parashikuara për organizatën "Gruaja te Gruaja" (2026–2028) 80
Tabela 17. Buxheti i vlerësuar për Qendrën "Gruaja tek Gruaja", duke përfshirë kostot shtesë të nevojshme për periudhën 2026–2028, në lekë....81
Tabela 18. Struktura vjetore e kostove të strehëzës sipas zërave buxhetorë (2022–2025, në lekë)....84
Tabela 19. Përllogaritjet buxhetore në lekë....86
Tabela 20. Kostot shtesë të parashikuara për Qendrën Vatra (2026–2028)....88
Tabela 21. Buxheti i parashikuar për Qendrën Vatra, duke përfshirë kostot shtesë të nevojshme (2026–2028), në lekë....89
Tabela 22. Numri faktik dhe i parashikuar i përfitueseve....91
Tabela 23. Shpenzimet faktike në lekë....92
Tabela 24. Parashikimi bazë i shpenzimeve për Qendrën "Të Ndryshëm & Të Barabartë" (2026–2028), në lekë....93
Tabela 25. Kostot shtesë të parashikuara për organizatën "Të Ndryshëm & Të Barabartë" (2026–2028)....98
Tabela 26. Parashikimi i buxhetit për periudhën 2026–2028, duke përfshirë kostot shtesë, në lekë....99
Tabela 27. Shpenzimet e QKTVDHF-së për vitet 2022–2024 në lekë....104
Tabela 28. Buxheti i parashikuar i QKTVDHF-së për vitet 2026–2028 në lekë....105
Tabela 29. Kostot shtesë të parashikuara për QKTVDHF-në 2026–2028 në lekë....106
Tabela 30. Parashikimi i buxhetit me kostot shtesë në lekë....107
Tabela 31. Buxheti i përgjithshëm i parashikuar për ofruesit e studiuar në milionë lekë....109
Tabela 32. Nevojat rajonale për kapacitet strehimi sipas standardit orientues....111

# MIRËNJOHJE

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC) falënderon përfaqësuesit e institucioneve publike dhe organizatave që morën pjesë në këtë studim, duke vënë në dispozicion kohën, informacionin dhe përvojën e tyre. GADC falënderon gjithashtu Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për bashkëpunimin dhe informacionin e ofruar gjatë procesit kërkimor.

Studimi u realizua nga ekipi kërkimor i GADC-së, me Elona Gjikën dhe Rudina Ramën si autoret kryesore të raportit. Mirela Arqimandriti kontribuoi në hartimin, rishikimin dhe përditësimin e kuadrit ligjor, institucional dhe buxhetor, si dhe në finalizimin e raportit. Esmeralda Hoxha ofroi mbështetje gjatë procesit të intervistave.

Nicole Farnsworth, nga Rrjeti i Grave të Kosovës, ishte drejtuesja e hulumtimit e studimit rajonal për Ballkanin Perëndimor dhe kontribuoi në hartimin dhe zbatimin e metodologjisë, sigurimin e cilësisë, rishikimin përmbajtësor dhe redaktimin gjuhësor të versionit në anglisht. Autoret falënderojnë recensuesit për komentet dhe rekomandimet e dhëna gjatë procesit të rishikimit të raportit.

Ky studim u realizua me mbështetjen financiare të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA). Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autoreve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e ADA-s.

# SHKURTIME

| | |
|---|---|
| AFMIS | Sistemi Shqiptar i Informacionit për Menaxhimin Financiar |
| AK | Analistët e kërkimit |
| AKPA | Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive |
| ALMP | Programet aktive të tregut të punës |
| AWEN | Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BP | Ballkani Perëndimor |
| BPGj | Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor |
| BPPM | Monitorimi i portofolit të projekteve buxhetore |
| Capex | Shpenzimet kapitale |
| CEDAW | Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave |
| DhBGj | Dhuna me bazë gjinore |
| FS | Fondi Social |
| GREVIO | Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje |
| INSTAT | Instituti i Statistikave |
| ISHP | Instituti i Shëndetit Publik |
| KDF | Konventa për të Drejtat e Fëmijës |
| KI | Konventa e Stambollit – Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje |
| KMD | Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi |
| KPI | Treguesit kryesorë të performances |
| LGBTQ+ | Persona lezbike, gej, biseksualë, transgjinorë, queer/në eksplorim të identitetit dhe persona me identitete të tjera |
| MF | Ministria e Financave |
| MKR | Mekanizmi i Koordinuar i Referimit |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| N/A | Nuk ka të dhëna / Nuk disponohet |
| NJBGJ | Nëpunës/e i/e barazisë gjinore |
| NJVV | Njësi e vetëqeverisjes vendore |
| Nr. | Numër |
| O&M | Funksionimi dhe mirëmbajtja |
| OBSH | Organizata Botërore e Shëndetësisë |
| OJF | Organizatë jofitimprurëse |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| OSHCG | Organizatë e shoqërisë civile për të drejtat e grave |
| OZHQ | Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm |
| PBA | Programi Buxhetor Afatmesëm |
| PNUD | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim |
| PSO | Procedurat Standarde të Veprimit |

| | |
|---|---|
| QKTVDF | Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje |
| QSUT | Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" |
| REVALB | Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Shqipëri |
| RRGK | Rrjeti i Grave të Kosovës |
| RVK | Raporti Vullnetar Kombëtar |
| SHSSH | Shërbimi Social Shtetëror |
| TIK | Teknologjia e informacionit dhe komunikimit |
| UM | Urdhër Mbrojtjeje |
| UMM | Urdhër i Menjëhershëm i Mbrojtjes |
| UMPMM | Urdhër për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme |
| UNFPA | Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë |
| UNICEF | Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët |
| UN OHCHR | Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky studim shqyrton financimin dhe kostot e shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore në Shqipëri. Ai vlerëson kuadrin ligjor, strategjitë kombëtare, buxhetimin dhe shpenzimet publike, si dhe burimet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve në përputhje me Konventën e Stambollit dhe nevojat e të mbijetuarave.

Studimi u krye në kuadër të një ndërhyrjeje rajonale në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Analiza për Shqipërinë përfshiu gjashtë ofrues shërbimesh: Linjën Kombëtare të Këshillimit për Gra dhe Vajza, Qendrën LILIUM, strehëzën "Gruaja te Gruaja", Qendrën "Vatra", Qendrën "Të Ndryshëm & Të Barabartë" dhe Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje në Kamëz. Metodologjia ndërthur analizën ligjore, institucionale dhe buxhetore me përllogaritjen e kostove për njësi dhe të dhënat e marra nga institucionet dhe ofruesit e shërbimeve. Kostot u shqyrtuan sipas kategorive: personel, funksionim, administrim, infrastrukturë, pajisje dhe mbështetje e drejtpërdrejtë për përfitueset.

Gjetjet tregojnë se Shqipëria ka një kuadër të gjerë ligjor dhe strategjik, të forcuar nga ligji nr. 64/2025 "Për barazinë gjinore" dhe ligji nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje". Megjithatë, financimi ende nuk i pasqyron plotësisht detyrimet ligjore. Fondet shpërndahen në disa programe dhe mekanizma, pa zëra buxhetorë të dedikuar dhe të qëndrueshëm për të gjitha shërbimet. Për rrjedhojë, shpesh nuk është e mundur të përcaktohet qartë sa fonde janë planifikuar, miratuar, disbursuar dhe shpenzuar për secilin shërbim. Financimi përmes projekteve të donatorëve dhe mbështetja e pjesshme nga bashkitë e bëjnë më pak të parashikueshëm ofrimin e shërbimeve.

Analiza identifikon gjithashtu mungesa në personel dhe mangësi në ofrimin e plotë të shërbimeve 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, si dhe financim të pamjaftueshëm për riintegrimin, shërbimet për fëmijët, supervizimin profesional të stafit, sigurinë, aksesueshmërinë dhe kujdesin e specializuar shëndetësor e ndihmën juridike. Kapaciteti i strehëzave vlerësohet të jetë ndjeshëm nën standardin orientues prej një vendi familjar për çdo 10 000 banorë. Studimi i referohet një nevoje të përafërt për 240 vende familjare dhe një kapaciteti të vlerësuar prej 80–90 vendesh; për këtë arsye, mungesa e përllogaritur duhet të verifikohet kundrejt të dhënave më të fundit dhe inventarit kombëtar të kapaciteteve.

Për periudhën 2026–2028, përllogaritjet për gjashtë ofruesit paraqesin nevoja të përgjithshme orientuese prej rreth 219,4 milionë lekësh në vitin 2026, 219,6 milionë lekësh në vitin 2027 dhe 226 milionë lekësh në vitin 2028. Këto shuma përfshijnë kostot bazë dhe kostot shtesë të identifikuara, por nuk përbëjnë një vlerësim të plotë në nivel kombëtar.

Vlerësimi për Qendrën LILIUM është i pjesshëm, pasi kostot e saj të funksionimit janë të integruara në buxhetin e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe nuk mund të veçohen. Gjithashtu, strehëzat bashkiake nuk u përfshinë në analizën e kostove për shkak të mungesës së të dhënave financiare të ndara dhe të verifikueshme. Për këtë arsye, përllogaritjet duhet të interpretohen si orientuese dhe jo si fonde të miratuara apo si kosto të plota për të gjithë vendin.

Studimi rekomandon që institucionet përgjegjëse:

- të krijojnë zëra buxhetorë të dedikuar dhe të zbatojnë metoda të standardizuara për përllogaritjen e kostove të shërbimeve;
- të sigurojnë financim publik të parashikueshëm dhe shumëvjeçar, përfshirë kontraktimin e qëndrueshëm të ofruesve jofitimprurës;
- të përcaktojnë qartë ndarjen e përgjegjësive financiare ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore dhe të zgjerojnë kapacitetet e strehëzave;

- të forcojnë ekipet shumëdisiplinore, shërbimet 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, supervizimin profesional dhe trajnimin e vazhdueshëm;
- të financojnë shërbimet e riintegrimit, mbështetjen për fëmijët, aksesueshmërinë dhe shërbimet e specializuara shëndetësore e juridike;
- të përmirësojnë të dhënat dhe gjurmimin e shpenzimeve në REVALB, si dhe raportimin mbi mbulimin, cilësinë dhe rezultatet e shërbimeve.

Në përfundim, studimi identifikon një hendek ndërmjet detyrimeve ligjore të Shqipërisë dhe financimit aktual të shërbimeve. Mbyllja e këtij hendeku kërkon kalimin nga financimi i fragmentuar dhe afatshkurtër drejt një sistemi publik të bashkërenduar dhe të mbështetur në të dhëna, në mënyrë që të mbijetuarat të kenë akses në mbështetje të sigurt, cilësore dhe të vazhdueshme, pavarësisht vendbanimit apo rrethanave të tyre.

# HYRJE

Dhuna me bazë gjinore përbën një shkelje të të drejtave të njeriut dhe një pengesë serioze për arritjen e barazisë gjinore.[1] Parandalimi i saj dhe garantimi i mbrojtjes, rehabilitimit dhe riintegrimit të të mbijetuarave kërkojnë më shumë se angazhime ligjore dhe politika të miratuara: kërkojnë institucione funksionale, shërbime të aksesueshme dhe cilësore, personel të kualifikuar, si dhe financim publik të mjaftueshëm, të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm.[2]

Të gjitha qeveritë e Ballkanit Perëndimor janë angazhuar për zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftëm kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, e njohur si Konventa e Stambollit. Konventa u kërkon shteteve të ndërtojnë një përgjigje të integruar ndaj të gjitha formave të dhunës ndaj grave, të mbështetur në parandalim, mbrojtje, ndjekje penale dhe politika të koordinuara. Ajo kërkon gjithashtu sigurimin e burimeve të përshtatshme financiare dhe njerëzore, me qëllim që shërbimet të jenë të disponueshme, të aksesueshme dhe të organizuara sipas nevojave dhe të drejtave të të mbijetuarave.[3]

Megjithatë, ndërmjet angazhimeve ligjore dhe zbatimit të tyre në praktikë vazhdon të ekzistojë një hendek i konsiderueshëm. Në vendet e Ballkanit Perëndimor, shërbimet për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore shpesh përballen me kapacitete të kufizuara institucionale, mbulim të pabarabartë territorial dhe financim publik të pamjaftueshëm ose të paqëndrueshëm. Në shumë raste, buxhetet publike nuk e bëjnë të mundur identifikimin e qartë të fondeve të planifikuara, të alokuara dhe të shpenzuara për shërbimet e specializuara. Kjo e vështirëson vlerësimin nëse burimet ekzistuese u përgjigjen nevojave reale dhe standardeve të përcaktuara nga Konventa e Stambollit.[4]

Organizatat e shoqërisë civile të grave luajnë një rol të rëndësishëm në plotësimin e këtyre boshllëqeve. Ato ofrojnë shërbime të specializuara dhe me bazë në komunitet, si strehim të sigurt, këshillim psikologjik e juridik, mbështetje psikosociale, asistencë gjatë procedurave institucionale dhe programe rehabilitimi e riintegrimi. Megjithatë, shumë prej këtyre organizatave mbështeten në financim afatshkurtër dhe të orientuar nga projektet. Mungesa e mekanizmave të qëndrueshëm të financimit publik kufizon vazhdimësinë e shërbimeve dhe mund të rrezikojë aksesin në kohë dhe cilësor të të mbijetuarave në mbështetjen që u nevojitet.

Për t'iu përgjigjur kësaj situate, një rrjet rajonal i përbërë nga shtatë organizata të shoqërisë civile të grave po zbaton ndërhyrjen "Institucionalizimi i shërbimeve cilësore të rehabilitimit dhe riintegrimit për të mbijetuarat e dhunës II", me mbështetjen financiare të Agjencisë Austriake për Zhvillim[5]. Ndërhyrja synon forcimin dhe institucionalizimin e shërbimeve cilësore të rehabilitimit dhe riintegrimit për të mbijetuarat e dhunës me bazë

[1] Council of Europe (2011), Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence, CETS No. 210, Articles 8, 20–25.

[2] Council of Europe (2011). Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence, CETS No. 210. Relevant provisions: Articles 3, 7–11, 15, 18, 20 and 22–26. https://rm.coe.int/168008482e

[3] Ibid. Ibid. Articles 7–9 and 18–25;

[4] paragraphs 21–27 and 102–113; 4

[5] Partnerët përfshijnë Qendrën Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC) dhe Rrjetin e Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN), Rrjetin e Grave të Kosovës, Fondacionin "Gratë e Bashkuara" në Bosnjë dhe Hercegovinë, Rrjetin Kombëtar kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje në Maqedoninë e Veriut, Qendrën për të Drejtat e Grave në Mal të Zi dhe Qendrën Autonome të Grave në Serbi.

gjinore, duke përdorur buxhetimin e përgjigjshëm gjinor si instrument për vlerësimin e nevojave, përllogaritjen e kostove reale dhe orientimin e fondeve publike.[67]

Në kuadër të kësaj ndërhyrjeje, studimi u realizua në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor dhe shqyrtoi financimin publik të shërbimeve të specializuara për parandalimin dhe trajtimin e dhunës me bazë gjinore gjatë periudhës 2023–2025. Analiza përfshin gjithashtu kontributin e organizatave të shoqërisë civile të grave dhe kostot që ato mbulojnë për ofrimin e shërbimeve. Studimi krahason fondet e planifikuara dhe të miratuara me shpenzimet faktike, si dhe shqyrton angazhimet e parashikuara financiare për periudhën 2025–2028.[8]

Qëllimi kryesor i studimit është të vlerësojë koston reale të shërbimeve të specializuara, nëse ato do të ofroheshin në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit dhe me nevojat e të mbijetuarave. Në këtë mënyrë, studimi synon të ndihmojë institucionet përgjegjëse që t'i përkthejnë detyrimet ligjore dhe të politikave në produkte konkrete buxhetore, tregues të matshëm dhe alokime financiare të mjaftueshme.

Gjetjet synojnë të mbështesin planifikimin buxhetor vjetor dhe afatmesëm, duke ofruar informacion mbi burimet e nevojshme për sigurimin e shërbimeve cilësore, të aksesueshme dhe të qëndrueshme. Studimi synon gjithashtu të kontribuojë në një ndarje më të qartë të përgjegjësive financiare ndërmjet institucioneve qendrore, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ofruesve të shërbimeve.

Përtej vlerësimit të financimit ekzistues, studimi propozon metodologji dhe modele standarde kostimi që mund të përdoren nga institucionet në ciklet e ardhshme buxhetore. Integrimi i këtyre instrumenteve në proceset e rregullta të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit mund të përmirësojë gjurmueshmërinë e shpenzimeve, të forcojë llogaridhënien dhe të mbështesë kalimin nga financimi i fragmentuar e afatshkurtër drejt financimit publik të qëndrueshëm të shërbimeve.

Në thelb, ky studim mbështetet në parimin se shërbimet për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore nuk duhet të varen nga financime të rastësishme. Ato janë pjesë e detyrimeve të shtetit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe duhet të planifikohen, kostohen, financohen dhe monitorohen si shërbime publike thelbësore.

## Rreth këtij studimi: metodologjia e shkurtuar

Metodologjia e këtij studimi mbështetet në parimet dhe praktikat e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor (BPGj), në udhëzuesit ekzistues për kostimin e shërbimeve sociale dhe të specializuara, si dhe në metodologjinë e zhvilluar nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) për përllogaritjen e

---

[6] Austrian Development Agency (n.d.). Institutionalizing Quality Rehabilitation and Reintegration Services for Violence Survivors II. Project description, objectives and partner organisations; implementation period 1 July 2024–30 September 2027. https://www.entwicklung.at/en/projects/detail-en/institutionalizing-quality-rehabilitation-and-reintegration-services-for-violence-survivors-ii

[7] Austrian Development Agency (n.d.). Institutionalizing Quality Rehabilitation and Reintegration Services for Violence Survivors II. Project description, objectives and partner organisations; implementation period 1 July 2024–30 September 2027. https://www.entwicklung.at/en/projects/detail-en/institutionalizing-quality-rehabilitation-and-reintegration-services-for-violence-survivors-ii

[7] Kosovo Women's Network (n.d.). WCSOs Ask: What's the Real Cost of Specialised Services for Gender-based Violence? Public description of the regional research, its scope, research questions and methodology. This page itself uses both 2023–2025 and 2022–2024; the research protocol must resolve the study's final reference period. https://womensnetwork.org/wcsos-ask-whats-the-real-cost-of-specialised-services-for-gender-based-violence/

[8] Kosovo Women's Network (n.d.). WCSOs Ask: What's the Real Cost of Specialised Services for Gender-based Violence? Public description of the regional research, its scope, research questions and methodology. This page itself uses both 2023–2025 and 2022–2024; the research protocol must resolve the study's final reference period. https://womensnetwork.org/wcsos-ask-whats-the-real-cost-of-specialised-services-for-gender-based-violence/

kostove të shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore[9]. Kjo metodologji është përshtatur me kuadrin ligjor, institucional dhe buxhetor të secilit vend të përfshirë në studim.

Studimet e mëparshme mbi përllogaritjen e kostove të shërbimeve në Shqipëri ofrojnë një pikë të dobishme krahasimi. Studimi i marsit 2025, *Sa kushton mbrojtja?*,[10] i përgatitur nga Rrjeti i Grave të Kosovës me kërkesë të Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN), përllogariti kostot e shërbimeve ekzistuese të ofruara nga organizatat anëtare të AWEN. Studimi aktual shqyrton gjashtë ofrues të përzgjedhur publikë dhe joqeveritarë dhe përfshin shpenzimet bazë të parashikuara, si dhe burimet shtesë të nevojshme për të adresuar mangësitë e identifikuara në ofrimin e shërbimeve. Për shkak të dallimeve në ofruesit e përfshirë, gamën e shërbimeve dhe supozimet e përdorura për përllogaritjen e kostove, vlerësimet e dy studimeve duhet të interpretohen si të dhëna plotësuese dhe shumat e tyre nuk duhet të mblidhen drejtpërdrejt.

Studimi përdori kryesisht qasjen e kostimit për njësi shërbimi. Nëpërmjet kësaj qasjeje u identifikuan dhe u përllogaritën burimet që u nevojiten institucioneve publike dhe ofruesve të tjerë për të ofruar shërbime të specializuara në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit. Analiza mori në konsideratë kostot e personelit, funksionimit, administrimit, infrastrukturës, pajisjeve dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë për përfitueset, sipas natyrës së secilit shërbim.

Qëllimi nuk ishte vetëm evidentimi i shpenzimeve ekzistuese, por edhe vlerësimi i burimeve që do të nevojiteshin për garantimin e një shërbimi cilësor, të aksesueshëm, të vazhdueshëm dhe të orientuar drejt nevojave e të drejtave të të mbijetuarave. Për këtë arsye, kostot faktike u shqyrtuan krahas standardeve të kërkuara, çmimeve të tregut, kapaciteteve të ofruesve dhe nivelit të pritshëm të mbulimit.

## Fusha dhe kufijtë e analizës

Analiza u përqendrua te shërbimet e specializuara të përzgjedhura për mbështetjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e të mbijetuarave të DhBGj-së. Ajo nuk përfshiu kostot e përgjithshme që lidhen me veprimtarinë e policisë, prokurorisë, gjykatave, sistemit penitenciar apo institucioneve të punësimit. Përllogaritja e plotë e këtyre kostove do të kërkonte një studim më të gjerë, metodologji të posaçme sektoriale dhe të dhëna të hollësishme administrative.

Gjithashtu, studimi nuk përllogariti kostot e shërbimeve të përgjithshme, si kujdesi shëndetësor, arsimi, ndërmjetësimi për punësim dhe formimi profesional, kur ato ofrohen jashtë strukturave të ofruesve të shërbimeve të specializuara. Megjithatë, kur shërbime të tilla ofroheshin drejtpërdrejt nga një strehëz ose nga një ofrues i specializuar dhe përbënin pjesë të paketës së mbështetjes, kostot përkatëse u përfshinë në analizë.

Për rrjedhojë, rezultatet e studimit nuk përfaqësojnë koston e përgjithshme ekonomike dhe shoqërore të DhBGj-së. Ato paraqesin kostot e vlerësuara për ofrimin e shërbimeve të specializuara të përfshira në fushën e kësaj analize.

## Pyetjet kërkimore

Studimi u udhëhoq nga dy pyetje kryesore:

1. Në çfarë mase qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë planifikuar, alokuar dhe shpenzuar fonde të mjaftueshme gjatë periudhës 2022–2024 për ofrimin e shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat e DhBGj-së, në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit? Në çfarë mase dokumentet buxhetore afatmesme

[9] KWN, *At What Cost?* 2012

[10] Nicole Farnsworth dhe Eleta Shala, *Sa kushton mbrojtja? Përllogaritja e kostove të shërbimeve të ofruara nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) për adresimin e dhunës me bazë gjinore në Shqipëri* (Rrjeti i Grave të Kosovës, me kërkesë të AWEN, mars 2025), f. 20–23.

parashikojnë financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për këto shërbime gjatë periudhës 2025–2028?

2. Cilat janë kostot e vlerësuara për ofrimin e shërbimeve të specializuara në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit gjatë periudhës 2026–2028, duke përfshirë financimin e organizatave të shoqërisë civile të grave që ofrojnë shërbime të tilla?

Në analizë u bë dallim ndërmjet fondeve të kërkuara, fondeve të planifikuara në dokumentet afatmesme, alokimeve të miratuara, fondeve të disbursuara dhe shpenzimeve faktike. Ky dallim është i rëndësishëm, pasi përfshirja e një shume në një dokument planifikimi nuk do të thotë domosdoshmërisht se ajo është miratuar, disbursuar ose shpenzuar.

**Metodat e kërkimit dhe burimet e të dhënave**

Për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore, studimi përdori një qasje të kombinuar, duke ndërthurur analizën e dokumentave të disponueshëm, analizën ligjore, institucionale dhe buxhetore me kostimin për njësi dhe informacionin e mbledhur drejtpërdrejt nga institucionet dhe ofruesit e shërbimeve.

**Analiza ligjore dhe e politikave**

Analiza ligjore shqyrtoi instrumentet ndërkombëtare, legjislacionin kombëtar, aktet nënligjore, strategjitë dhe planet e veprimit që përcaktojnë detyrimet për parandalimin dhe trajtimin e DhBGj-së dhe për ofrimin e shërbimeve të specializuara.

Vëmendje e posaçme iu kushtua:

- detyrimeve për sigurimin dhe financimin e shërbimeve;
- ndarjes së përgjegjësive ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore;
- standardeve minimale të ofrimit të shërbimeve;
- kërkesave për personel, infrastrukturë dhe funksionim;
- përfshirjes së BPGj-së në planifikimin dhe monitorimin buxhetor;
- përputhshmërisë së kuadrit kombëtar me Konventën e Stambollit.

Analiza synoi të identifikonte jo vetëm boshllëqet ligjore, por edhe mospërputhjet ndërmjet detyrimeve të përcaktuara në ligj, standardeve të shërbimeve dhe burimeve financiare të parashikuara për zbatimin e tyre.

**Analiza institucionale**

Analiza institucionale evidentoi institucionet përgjegjëse për planifikimin, financimin, koordinimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve të specializuara. Ajo shqyrtoi rolet e ministrive, institucioneve të varësisë, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe organizatave të shoqërisë civile të grave.

Të dhënat u mblodhën nga:

- faqet zyrtare dhe dokumentet e institucioneve;
- raportet administrative dhe monitoruese;
- dokumentet strategjike dhe buxhetore;
- literatura dhe studimet ekzistuese;
- kërkesat zyrtare për informacion;
- intervistat me përfaqësues të institucioneve dhe ofruesve të shërbimeve.

Kjo analizë shërbeu për të kuptuar mënyrën se si ndahen përgjegjësitë në praktikë, si qarkullon financimi dhe cilat institucione mbulojnë kostot e secilit shërbim.

**Analiza buxhetore**

Analiza buxhetore shqyrtoi financimin e planifikuar, të miratuar dhe të shpenzuar për shërbimet e specializuara gjatë periudhës së analizuar. Ajo vlerësoi nëse buxhetet publike përmbanin zëra, produkte ose programe të identifikueshme për DhBGj-në dhe nëse

informacioni i disponueshëm mundësonte gjurmimin e fondeve deri te shërbimi dhe përfitueset.
Analiza përfshiu, sa herë që të dhënat ishin të disponueshme:

- kërkesat dhe parashikimet buxhetore;
- alokimet e miratuara;
- disbursimet dhe transfertat;
- shpenzimet faktike;
- burimin e financimit;
- numrin e përfitueseve;
- kostot për njësi ose për përfituese;
- nivelin e realizimit të buxhetit;
- treguesit e performancës dhe rezultatet e raportuara.

Burimet përfshinë ligjet vjetore të buxhetit, Programet Buxhetore Afatmesme, raportet e zbatimit të buxhetit, të dhënat e thesarit, raportet e auditimit, informacionin e ofruar nga institucionet dhe dokumentacionin financiar të ofruesve të shërbimeve.

Kur shërbimet për DhBGj-në financoheshin brenda programeve më të gjera dhe nuk ekzistonte një zë i veçantë buxhetor, analiza evidentoi kufizimet në gjurmueshmërinë e fondeve. Në mungesë të të dhënave të plota, nuk u supozua se i gjithë buxheti i programit përkatës përfaqësonte financim për DhBGj-në.

**Analiza e kostimit**
Analiza e kostimit zbatoi parimet e BPGj-së dhe metodën e kostimit për njësi për të vlerësuar burimet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të specializuara sipas standardeve të Konventës së Stambollit.
Përllogaritja mori në konsideratë, sipas llojit të shërbimit:

- numrin dhe profilin e personelit;
- pagat, kontributet dhe kostot e zhvillimit profesional;
- kohën e punës dhe kërkesat për funksionim 24 orë në ditë;
- shpenzimet e ambienteve, mirëmbajtjes dhe shërbimeve utilitare;
- sigurinë, aksesueshmërinë dhe konfidencialitetin;
- ushqimin, veshmbathjen dhe nevojat bazë;
- mbështetjen psikologjike, psikosociale dhe juridike;
- kujdesin për fëmijët;
- transportin dhe mbështetjen emergjente;
- menaxhimin e rasteve, dokumentimin dhe raportimin;
- rehabilitimin dhe riintegrimin;
- kostot administrative dhe operative.

Për vlerësimin e këtyre kostove u përdorën të dhënat mbi shpenzimet ekzistuese, çmimet e tregut, kostot historike, standardet ligjore dhe profesionale, si dhe informacioni i siguruar nëpërmjet intervistave me institucionet dhe ofruesit. Kur informacioni nuk ishte i plotë, u përdorën supozime të arsyetuara dhe të dokumentuara.

Rezultatet e kostimit synojnë të mbështesin hartimin e parashikimeve buxhetore për periudhën 2026–2028. Ato nuk duhet të interpretohen si alokime të miratuara, por si vlerësime të nevojave financiare për ofrimin e shërbimeve në përputhje me standardet e kërkuara.

**Përzgjedhja e kampionit**

**Pasqyra e përgjithshme e popullatës përfituese të shërbimeve**

Studimi u përqendrua në shërbimet e specializuara për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore (DhBGj), siç përcaktohen nga Konventa e Stambollit, përkatësisht shërbimet e qendrave të krizës për rastet e përdhunimit, strehëzat emergjente dhe qendrat rezidenciale afatgjata të përkujdesjes shoqërore.

Megjithëse Konventa e Stambollit i përcakton edhe linjat kombëtare SOS si një shërbim thelbësor të mbështetjes së specializuar, ato nuk u përfshinë në objektin e këtij studimi, pasi metodologjia e përllogaritjes së kostove ishte hartuar për të vlerësuar kostot e shërbimeve të ofruara në struktura rezidenciale, të cilat sigurojnë drejtpërdrejt strehim, rehabilitim dhe mbështetje për riintegrim. Shërbimet e linjave telefonike funksionojnë sipas një modeli ofrimi dhe strukture financimi thelbësisht të ndryshme, ndaj kërkojnë një metodologji të veçantë për përllogaritjen e kostove.

Në Shqipëri, struktura formale e shërbimeve të specializuara përbëhet nga 13 strehëza emergjente në nivel bashkie, shtatë qendra rezidenciale afatgjata të përkujdesjes shoqërore dhe një qendër krize për rastet e përdhunimit, Qendra "Lilium". Megjithëse të dhënat administrative evidentojnë ekzistencën e 13 strehëzave emergjente në nivel bashkie, intervistat me aktorët e interesuar sugjeruan se disa prej këtyre strukturave mund të mos jenë funksionale ose, në praktikë, mund të mos ofrojnë aktualisht shërbime të specializuara. Duke qenë se kjo nuk mund të verifikohej në mënyrë të pavarur, në studim u përfshinë vetëm institucionet për të cilat mund të konfirmoheshin funksionimi dhe ofrimi i shërbimeve.

Këto shërbime të specializuara përbëjnë mekanizmat kryesorë përmes të cilëve të mbijetuarat përfitojnë mbrojtje emergjente, strehim të sigurt, mbështetje psikosociale, si dhe shërbime afatgjata rehabilitimi dhe riintegrimi.

**Strategjia e përzgjedhjes së kampionit**

Përzgjedhja e qëllimshme e kampionit u përdor për të identifikuar institucionet e afta për të siguruar të dhënat e hollësishme dhe të besueshme, të nevojshme për analizën e përllogaritjes së kostove. Ekipi kërkimor kontaktoi tri strehëza emergjente dhe katër qendra rezidenciale afatgjata të përkujdesjes shoqërore në Shqipëri.

Gjithashtu, u konsultuan Qendra "Lilium", Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (linja telefonike SOS), si dhe aktorët kryesorë institucionalë, duke përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS), Shërbimin Social Shtetëror (SHSSH), Bashkinë Tiranë[11] dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.

Njëra prej tri strehëzave emergjente dhe tri prej katër qendrave rezidenciale afatgjata dhanë përgjigje të plota, sikurse edhe Qendra "Lilium" dhe Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza. Konsultimet me aktorët e interesuar përfshinë pesë intervista me përfaqësues të institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore. Drejtoritë e Buxhetit të bashkive Tiranë dhe Elbasan u ftuan gjithashtu të merrnin pjesë, por nuk iu përgjigjën ftesës.

Strategjia e përzgjedhjes së kampionit i dha përparësi thellësisë së analizës kundrejt shtrirjes së saj, duke u përqendruar tek institucionet që ishin në gjendje të siguronin grupe të plota dhe të verifikueshme të dhënash, të cilat mund të mbështesnin përllogaritje të qëndrueshme

[11] The Municipality of Tirana was selected because it has the largest concentration and diversity of specialised GBV services in Albania and plays a leading role in financing and coordinating these services. Elbasan was also approached due to its established specialised service provision and previous engagement in national GBV response mechanisms.

të kostove. Këto të dhëna u përdorën më pas për të hartuar përllogaritje buxhetore të mbështetura në evidenca për ofrues të krahasueshëm të shërbimeve të specializuara.

**Madhësia dhe përbërja e kampionit**

Pas kërkesave të përsëritura drejtuar të gjitha institucioneve për sigurimin e të dhënave, gjashtë institucione përmbushën kriteret e përfshirjes dhe përbëjnë kampionin analitik: një qendër krize për rastet e përdhunimit (Qendra "Lilium"), Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, një strehëz emergjente afatshkurtër dhe tri qendra rezidenciale afatgjata.
Këto institucione siguruan dokumentacion të plotë financiar, informacion mbi personelin dhe ngarkesën e punës, të dhëna mbi kapacitetin dhe nivelin e shfrytëzimit të shërbimeve, si dhe profilet e përfitueseve.

**Kriteret e përfshirjes dhe kërkesat për cilësinë e të dhënave**

Institucionet u përfshinë vetëm nëse paraqitën të dhëna të plota mbi shpenzimet, struktura të hollësishme organizative dhe të personelit, informacion të saktë mbi ofrimin e shërbimeve, përfshirë kapacitetin dhe nivelin e zënies, si dhe profile të ndara sipas karakteristikave të përfitueseve. Këto kritere garantuan qëndrueshmërinë e analizës dhe krahasueshmërinë ndërmjet modeleve të ndryshme të ofrimit të shërbimeve.

**Mospërfshirja e strehëzave emergjente në nivel bashkie në analizën e kostimit**

Megjithëse në dokumentet dhe raportimet zyrtare evidentohen 13 strehëza emergjente në nivel bashkie, kostot e tyre nuk u përfshinë në analizën përfundimtare të këtij studimi. Nga intervistat e zhvilluara dhe shqyrtimi i të dhënave të transaksioneve të Thesarit për periudhën 2012–2023 rezultoi se shpenzimet për këto struktura nuk regjistrohen dhe nuk raportohen në mënyrë të veçantë.

Në shumicën e rasteve, bashkitë nuk kanë zëra buxhetorë të posaçëm për strehimin emergjent ose për shërbimet ndaj të mbijetuarave të DhBGj-së. Kostot për personelin, ambientet, ushqimin, shërbimet utilitare, sigurinë dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë për përfitueset përfshihen zakonisht brenda programeve ose kategorive më të gjera të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Për pasojë, nga dokumentacioni financiar i disponueshëm nuk ishte e mundur të veçoheshin shpenzimet që lidheshin drejtpërdrejt me funksionimin e strehëzave emergjente.

Gjithashtu, të dhënat e mbledhura nuk mundësuan verifikimin e njëtrajtshëm të statusit operacional, kapacitetit, nivelit të përdorimit dhe paketës së shërbimeve të ofruara nga të gjitha strukturat e raportuara. Prandaj, vetëm evidentimi i tyre në dokumentet zyrtare nuk ishte i mjaftueshëm për të kryer një përllogaritje të besueshme të kostos për njësi.

Në mungesë të të dhënave financiare të verifikueshme dhe të ndara sipas strehëzës, llojit të shpenzimit dhe numrit të përfitueseve, zbatimi i metodologjisë së kostimit për njësi nuk ishte i mundur. Për këtë arsye, mospërfshirja e strehëzave emergjente bashkiake përbën një kufizim metodologjik të studimit dhe nuk duhet të interpretohet si tregues se këto struktura nuk kanë kosto ose nuk marrin financim publik.

Ky boshllëk evidenton nevojën që bashkitë të krijojnë produkte ose kode buxhetore të identifikueshme për strehimin emergjent dhe të mbajnë të dhëna të standardizuara mbi alokimet, shpenzimet faktike, kapacitetin, kohëzgjatjen e qëndrimit dhe numrin e personave të mbështetur. Kjo do të mundësonte gjurmimin e financimit, krahasimin ndërmjet bashkive dhe përfshirjen e këtyre shërbimeve në analizat e ardhshme të kostimit.

**Vlefshmëria dhe kufizimet e studimit**

Vlefshmëria e studimit mbështetet në cilësinë, plotësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të siguruara nga institucionet dhe ofruesit që përmbushën kriteret e përfshirjes.

Analiza u forcua nëpërmjet triangulimit të burimeve dhe metodave, duke ndërthurur dokumentacionin ligjor, institucional dhe financiar, të dhënat kombëtare të Thesarit dhe pesë intervista me përfaqësues të institucioneve dhe aktorë të tjerë përkatës. Krahasimi i këtyre burimeve mundësoi verifikimin e informacionit, evidentimin e mospërputhjeve dhe krijimin e një panorame më të plotë të mënyrës së financimit dhe funksionimit të shërbimeve të specializuara.

Megjithatë, gjatë interpretimit të gjetjeve duhet të merren parasysh disa kufizime si më poshtë:

Së pari, megjithëse të dhënat administrative dhe raportimet zyrtare evidentojnë 13 strehëza emergjente në nivel bashkie, statusi i tyre operacional, kapaciteti, niveli i përdorimit dhe paketa e shërbimeve nuk mundën të verifikoheshin në mënyrë të njëtrajtshme për të gjitha strukturat. Gjithashtu, mungonin të dhëna financiare të ndara sipas strehëzës dhe kategorisë së shpenzimit. Për pasojë, këto struktura nuk mund të përfshiheshin në mënyrë sistematike në analizën e kostimit dhe nuk ishte i mundur krahasimi ndërmjet bashkive.

Së dyti, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, e cila ofron shërbimin telefonik SOS, mori pjesë në procesin kërkimor dhe ofroi informacion të vlefshëm për analizën e financimit dhe të ofrimit të shërbimeve. Megjithatë, ajo nuk u përfshi në të njëjtën analizë të kostimit për njësi të përdorur për shërbimet rezidenciale dhe ato që ofrohen në struktura fizike. Modeli i funksionimit të linjës, organizimi i personelit, kohëzgjatja dhe intensiteti i kontakteve, infrastruktura teknologjike dhe mënyra e financimit kërkojnë tregues dhe një metodologji të posaçme kostimi.

Së treti, jo të gjithë ofruesit e kontaktuar paraqitën tërësinë e të dhënave financiare dhe operative të nevojshme. Në disa raste mungonin të dhënat e detajuara për personelin, shpenzimet operative, numrin e përfitueseve ose shpërndarjen e kostove sipas shërbimit. Studimi nuk nxjerr përfundime dhe nuk bën hamendësime mbi arsyet e mosparaqitjes ose paplotësisë së këtyre të dhënave. Në analizën përfundimtare u përdor vetëm informacioni që mund të verifikohej dhe të krahasohej në mënyrë të arsyeshme.

Së katërti, të dhënat buxhetore publike nuk mundësojnë gjithmonë gjurmimin e financimit deri në nivelin e shërbimit. Shpenzimet për DhBGj-në përfshihen shpesh në programe më të gjera të mbrojtjes sociale, shëndetësisë, drejtësisë ose qeverisjes vendore. Mungesa e zërave ose kodeve të posaçme buxhetore kufizon mundësinë për të dalluar qartë ndërmjet financimit të planifikuar, alokimit të miratuar, disbursimit dhe shpenzimit faktik për secilin shërbim.

Së pesti, çmimet, pagat dhe kostot operative ndryshojnë sipas territorit, llojit të ofruesit dhe periudhës së referencës. Për këtë arsye, përllogaritjet paraqesin vlerësime të argumentuara të burimeve të nevojshme dhe jo tarifa të pandryshueshme. Ato duhet të përditësohen periodikisht për të pasqyruar inflacionin, ndryshimet në pagën minimale dhe pagat referuese, kostot e shërbimeve utilitare dhe çdo ndryshim në standardet ligjore ose nënligjore.

Së fundi, ndonëse kampioni përfshin një pjesë domethënëse të ofruesve, duke pasur parasysh numrin relativisht të kufizuar të shërbimeve të specializuara për DhBGj-në në Shqipëri, gjetjet nuk duhet të interpretohen si statistikisht përfaqësuese për të gjithë ofruesit. Ky kufizim është veçanërisht i rëndësishëm për strehëzat emergjente bashkiake, modelet e organizimit, kapacitetet dhe burimet financiare të të cilave mund të ndryshojnë ndjeshëm nga një bashki në tjetrën.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, përzgjedhja e të dhënave të verifikueshme, përdorimi i disa burimeve dhe dhënia përparësi cilësisë së informacionit kundrejt zgjerimit artificial të kampionit sigurojnë një bazë të arsyeshme për analizën. Gjetjet mundësojnë një kuptim më të qartë të strukturës së kostove, mënyrave të financimit dhe nevojave për burime të shërbimeve kryesore të specializuara për DhBGj-në në Shqipëri. Ato ofrojnë gjithashtu një pikënisje për përmirësimin e mbledhjes së të dhënave, standardizimin e kostimit dhe zhvillimin e analizave më të plota në të ardhmen.

## Cfarë përmban ky raport?

Raporti është i organizuar në dy kapituj kryesorë, të cilët lidhin analizën e detyrimeve ligjore dhe buxhetore me vlerësimin konkret të kostove të shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore.

**Kapitulli i parë** paraqet analizën ligjore, institucionale dhe buxhetore. Ai shqyrton fillimisht standardet ndërkombëtare që ndikojnë në organizimin dhe financimin e shërbimeve, me vëmendje të veçantë ndaj Konventës së Stambollit. Më tej, analizon kuadrin ligjor shqiptar, përfshirë Ligjin nr. 64/2025 "Për barazinë gjinore"[12], Ligjin nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje"[13], legjislacionin sektorial dhe aktet nënligjore që rregullojnë shërbimet e kujdesit shoqëror, ndihmën juridike, asistencën sociale, strehimin dhe punësimin.

Kapitulli vlerëson gjithashtu se si detyrimet ligjore për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor pasqyrohen në strategjitë kombëtare, Programin Buxhetor Afatmesëm dhe buxhetet vjetore. Analiza përqendrohet në lidhjen ndërmjet detyrimeve ligjore, përgjegjësive institucionale, produkteve buxhetore, treguesve të performancës dhe financimit të identifikueshëm. Një vëmendje e posaçme i kushtohet gjurmueshmërisë së fondeve, ndarjes së përgjegjësive ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vendore, administrimit të të dhënave për përfitueset dhe dallimit ndërmjet financimit publik të siguruar dhe mbështetjes së përkohshme nga donatorët.

**Kapitulli i dytë** shqyrton kërkesën për shërbime, kapacitetet ekzistuese dhe kostot e ofrimit të tyre në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit. Analiza mbulon gjashtë ofrues të përzgjedhur: Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Qendrën "LILIUM", strehëzën emergjente "Gruaja te Gruaja", Qendrën "Vatra", Qendrën "Të Ndryshëm & Të Barabartë" dhe Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje në Kamëz.

Për secilin ofrues shqyrtohen përgjegjësitë ligjore, kapacitetet për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, numri dhe profili i përfitueseve, kërkesa për shërbime, shpenzimet e viteve të mëparshme dhe parashikimet bazë për periudhën 2026–2028. Kapitulli identifikon gjithashtu kostot shtesë të nevojshme për plotësimin e mangësive në personel, infrastrukturë, aksesueshmëri, siguri, kujdes shëndetësor dhe psikologjik, mbështetje juridike, shërbime për fëmijët dhe riintegrim pas largimit nga strehëza. Përllogaritjet dallojnë ndërmjet shpenzimeve ekzistuese, nevojave shtesë dhe buxhetit të përgjithshëm që do të kërkohej për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve të përcaktuara.

Në pjesën përmbyllëse, raporti bashkon gjetjet ndërsektoriale, paraqet kostot e parashikuara dhe shpjegon kufizimet e të dhënave dhe të metodologjisë. Mbi këtë bazë formulohen rekomandime për zgjerimin e kapaciteteve, forcimin e burimeve njerëzore, institucionalizimin e përllogaritjes së kostove, financimin publik shumëvjeçar, kontraktimin e qëndrueshëm të ofruesve jofitimprurës, përmirësimin e REVALB-it dhe forcimin e monitorimit dhe të llogaridhënies. Në këtë mënyrë, raporti nuk kufizohet në evidentimin e shpenzimeve aktuale, por vlerëson hendekun ndërmjet financimit ekzistues dhe burimeve që nevojiten për zbatimin e plotë të standardeve ligjore dhe të Konventës së Stambollit.

[12] Ligji nr. 64/2025, datë 06.11.2025, "Për barazinë gjinore" https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/c94610c7-8f7f-4274-a3a7-bdf6ff2459f6

[13] Ligji nr. 11/2026, datë 28.01.2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje" https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/26a84a4d-1b39-4a51-80b9-5f159f8edaad

# KAPITULLI 1. ANALIZA LIGJORE

### Qëllimi dhe fokusi i analizës ligjore

Ky kapitull analizon kuadrin ligjor që përcakton detyrimet e institucioneve publike për financimin, organizimin dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Shqipëri. Analiza përqendrohet vetëm në ato instrumente ndërkombëtare dhe ligje kombëtare që krijojnë detyrime me ndikim të drejtpërdrejtë ose të matshëm financiar.
Në mënyrë të veçantë, kapitulli shqyrton:

- shërbimet mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara që duhet të garantohen;
- përgjegjësitë financiare të institucioneve qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore;
- detyrimin për zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor;
- kostot institucionale të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit;
- personelin, trajnimin, infrastrukturën dhe sistemet e të dhënave që kërkohen për zbatimin e ligjit;
- mbështetjen ekonomike, strehimin, ndihmën juridike dhe masat e riintegrimit;
- boshllëqet ndërmjet detyrimeve ligjore dhe financimit faktik.

Analiza mbështetet kryesisht në Ligjin nr. 64/2025 "Për barazinë gjinore"[14] dhe Ligjin nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje". Ligji nr. 11/2026 ka shfuqizuar Ligjin nr. 9669/2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar[15]. Për këtë arsye, ligji i vitit 2006 nuk analizohet më si baza ligjore aktuale, përveçse kur është e nevojshme të shpjegohet periudha kalimtare e zbatimit të akteve nënligjore.

## Standardet ndërkombëtare me ndikim në financimin e shërbimeve

Standardet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria krijojnë detyrime të drejtpërdrejta për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave dhe garantimin e shërbimeve të aksesueshme e cilësore. Këto detyrime kërkojnë sigurimin e burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore, duke mbuluar jo vetëm reagimin emergjent, por edhe kujdesin shëndetësor, strehimin, ndihmën juridike, rehabilitimin dhe riintegrimin afatgjatë. Instrumentet e mëposhtme përbëjnë bazën kryesore për vlerësimin e përgjegjësive të shtetit dhe të kostos së shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore.

### Konventa e Stambollit

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje përbën standardin kryesor ndërkombëtar për përcaktimin e përgjegjësive shtetërore në këtë fushë. Shqipëria e ratifikoi Konventën në vitin 2013 dhe ajo hyri në fuqi më 1 gusht 2014[16].

---

[14] Ligji nr. 64/2025, datë 06.11.2025, "Për barazinë gjinore" https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/c94610c7-8f7f-4274-a3a7-bdf6ff2459f6
[15] Ligji nr. 11/2026, datë 28.01.2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje" https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/26a84a4d-1b39-4a51-80b9-5f159f8edaad
[16] Republic of Albania, Law No. 104/2012, "On the Ratification of the Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence", Official Gazette of Albania, at: https://qbz.gov.al/eli/fz/2012/151

Nga këndvështrimi i kostimit, dispozita më e rëndësishme është detyrimi i shtetit për të alokuar burime të përshtatshme financiare dhe njerëzore për zbatimin e politikave, masave dhe programeve të integruara. Ky detyrim nuk kufizohet te financimi i strehëzave, por përfshin të gjithë zinxhirin e parandalimit, mbrojtjes, ndjekjes penale dhe riintegrimit.
Konventa kërkon financimin e:

- politikave të koordinuara kombëtare dhe vendore;
- shërbimeve të përgjithshme sociale dhe shëndetësore;
- shërbimeve të specializuara për gratë;
- strehëzave të sigurta dhe të aksesueshme;
- linjave telefonike të ndihmës që funksionojnë 24 orë në ditë, 7 ditë në javë;
- qendrave të referimit për viktimat e dhunës seksuale;
- këshillimit psikologjik, psikosocial dhe juridik;
- mbështetjes për fëmijët viktima ose dëshmitarë të dhunës;
- trajnimit të profesionistëve;
- programeve për autorët e dhunës;
- mbledhjes së të dhënave, kërkimit dhe monitorimit;
- mbështetjes së organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime të specializuara.

Në këtë kuptim, financimi i shërbimeve nuk është një masë diskrecionale ose e varur vetëm nga disponueshmëria e projekteve të donatorëve. Ai përbën pjesë të detyrimit pozitiv të shtetit për të ushtruar kujdesin e duhur në parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave dhe vendosjen e autorëve përpara përgjegjësisë.

Vlerësimi tematik i GREVIO-s për Shqipërinë, i publikuar në vitin 2024, evidentoi përparime në shtrirjen e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit në të gjitha bashkitë[17]. Megjithatë, raporti ngriti shqetësime për mbulimin e pabarabartë territorial, varësinë e disa shërbimeve nga financimi i donatorëve, mungesën e shërbimeve të mjaftueshme të specializuara dhe nevojën për trajnime sistematike të profesionistëve. Këto gjetje tregojnë se ekzistenca formale e një shërbimi nuk është e mjaftueshme: duhet të vlerësohen kapaciteti real, cilësia, aksesueshmëria, vazhdimësia dhe financimi i tij.

## Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe rekomandimet e përgjithshme të Komitetit përkatës e njohin dhunën me bazë gjinore si një formë diskriminimi ndaj grave.
Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 35 kërkon që shtetet të alokojnë burime të përshtatshme njerëzore dhe financiare në nivel kombëtar dhe vendor për zbatimin efektiv të masave kundër dhunës me bazë gjinore. Kjo përfshin financimin e:

- parandalimit dhe ndërgjegjësimit;
- strehimit dhe mbrojtjes emergjente;
- kujdesit shëndetësor dhe shëndetit mendor;
- ndihmës juridike;
- rehabilitimit dhe riintegrimit;
- mekanizmave të aksesueshëm për gratë që përballen me forma të shumëfishta diskriminimi;
- monitorimit të rezultateve dhe mbledhjes së të dhënave[18].

[17] Council of Europe, GREVIO's First Thematic Evaluation Report on Albania: Building Trust by Delivering Support, Protection and Justice (Strasbourg: Council of Europe, 2024), ), https://rm.coe.int/grevio-s-first-thematic-evaluation-report-on-albania/1680b1a0ca.
[18] CEDAW. General Recommendation No. 35 on Gender-Based Violence against Women, Updating General Recommendation No. 19. UN Doc. CEDAW/C/GC/35, 2017.

Në procesin e kostimit duhet të merret parasysh jo vetëm numri i përgjithshëm i viktimave, por edhe kostoja shtesë e garantimit të aksesit për gratë me aftësi të kufizuara, gratë në zonat rurale, gratë rome dhe egjiptiane, gratë migrante, gratë e moshuara dhe kategori të tjera që përballen me pengesa të shumëfishta[19].

## Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës

Konventa për të Drejtat e Fëmijës kërkon që shteti të mbrojë fëmijët nga çdo formë dhune fizike ose mendore, keqtrajtimi, abuzimi, neglizhimi dhe shfrytëzimi. Neni 19 kërkon marrjen e masave legjislative, administrative, shoqërore dhe arsimore, si dhe krijimin e procedurave efektive për identifikimin, raportimin, referimin, hetimin, trajtimin dhe ndjekjen e rasteve.
Ky standard është veçanërisht i rëndësishëm për fëmijët që:

- janë viktima të drejtpërdrejta të dhunës;
- kanë qenë të pranishëm gjatë ushtrimit të dhunës në familje;
- shoqërojnë nënat e tyre në strehëza emergjente ose qendra rezidenciale;
- kanë nevojë për mbështetje psikologjike, shëndetësore, arsimore dhe juridike;
- rrezikojnë të ndërpresin arsimin ose të humbasin lidhjen me shërbimet bazë[20].

Konventa kërkon gjithashtu që fëmijëve viktima t'u garantohet rikuperimi fizik dhe psikologjik dhe riintegrimi shoqëror në një mjedis që mbron shëndetin, dinjitetin dhe mirëqenien e tyre.
Për kostimin e shërbimeve, kjo nënkupton se fëmijët nuk duhet të llogariten vetëm si persona shoqërues të grave të strehuara. Ata janë përfitues të drejtpërdrejtë të shërbimeve dhe kërkojnë një paketë të përshtatur, e cila mund të përfshijë:

- vlerësimin individual të nevojave;
- mbështetjen psikologjike të specializuar;
- menaxhimin e rastit nga profesionistë të trajnuar;
- vazhdimësinë e arsimit;
- transportin për në shkollë;
- kujdesin ditor;
- kujdesin shëndetësor;
- mjedise dhe procedura miqësore për fëmijët;
- aktivitete zhvillimore dhe rikuperuese;
- mbështetjen pas largimit nga strehëza.

Për rrjedhojë, kostoja e shërbimeve për fëmijët duhet të identifikohet veçmas në buxhetet e strehëzave dhe qendrave rezidenciale dhe jo të përfshihet pa dallim në kostot e përgjithshme të akomodimit[21].

---

[19] UN Committee on the Elimination of Discrimination against Women. Concluding Observations on the Fourth Periodic Report of Albania. UN Doc. CEDAW/C/ALB/CO/4, 2016.
[20] Council of Europe. GREVIO Baseline Evaluation Report on legislative and other measures giving effect to the provisions of the Istanbul Convention – Albania. UN Doc. GREVIO/Inf (2020)8, Strasbourg, 2020; Committee on the Rights of the Child. Concluding Observations on the Combined Second to Fourth Periodic Reports of Albania. UN Doc. CRC/C/ALB/CO/2-4, 2012; Dika, Q., Duli, M., Burazeri, G., Çumashi, R., Hala, R., Agolli, E., & Qirja, G. Prevalence of child maltreatment in Albania. Eastern Mediterranean Health Journal, Vol. 30, No. 12, 2024, pp. 821–828
[21] United Nations. Convention on the Rights of the Child: Albania. United Nations Treaty Collection. https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=IV-11&chapter=4.

## Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara kërkon që shtetet të njohin rrezikun më të lartë që përjetojnë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi. Nenet 6 dhe 16 kërkojnë masa të posaçme për mbrojtjen e tyre dhe për sigurimin e shërbimeve të përshtatshme, të aksesueshme dhe të ndjeshme ndaj gjinisë dhe moshës.

Konventa kërkon që shërbimet e mbrojtjes dhe rehabilitimit të jenë të aksesueshme në praktikë. Kjo përfshin jo vetëm aksesin fizik në ndërtesa, por edhe:

- informacionin në formate të aksesueshme;
- komunikimin në gjuhë të kuptueshme;
- interpretimin në gjuhën e shenjave;
- përshtatjet e arsyeshme;
- pajisjet ndihmëse;
- mbështetjen personale;
- transportin e aksesueshëm;
- profesionistë të trajnuar për të punuar me persona me lloje të ndryshme aftësish të kufizuara;
- procedura të aksesueshme raportimi dhe ankimi.

Nga këndvështrimi i kostimit, aksesueshmëria nuk duhet të trajtohet si një shpenzim fakultativ. Ajo përbën pjesë të standardit minimal të shërbimit. Kostimi duhet të përfshijë investimet për përshtatjen fizike të strehëzave dhe qendrave, mjetet e komunikimit, interpretimin, transportin, pajisjet ndihmëse dhe mbështetjen shtesë të nevojshme.
Mungesa e këtyre elementeve mund ta bëjë një shërbim formalisht ekzistues, por praktikisht të paarritshëm për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.

## Karta Sociale Evropiane e Rishikuar

Karta Sociale Evropiane e Rishikuar plotëson standardet e Konventës së Stambollit duke garantuar të drejta që janë thelbësore për mbrojtjen dhe riintegrimin afatgjatë të viktimave. Këto përfshijnë të drejtën për mbrojtje shëndetësore, sigurime shoqërore, ndihmë sociale dhe mjekësore, përfitim nga shërbimet e mirëqenies sociale, mbrojtje nga varfëria dhe përjashtimi shoqëror, si dhe akses në strehim.

Për viktimat që largohen nga një marrëdhënie e dhunshme, këto të drejta kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mundësinë për të krijuar një jetë të pavarur dhe për të shmangur rikthimin te autori për arsye ekonomike.
Në procesin e kostimit duhet të përfshihen:

- ndihma ekonomike emergjente dhe kalimtare;
- strehimi social dhe bonusi i qirasë;
- kujdesi shëndetësor dhe shëndeti mendor;
- shërbimet e mirëqenies sociale;
- kujdesi për fëmijët;
- formimi profesional;
- ndërmjetësimi dhe mbështetja për punësim;
- masat kundër varfërisë dhe përjashtimit shoqëror;
- mbështetja pas largimit nga shërbimi rezidencial.

Karta përforcon argumentin se mbrojtja nuk përfundon me largimin nga situata e menjëhershme e rrezikut. Shteti duhet të sigurojë edhe kushtet sociale dhe ekonomike që mundësojnë rehabilitimin dhe riintegrimin e qëndrueshëm.
Shqipëria ka pranuar 64 nga 98 paragrafët e Kartës. Prandaj, jo të gjitha të drejtat e renditura — veçanërisht ato të parashikuara në nenet 30 dhe 31 — duhet të konsiderohen automatikisht

si detyrime të pranuara nga Shqipëria, pa verifikuar më parë tabelën e dispozitave të pranuara.[22]

## Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut[23] nuk përcakton një listë të posaçme shërbimesh ose një formulë financimi. Megjithatë, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ka vendosur se shtetet kanë detyrime për të parandaluar dhunën, për të mbrojtur personat në rrezik dhe për të zhvilluar hetime efektive kur autoritetet kanë dijeni ose duhet të kishin dijeni për rrezikun.
Këto detyrime lidhen veçanërisht me:

- të drejtën për jetën;
- ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose degradues;
- respektimin e jetës private dhe familjare;
- ndalimin e diskriminimit;
- të drejtën për një mjet juridik efektiv.

Nga këndvështrimi financiar, përmbushja e këtyre detyrimeve kërkon që shteti të sigurojë kapacitete reale dhe jo vetëm kompetenca formale. Kjo përfshin policinë e specializuar, vlerësimin e riskut, strehimin emergjent, mbështetjen shëndetësore dhe psikosociale, hetimin efektiv, ndihmën juridike dhe zbatimin e urdhrave të mbrojtjes.
Mungesa e fondeve nuk mund të përdoret si justifikim për mosmarrjen e masave të arsyeshme kur jeta, siguria ose integriteti i viktimës janë në rrezik. Kufizimet financiare nuk e heqin detyrimin e autoriteteve për të marrë masa të arsyeshme mbrojtëse brenda kompetencave të tyre, kur plotësohen kushtet ligjore për ndërhyrje.

## Konventa nr. 190 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për dhunën dhe ngacmimin

Konventa nr. 190 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës njeh të drejtën e çdo personi për një botë pune pa dhunë dhe ngacmim, përfshirë dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore. Ajo kërkon politika parandaluese, mekanizma raportimi dhe ankimi, mbrojtje nga hakmarrja, trajnim, ndërgjegjësim dhe masa mbështetëse[24].
Konventa njeh gjithashtu ndikimin e dhunës në familje në pjesëmarrjen, produktivitetin dhe sigurinë e grave në punë. Për këtë arsye, masat shtetërore dhe institucionale mund të përfshijnë:

- mekanizma konfidencialë raportimi;
- trajnime për punëdhënësit dhe inspektorët e punës;
- mbështetje për ruajtjen e vendit të punës;
- përshtatje të përkohshme të orarit ose vendit të punës;
- referim në shërbime të specializuara;
- mbrojtje nga diskriminimi dhe largimi nga puna;
- asistencë për riintegrimin ekonomik.

---

[22] Albania - Social Rights

[23] *European Court of Human Rights, Opuz v. Turkey, application no. 33401/02, judgment of 9 June 2009; Kurt v. Austria [GC], application no. 62903/15, judgment of 15 June 2021. See also the Court's Factsheet on Domestic Violence. Online: Opuz v. Turkey; Factsheet — Domestic violence. hudoc.echr.coe.int*

[24] International Labour Organization (ILO), Violence and Harassment Convention, 2019 (No. 190), 21 June 2019, Articles 4, 9, 10 and 11 https://www.ilo.org/resource/ilc/ilc108/violence-and-harassment-convention-2019-no-190

Për studimin aktual, kjo Konventë ka rëndësi kryesisht për kostimin e masave të riintegrimit ekonomik dhe të mbështetjes në punësim. Megjithatë, këto kosto duhet të dallohen nga kostot bazë të strehëzave, Linjës Kombëtare dhe Qendrës LILIUM.

**Përfundim mbi standardet ndërkombëtare**

Të marra së bashku, këto instrumente krijojnë një standard të integruar sipas të cilit shteti duhet të financojë jo vetëm reagimin emergjent, por të gjithë vazhdimësinë e mbështetjes: identifikimin, raportimin, mbrojtjen, kujdesin shëndetësor, strehimin, ndihmën juridike, rehabilitimin dhe riintegrimin social dhe ekonomik.
Ato kërkojnë gjithashtu që financimi të marrë parasysh nevojat e ndryshme të viktimave, veçanërisht:

- fëmijëve;
- grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara;
- grave në zonat rurale dhe të largëta;
- grave rome dhe egjiptiane;
- grave migrante dhe pa shtetësi;
- grave të moshuara;
- grave me fëmijë në ngarkim;
- viktimave që përballen me forma të shumëfishta diskriminimi.

Për rrjedhojë, vlerësimi i mjaftueshmërisë së financimit nuk mund të mbështetet vetëm në numrin e strukturave ose në shumën e përgjithshme të shpenzuar. Ai duhet të vlerësojë nëse burimet e alokuara garantojnë në praktikë disponueshmërinë, aksesueshmërinë, cilësinë, përshtatshmërinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve për të gjitha viktimat.

## Kuadri ligjor shqiptar dhe detyrimet financiare për shërbimet ndaj viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

### Hyrje në kuadrin ligjor kombëtar

Kuadri ligjor shqiptar për parandalimin dhe trajtimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje ka pësuar një ndryshim të rëndësishëm me miratimin e Ligjit nr. 64/2025 "Për barazinë gjinore"[25] dhe Ligjit nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje"[26]. Këto dy ligje krijojnë një bazë të re për organizimin, financimin dhe monitorimin e reagimit institucional, duke e zhvendosur vëmendjen nga ndërhyrja kryesisht pas rasteve të dhunës në një sistem më të gjerë që përfshin parandalimin, mbrojtjen e menjëhershme, shërbimet e specializuara, rehabilitimin dhe riintegrimin afatgjatë.
Ligji nr. 64/2025 vendos detyrimin horizontal për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në politikat, programet dhe buxhetet e institucioneve publike. Ligji nr. 11/2026, nga ana tjetër, përcakton paketën e të drejtave, masave mbrojtëse dhe shërbimeve që duhet t'u garantohen viktimave. Të lexuara së bashku, këto ligje kërkojnë që çdo detyrim për ofrimin e një shërbimi të shoqërohet me planifikim financiar, burime njerëzore, standarde cilësie, tregues performance dhe mekanizma monitorimi.
Kuadri kombëtar plotësohet nga legjislacioni për shërbimet e kujdesit shoqëror, ndihmën juridike, asistencën sociale, strehimin social, punësimin, vetëqeverisjen vendore dhe financat vendore. Këto ligje rregullojnë komponentë të ndryshëm të rrugës së viktimës në sistem:

[25] Ligji nr. 64/2025, datë 06.11.2025, "Për barazinë gjinore" https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/c94610c7-8f7f-4274-a3a7-bdf6ff2459f6
[26] Ligji nr. 11/2026, datë 28.01.2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje" https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/26a84a4d-1b39-4a51-80b9-5f159f8edaad

identifikimin dhe referimin, strehimin, ndihmën ekonomike, kujdesin shëndetësor, mbështetjen juridike, punësimin dhe pavarësinë ekonomike.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përbën bazën e përgjithshme të këtij sistemi. Parimet e barazisë përpara ligjit, ndalimit të diskriminimit, mbrojtjes së jetës dhe dinjitetit, integritetit fizik dhe psikologjik, jetës private dhe familjare dhe mbrojtjes së veçantë të fëmijëve krijojnë detyrimin e shtetit për të parandaluar dhunën dhe për të siguruar mbrojtje efektive. Gjithashtu, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe kanë epërsi ndaj ligjeve të zakonshme që nuk pajtohen me to. Për këtë arsye, ligjet kombëtare duhet të interpretohen dhe zbatohen në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit, CEDAË-it dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare.

Nga këndvështrimi i këtij studimi, rëndësi ka jo vetëm ekzistenca e një detyrimi ligjor, por aftësia e sistemit publik për ta zbatuar atë. E drejta për strehim emergjent, për shembull, nuk realizohet vetëm përmes ngritjes formale të një strukture, por kërkon ndërtesë të përshtatshme, personel të trajnuar, funksionim 24/7, ushqim, siguri, transport, këshillim, kujdes për fëmijët dhe financim të qëndrueshëm. Në të njëjtën mënyrë, funksionimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kërkon koordinator vendor, menaxhim profesional të rasteve, komunikim ndërinstitucional, dokumentim, transport, sisteme të sigurta të të dhënave dhe monitorim.

Analiza e kuadrit ligjor shqiptar përqendrohet, për rrjedhojë, në katër pyetje kryesore:

1. Cilat shërbime dhe masa duhet të garantohen sipas ligjit?
2. Cili institucion është përgjegjës për organizimin dhe financimin e tyre?
3. Cilat janë burimet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare që kërkon zbatimi?
4. A mundëson kuadri aktual identifikimin dhe monitorimin e financimit të nevojshëm dhe faktik?

Kjo qasje shërben për të dalluar ndërmjet kostos faktike të sistemit ekzistues dhe kostos normative të zbatimit të plotë të ligjit. Diferenca ndërmjet tyre përfaqëson hendekun real të financimit publik.

## Ligji nr. 64/2025 "Për barazinë gjinore"[27]

Ligji nr. 64/2025 krijon kuadrin e ri të përgjithshëm për garantimin dhe promovimin e barazisë gjinore në Shqipëri. Ai zëvendëson Ligjin nr. 9970/2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" dhe forcon detyrimet e institucioneve publike për integrimin e perspektivës gjinore në legjislacion, politika, programe, buxhete dhe shërbime.

Rëndësia e këtij ligji për kostimin e reagimit ndaj dhunës qëndron në faktin se buxhetimi i përgjigjshëm gjinor nuk trajtohet më vetëm si praktikë e rekomanduar, por si detyrim për institucionet publike qendrore dhe vendore.

Ligji e përkufizon buxhetimin e përgjigjshëm gjinor si qasje që integron sistematikisht objektivat e barazisë gjinore në:

- politikat qeveritare;
- planifikimin;
- buxhetimin;
- zbatimin;
- monitorimin;
- vlerësimin;
- auditimin.

[27] Ligji nr. 64/2025, datë 06.11.2025, "Për barazinë gjinore"
https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/c94610c7-8f7f-4274-a3a7-bdf6ff2459f6

Qëllimi është të evidentohet ndikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve publike te gratë dhe burrat dhe të riorientohen burimet në mënyrë që nevojat dhe prioritetet e ndryshme gjinore të trajtohen në mënyrë të drejtë.

**Detyrimi për buxhetim të përgjigjshëm gjinor**

Neni 12 kërkon që institucionet publike të zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në planifikimin, menaxhimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave buxhetore, programeve, planeve dhe projekteve.

Detyrimi zbatohet shprehimisht edhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kjo do të thotë se bashkitë duhet të integrojnë objektiva, masa dhe tregues gjinorë në:

- programet buxhetore afatmesme;
- buxhetet vjetore;
- planet sociale vendore;
- programin e përkujdesit social;
- fondin social vendor;
- projektet dhe kontratat për ofrimin e shërbimeve.

Në kontekstin e dhunës ndaj grave, institucionet nuk duhet të kufizohen në paraqitjen e shumës që aktualisht shpenzohet. Ato duhet fillimisht të identifikojnë:

- nevojën dhe kërkesën reale për shërbime;
- numrin e pritshëm të përfitueseve;
- llojin dhe intensitetin e shërbimit;
- standardin minimal të cilësisë;
- mbulimin e nevojshëm territorial;
- koston për njësi;
- burimin e financimit;
- hendekun ndërmjet kostos së nevojshme dhe alokimit faktik.

**Vlerësimi i ndikimit gjinor**

Ligji kërkon që projektligjet të shoqërohen me vlerësim të ndikimit gjinor. Ky detyrim është i rëndësishëm për politikat kundër dhunës, pasi çdo ndryshim ligjor ose program i ri duhet të analizojë ndikimin e tij te gratë dhe burrat, si dhe nevojat e grupeve të ndryshme.

Vlerësimi i ndikimit gjinor duhet të shoqërohet me vlerësim financiar. Nëse një projektligj krijon të drejtën për një shërbim të ri, zgjeron kategoritë e përfitueseve ose vendos standarde më të larta, ai duhet të identifikojë:

- kostot fillestare të ngritjes;
- kostot vjetore të funksionimit;
- personelin shtesë;
- investimet infrastrukturore;
- kostot e trajnimit;
- ndikimin në buxhetet qendrore dhe vendore.

**Burimet njerëzore dhe mekanizmat institucionalë**

Ligji kërkon burime njerëzore të kualifikuara për zbatimin e politikave të barazisë gjinore. Në ministrinë përgjegjëse duhet të funksionojë një strukturë e posaçme për çështjet gjinore, të paktën në nivel drejtorie. Ministritë, institucionet e administratës publike dhe njësitë vendore kanë detyrime për bashkëpunim, raportim dhe zbatim.

Kjo krijon kosto të lidhura me:

- pozicionet e dedikuara;
- pagat dhe kontributet;
- trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm;
- koordinimin ndërinstitucional;
- monitorimin dhe raportimin;

- mbështetjen teknike për institucionet vendore.

**Të dhënat dhe statistikat gjinore**
Ligji forcon detyrimin për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave gjinore dhe statistikave të ndara sipas seksit. Për sektorin e dhunës, kjo është thelbësore për planifikimin e kapaciteteve dhe kostove.
Financimi duhet të përfshijë:
- sistemet elektronike të të dhënave;
- standardizimin e treguesve;
- ndërveprimin e sistemeve institucionale;
- mbrojtjen e të dhënave personale;
- personelin përgjegjës;
- kontrollin e cilësisë;
- analizën dhe publikimin periodik.

Pa të dhëna të besueshme për numrin e viktimave, llojin e dhunës, shërbimet e përfituara, kohëzgjatjen e ndërhyrjes dhe rezultatet e arritura, nuk mund të ndërtohet një buxhet realist.

**Rëndësia për kostimin e shërbimeve**
Ligji nr. 64/2025[28] e lidh financimin e shërbimeve kundër dhunës me sistemin e përgjithshëm të financave publike. Shpenzimet duhet:
- të identifikohen në programet përkatëse buxhetore;
- të lidhen me objektiva të barazisë gjinore;
- të shoqërohen me tregues të matshëm;
- të ndiqen nga planifikimi deri te shpenzimi;
- të vlerësohen në raport me rezultatet për viktimat.

Kjo e zhvendos analizën nga pyetja "sa është shpenzuar?" te pyetja "sa nevojitet për të zbatuar standardin ligjor dhe çfarë rezultatesh janë arritur?".

**Ligji nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje"[29]**

Ligji nr. 11/2026 përbën bazën kryesore aktuale për parandalimin, mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave. Ai shfuqizon Ligjin nr. 9669/2006, të ndryshuar, dhe e zgjeron mbrojtjen përtej dhunës në marrëdhëniet familjare.
Ligji mbulon dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje në veprimtarinë publike dhe private, përfshirë:
- dhunën fizike;
- dhunën psikologjike;
- dhunën seksuale;
- dhunën ekonomike;
- dhunën e lehtësuar nga teknologjia;
- dhunën dhe ngacmimin seksual;
- dhunën ndaj grave në proceset zgjedhore dhe në politikë.

Ligji mbështetet në qasjen me në qendër viktimën, respektimin e dinjitetit, sigurisë, privatësisë dhe konfidencialitetit, shmangien e viktimizimit dytësor dhe garantimin e aksesit në drejtësi dhe në shërbime.

---

[28] Ligji nr. 64/2025, datë 06.11.2025, "Për barazinë gjinore" https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/c94610c7-8f7f-4274-a3a7-bdf6ff2459f6
[29] Ligji nr. 11/2026, datë 28.01.2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje" https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/26a84a4d-1b39-4a51-80b9-5f159f8edaad

Nga këndvështrimi financiar, ligji krijon një standard më të gjerë se kuadri i mëparshëm. Ai nuk kërkon vetëm reagim institucional dhe urdhra mbrojtjeje, por një paketë të integruar shërbimesh falas, të shpejta, lehtësisht të aksesueshme dhe të përshtatura me nevojat e viktimave.

**Vlerësimi individual dhe vlerësimi i riskut**

Ligji kërkon vlerësim individual të viktimës dhe të nevojave të saj për mbrojtje dhe mbështetje. Vlerësimi duhet të marrë parasysh rrezikun, natyrën e dhunës, përsëritjen, nevojat shëndetësore dhe psikosociale, praninë e fëmijëve, aftësinë e kufizuar dhe rrethana të tjera cenueshmërie.

Kjo kërkon:

- profesionistë të trajnuar;
- mjete dhe metodologji të standardizuara;
- kohë të dedikuar për intervistim;
- mjedise të sigurta dhe konfidenciale;
- koordinim ndërinstitucional;
- përditësim periodik të vlerësimit;
- dokumentim dhe ruajtje të sigurt të të dhënave.

Vlerësimi nuk duhet të konsiderohet si veprim administrativ pa kosto, por si shërbim profesional që ndikon në cilësinë dhe efektivitetin e ndërhyrjes.

**Shërbimet mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara**

Neni 16 u njeh viktimave të drejtën për mbështetje përmes shërbimeve të përgjithshme dhe të specializuara.

Mbështetja e përgjithshme përfshin:

- informimin dhe mbështetjen gjatë raportimit;
- informimin dhe referimin për ndihmë juridike falas;
- këshillimin juridik falas;
- këshillimin psikologjik dhe psikosocial falas;
- shërbimet mjekësore falas;
- ekzaminimet mjekoligjore falas;
- strehimin e menjëhershëm;
- ndihmën ekonomike për viktimat e dhunës në familje për të paktën 30 ditë;
- integrimin social dhe ekonomik;
- ndihmën dhe mbështetjen financiare;
- kujdesin për fëmijët;
- asistencën për punësim;
- arsimimin dhe formimin profesional.

Mbështetja e specializuar duhet të garantohet veçanërisht për viktimat e dhunës seksuale dhe, sipas rastit, për personat që përjetojnë dhunë ose ngacmim në vendin e punës.

Shërbimet duhet të ofrohen falas nga profesionistë të trajnuar, në mënyrë të personalizuar dhe në një gjuhë që viktima e kupton. Kur është e mundur, shërbimet duhet të ofrohen në të njëjtin mjedis, duke mbështetur zhvillimin e modeleve të integruara dhe të tipit "one-stop".

**Kategoritë e kostove të shërbimeve**

Zbatimi i nenit 16 kërkon financimin e:

- pagave dhe kontributeve të personelit;
- turneve dhe gatishmërisë 24/7;
- strehimit dhe mirëmbajtjes së mjediseve;
- ushqimit, veshmbathjes dhe produkteve të higjienës;
- sigurisë fizike;
- transportit dhe shoqërimit;

- përkthimit dhe interpretimit;
- përshtatjeve për personat me aftësi të kufizuara;
- këshillimit juridik, psikologjik dhe psikosocial;
- ekzaminimeve shëndetësore dhe mjekoligjore;
- medikamenteve dhe analizave laboratorike;
- kujdesit dhe mbështetjes për fëmijët;
- ndihmës ekonomike emergjente;
- strehimit kalimtar dhe afatgjatë;
- programeve të punësimit dhe formimit profesional;
- menaxhimit dhe ndjekjes së rastit;
- mbështetjes pas largimit nga strehëza.

Ligji parashikon miratimin e një udhëzimi që do të përcaktojë llojet e shërbimeve, standardet, procedurat, shtrirjen dhe rregullat e mbështetjes financiare. Deri në plotësimin e kuadrit nënligjor, analiza duhet të dallojë qartë ndërmjet të drejtave të njohura nga ligji dhe kapaciteteve faktike ekzistuese.

**Programet e rehabilitimit**

Neni 17 kërkon hartimin dhe zbatimin e programeve për rehabilitimin e viktimave dhe autorëve të dhunës.

Programet për viktimat duhet të synojnë:

- rikuperimin psikologjik dhe psikosocial;
- përmirësimin e sigurisë dhe mirëqenies;
- rikthimin e autonomisë;
- parandalimin e riviktimizimit;
- riintegrimin social dhe ekonomik.

Programet për autorët duhet të synojnë uljen e rrezikut të përsëritjes, ndryshimin e sjelljes së dhunshme dhe, kur është e nevojshme, trajtimin e varësive ose problemeve të shëndetit mendor.

Kostimi duhet të përfshijë vlerësimin fillestar, seancat individuale dhe në grup, personelin e specializuar, mjediset, monitorimin e pjesëmarrjes dhe vlerësimin e rezultateve.

Programet për autorët duhet të kenë financim të veçantë. Ato nuk duhet të financohen duke reduktuar burimet e destinuara për sigurinë, mbështetjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave.

**Masat e mbrojtjes dhe kostot e zbatimit**

Ligji zgjeron masat që mund të vendosen përmes urdhrave të mbrojtjes, duke përfshirë, sipas rastit:

- largimin e autorit;
- ndalimin e kontaktit;
- vendosjen e viktimës dhe fëmijëve në strehim të përkohshëm;
- pagesën e qirasë ose detyrimeve të tjera nga autori;
- mbështetjen psikosociale, shëndetësore dhe financiare;
- përfshirjen e viktimës në programe rehabilitimi;
- detyrimin e autorit për të ndjekur programe rehabilitimi;
- masa mbrojtëse për dhunën e lehtësuar nga teknologjia;
- monitorimin elektronik, kur është i disponueshëm dhe i nevojshëm.

Kostot e zbatimit të urdhrave të mbrojtjes duhet të përfshihen në buxhetet e policisë, bashkive, shërbimeve sociale, gjykatave, përmbarimit dhe ofruesve të shërbimeve.

**Mekanizmi i Koordinuar i Referimit dhe përgjegjësitë vendore**

Ligji nr. 11/2026[30] i njeh njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e MKR-së si autoritete përgjegjëse të linjës.
Bashkitë duhet të marrin masa për:

- trajnimin e strukturave të shërbimit social;
- identifikimin, trajtimin dhe referimin e rasteve;
- koordinimin ndërinstitucional;
- zbatimin dhe monitorimin e urdhrave të mbrojtjes;
- krijimin dhe përmirësimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- funksionimin e qendrave të rehabilitimit;
- programet për autorët e dhunës;
- informimin e publikut për masat dhe shërbimet;
- garantimin e aksesit në shërbime.

Neni 56, pika 3, kërkon që njësitë vendore të planifikojnë dhe menaxhojnë produktin e fondit social vendor, si pjesë e programit buxhetor vendor të përkujdesit social, për ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve të përgjithshme dhe të specializuara.
Shërbimet mund të ofrohen:

- drejtpërdrejt nga bashkia;
- përmes institucioneve publike;
- përmes kontraktimit të organizatave jofitimprurëse të specializuara.

Kjo dispozitë krijon një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet detyrimit ligjor, planit social vendor, programit buxhetor, fondit social vendor, standardit të shërbimit dhe kontraktimit të ofruesit.
Kostimi i MKR-së duhet të përfshijë:

- koordinatorin vendor;
- menaxhimin e rasteve;
- kohën e punës së anëtarëve;
- mbledhjet multidisiplinare;
- transportin dhe shoqërimin;
- komunikimin e sigurt;
- dokumentimin;
- sistemet e të dhënave;
- monitorimin e urdhrave të mbrojtjes;
- ndjekjen e planeve individuale;
- referimin dhe ndjekjen pas përfundimit të ndërhyrjes

### 2.2.7 Detyrimet e sistemit shëndetësor

Neni 51 kërkon që ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionet shëndetësore të garantojnë ndihmë mjekësore, psikosociale dhe shërbime të specializuara për viktimat.
Detyrimet përfshijnë:

- shërbimet e urgjencës;
- shërbimet e mjekut të familjes;
- trajtimin në qendrat shëndetësore dhe spitale;
- ekzaminimet mjekësore;
- dokumentimin e dëmtimeve;
- dhënien e raportit mjekësor;
- referimin në shërbime të specializuara;
- krijimin e qendrave të reja të integruara për viktimat e dhunës seksuale;
- fuqizimin e qendrave ekzistuese;
- shërbimet e specializuara të shëndetit mendor;

[30] Ligji nr. 11/2026, datë 28.01.2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje" https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/26a84a4d-1b39-4a51-80b9-5f159f8edaad

- trajtimin e autorëve me çrregullime të shëndetit mendor.

Për qëllimet e këtij studimi, vlerësohet se burimet e nevojshme për zbatimin e këtyre detyrimeve përfshijnë: ndërhyrjen mjekësore, personelin e specializuar, gatishmërinë 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë, pajisjet, analizat laboratorike, barnat, mbledhjen dhe ruajtjen e provave, dokumentimin, mbështetjen psikologjike dhe koordinimin me policinë, prokurorinë dhe shërbimet sociale.Këto dispozita krijojnë bazën për vlerësimin jo vetëm të kostos aktuale të Qendrës LILIUM, por edhe të kostos së zgjerimit të mbulimit me qendra të integruara për viktimat e dhunës seksuale.

**Detyrimet e Policisë së Shtetit**

Ligji kërkon krijimin e seksioneve përgjegjëse pranë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, me oficerë të policisë gjyqësore të trajnuar dhe të specializuar për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.

Ky detyrim kërkon:

- personel të dedikuar;
- trajnime fillestare dhe të vazhdueshme;
- mjedise konfidenciale për intervistimin;
- mjete transporti dhe shoqërimi;
- pajisje për dokumentimin dhe ruajtjen e provave;
- kapacitete për trajtimin e dhunës digjitale;
- instrumente të standardizuara për vlerësimin e riskut;
- monitorim të urdhrave të mbrojtjes;
- pajisje monitorimi elektronik, kur përdoren;
- sisteme raportimi dhe administrimi të të dhënave.

Këto shpenzime duhet të identifikohen si pjesë e reagimit ndaj dhunës dhe jo të mbeten të padallueshme brenda shpenzimeve të përgjithshme të rendit publik.

**Trajnimi i detyrueshëm i profesionistëve**

Neni 45 përcakton se viktimat duhet të trajtohen vetëm nga profesionistë të trajnuar dhe të specializuar. Institucionet me përgjegjësi trajnuese duhet të hartojnë programe dhe kalendarë trajnimi dhe të përcaktojnë buxhetin e nevojshëm për trajnime të vazhdueshme dhe të detyrueshme.

Kostimi duhet të përfshijë:

- vlerësimin e nevojave për trajnim;
- hartimin dhe përditësimin e moduleve;
- trajnuesit dhe materialet;
- kohën e punës së pjesëmarrësve;
- trajnimin e stafit të ri;
- rifreskimin periodik të njohurive;
- mbikëqyrjen profesionale;
- vlerësimin e njohurive dhe praktikës;
- raportimin vjetor.

Trajnimi duhet të trajtohet si shpenzim i rregullt institucional dhe jo si aktivitet që zhvillohet vetëm kur sigurohet financim nga donatorët.

**Parandalimi dhe ndërgjegjësimi**

Ligji kërkon që autoritetet qendrore dhe vendore të realizojnë programe dhe fushata vjetore për edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut.

Masat duhet të mbulojnë:

- format e dhunës ndaj grave;
- raportimin dhe shërbimet e disponueshme;

- identifikimin e hershëm;
- dhunën e lehtësuar nga teknologjia;
- ngacmimin seksual në punë;
- angazhimin e burrave dhe djemve;
- parandalimin ndërmjet fëmijëve dhe të rinjve;
- materiale në formate të aksesueshme.

Këto masa kërkojnë buxhete të parashikueshme për hartimin e materialeve, komunikimin publik, aktivitetet në komunitet, aksesueshmërinë dhe vlerësimin e ndikimit.

**Të dhënat, statistikat dhe studimi i prevalencës**

Ligji nr. 11/2026 kërkon:

- mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave administrative;
- përmirësimin e sistemeve të të dhënave;
- prodhimin dhe publikimin vjetor të statistikave;
- të dhëna të disagreguara për format e dhunës;
- mbledhjen dhe publikimin e të dhënave për femicidin;
- kryerjen e një studimi kombëtar prevalence çdo pesë vjet.

Zbatimi kërkon financim për:

- sistemet elektronike;
- ndërveprimin e bazave të të dhënave;
- metodologjitë dhe treguesit;
- mbrojtjen e të dhënave personale;
- personelin dhe trajnimin;
- kontrollin e cilësisë;
- analizën dhe publikimin;
- studimet periodike kombëtare.

Këto të dhëna janë të nevojshme për të përcaktuar kërkesën për shërbime, kapacitetet e nevojshme, koston përfituese dhe hendekun financiar.

**Ligjet sektoriale me ndikim të drejtpërdrejtë financiar**

**Ligjet sektoriale me ndikim të drejtpërdrejtë financiar**

Përmbushja e detyrimeve që burojnë nga Ligji nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje"[31] dhe nga Konventa e Stambollit nuk varet vetëm nga legjislacioni specifik kundër dhunës. Ajo kërkon ndërveprimin e një sërë ligjesh sektoriale që rregullojnë shërbimet shoqërore, ndihmën juridike, mbështetjen ekonomike, strehimin, punësimin dhe financat vendore. Këto ligje përcaktojnë instrumentet përmes të cilave të drejtat e viktimave duhet të shndërrohen në shërbime konkrete dhe të financuara.

**Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"**

Ligji nr. 121/2016 rregullon organizimin, ofrimin, standardizimin dhe financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror[32]. Ai përbën bazën ligjore për funksionimin e strehëzave emergjente dhe afatgjata, shërbimeve rezidenciale dhe komunitare, këshillimit, rehabilitimit dhe riintegrimit.
Nga këndvështrimi i kostimit, zbatimi i këtij ligji kërkon që të mos merret në konsideratë vetëm numri i personave të akomoduar, por e gjithë struktura e nevojshme për ofrimin e një shërbimi

[31] Ligji nr. 11/2026, datë 28.01.2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje" https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/26a84a4d-1b39-4a51-80b9-5f159f8edaad

[32] Republic of Albania, Law No. 121/2016, dated 24 November 2016, "On Social Care Services in the Republic of Albania", as amended by Law No. 99/2024, dated 12 September 2024, consolidated version, Official Publications Centre (Qendra e Botimeve Zyrtare) https://qbz.gov.al/alfresco/webdav/Aktet/ligj/kuvendi-i-shqiperise/2016/11/24/121-2016/cons-2024-11-14/ligj-2016-11-24-121-2016%20i%20perditesuar.pdf

cilësor. Kjo përfshin standardin e miratuar të shërbimit, kapacitetin e licencuar dhe atë të përdorur realisht, numrin dhe profilin e përfitueseve, raportin ndërmjet personelit dhe përfitueseve, kohëzgjatjen e qëndrimit, shpenzimet e drejtpërdrejta dhe administrative, si dhe kostot e monitorimit dhe inspektimit.
Ligji është veçanërisht i rëndësishëm për analizën financiare, pasi parashikon financim nga disa burime: buxheti qendror, fondi social dhe buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore. Ai krijon gjithashtu bazën për kontraktimin e ofruesve jopublikë. Për rrjedhojë, kostimi duhet të evidentojë jo vetëm shumën e nevojshme për ofrimin e shërbimit, por edhe institucionin përgjegjës për financimin dhe mekanizmin përmes të cilit fondet duhet të transferohen te ofruesi.

**Ligji nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"**
Ligji nr. 111/2017[33] garanton ndihmë juridike falas për kategoritë e mbrojtura, përfshirë viktimat e dhunës në familje dhe të dhunës seksuale, sipas kushteve të përcaktuara në të. Në praktikë, nevojat juridike të viktimave shkojnë përtej përfaqësimit në një proces të vetëm. Ato mund të përfshijnë këshillimin juridik parësor, përgatitjen e dokumentacionit, kërkesat për urdhër mbrojtjeje, përfaqësimin në procedime penale, çështjet familjare dhe administrative, si dhe shërbimet e përkthimit dhe interpretimit.
Kostimi duhet të marrë parasysh edhe pengesat territoriale dhe sociale që kufizojnë aksesin në ndihmën juridike, veçanërisht në zonat rurale. Për këtë arsye, mund të nevojiten shërbime lëvizëse, mekanizma referimi dhe forma të tjera mbështetjeje. Ndihma juridike e garantuar nga shteti nuk e zëvendëson domosdoshmërisht këshillimin juridik të ofruar brenda strehëzave dhe shërbimeve të specializuara. Të dyja format kanë funksione të ndryshme, por plotësuese, dhe duhet të planifikohen si pjesë e së njëjtës paketë mbështetëse.

**Ligji nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"**
Ky ligj[34] krijon bazën për mbështetjen ekonomike të individëve dhe familjeve që nuk kanë të ardhura të mjaftueshme. Ai duhet të zbatohet në lidhje me detyrimin e parashikuar nga Ligji nr. 11/2026 për ofrimin e ndihmës ekonomike për viktimat e dhunës në familje për të paktën 30 ditë.
Megjithatë, mbështetja financiare nuk duhet të kufizohet në periudhën e emergjencës. Përllogaritja e nevojave duhet të dallojë ndërmjet ndihmës së menjëhershme, mbështetjes gjatë qëndrimit në strehëz, asistencës kalimtare pas largimit dhe masave afatmesme që mundësojnë pavarësinë ekonomike. Pa këtë vazhdimësi, viktimat mund të përballen me varfëri, pasiguri strehimi dhe rrezik të shtuar për t'u rikthyer në mjedisin e dhunshëm.

**Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social"**
Ligji nr. 22/2018[35] i përfshin viktimat e dhunës në familje ndër kategoritë prioritare për përfitimin nga programet e strehimit social. Strehimi i qëndrueshëm përbën një element thelbësor të riintegrimit dhe një kusht praktik për shkëputjen afatgjatë nga autori i dhunës.

---

[33] Republic of Albania, Law No. 111/2017, dated 14 December 2017, "On State-Guaranteed Legal Aid", Official Gazette of the Republic of Albania, published by the Official Publications Centre (Qendra e Botimeve Zyrtare) https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/legjislacion/

[34] Republic of Albania, Law No. 57/2019, dated 18 July 2019, "On Social Assistance in the Republic of Albania", as amended by Law No. 79/2023, dated 12 October 2023, Official Gazette No. 113/2019, Official Publications Centre (Qendra e Botimeve Zyrtare https://qbz.gov.al/eli/ligj/2019/07/18/57

[35] Republic of Albania, Law No. 22/2018, "On Social Housing", as amended by Law No. 48/2023, dated 22 June 2023, consolidated text, Ministry of Economy, Culture and Innovation https://ekb.gov.al/legjislacioni-1/

Kostot e strehimit mund të përfshijnë bonusin e qirasë, strehimin e përkohshëm, banesat sociale me qira, subvencionimin e qirasë ose të interesave të kredisë, përshtatjen e banesës për personat me aftësi të kufizuara, garancinë dhe pagesat fillestare, si dhe mbështetjen për kalimin drejt jetesës së pavarur. Problemi kryesor nuk është vetëm ekzistenca formale e këtyre instrumenteve, por aksesi real dhe në kohë i viktimave në to. Për rrjedhojë, kostimi duhet të vlerësojë edhe diferencën ndërmjet numrit të personave që plotësojnë kriteret dhe numrit të personave që përfitojnë efektivisht.

**Ligji nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"**
Ligji nr. 15/2019[36] krijon instrumente për punësimin, formimin profesional, ndërmjetësimin në tregun e punës, subvencionimin e punësimit dhe vetëpunësimin. Këto masa plotësojnë detyrimin e Ligjit nr. 11/2026 për integrimin social dhe ekonomik të viktimave, si dhe për mbështetjen e tyre në punësim, arsim dhe trajnim.
Kostimi i kësaj mbështetjeje duhet të përfshijë profilizimin dhe orientimin profesional, formimin, ndërmjetësimin për punësim, subvencionimin e vendeve të punës dhe mbështetjen për vetëpunësim. Në të njëjtën kohë, duhet të përllogariten shpenzimet që shpesh përcaktojnë nëse një grua mund ta ndjekë realisht një program punësimi, si transporti, kujdesi për fëmijët, mentorimi dhe ndjekja pas punësimit. Pa financimin e këtyre elementeve plotësuese, masat e punësimit mund të mbeten formalisht të disponueshme, por praktikisht të paarritshme.

**Legjislacioni për vetëqeverisjen dhe financat vendore**
Legjislacioni për vetëqeverisjen dhe financat vendore ka rëndësi të veçantë, pasi një pjesë e konsiderueshme e përgjegjësisë për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore ushtrohet në nivel bashkie. Bashkitë duhet ta lidhin vlerësimin e nevojave me planin social vendor, Programin Buxhetor Afatmesëm, buxhetin vjetor, fondin social vendor, kontraktimin e shërbimeve, monitorimin e ofruesve dhe raportimin e rezultateve.

Megjithatë, transferimi i përgjegjësive në nivel vendor nuk duhet të shndërrohet në decentralizim të pafinancuar. Kapaciteti fiskal ndryshon ndjeshëm ndërmjet bashkive dhe, në mungesë të transfertave të mjaftueshme dhe mekanizmave barazues, vendbanimi mund të përcaktojë nivelin e mbrojtjes që merr një viktimë. Kur burimet vendore nuk mjaftojnë për të garantuar standardin minimal, financimi qendror duhet të plotësojë hendekun dhe të sigurojë një nivel të krahasueshëm shërbimesh në të gjithë territorin.

**Aktet nënligjore dhe standardet e shërbimeve**
Zbatimi praktik i kuadrit ligjor mbështetet në aktet nënligjore që rregullojnë funksionimin e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit, menaxhimin e rasteve, standardet e shërbimeve të përgjithshme dhe të specializuara, si dhe metodologjinë e financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Ligji nr. 11/2026 ka shfuqizuar Ligjin nr. 9669/2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar. Megjithatë, neni 59 i ligjit të ri përcakton se aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit të mëparshëm vazhdojnë të jenë në fuqi deri në zëvendësimin e tyre. Për rrjedhojë, aktet ekzistuese përbëjnë një kuadër kalimtar: ato vazhdojnë të zbatohen, por duhet të interpretohen në përputhje me Ligjin nr. 11/2026 dhe Ligjin nr. 64/2025 "Për barazinë gjinore"[37].

[36] Republic of Albania, Law No. 15/2019, dated 13 March 2019, "On Employment Promotion", as amended, Official Publications Centre (Qendra e Botimeve Zyrtare) https://ekonomia.gov.al/ligje-2/

[37] Ligji nr. 64/2025, datë 06.11.2025, "Për barazinë gjinore"
https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/c94610c7-8f7f-4274-a3a7-bdf6ff2459f6

Për objektin e këtij studimi, rëndësi të drejtpërdrejtë kanë:

- VKM nr. 518/2018 për shërbimet komunitare dhe rezidenciale të kujdesit shoqëror;
- VKM nr. 150/2019 për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- VKM nr. 327/2021 për funksionimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit;
- VKM nr. 430/2016 për standardet e Linjës Kombëtare të Këshillimit;
- VKM nr. 505/2011 për standardet e shërbimeve në qendrat rezidenciale publike dhe jopublike;
- Udhëzimi nr. 816/2018 për standardet dhe funksionimin e qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale;
- Udhëzimi nr. 744/2019 dhe Udhëzimi nr. 354/2022 për shërbimet e strehimit emergjent dhe të sigurt;
- urdhrat nr. 100 dhe nr. 101/2020 për procedurat standarde të veprimit të punonjësve të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe profesionistëve shëndetësorë.

Këto akte përcaktojnë elemente që ndikojnë drejtpërdrejt në koston e shërbimeve: numrin dhe kualifikimin e personelit; funksionimin 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë të shërbimeve emergjente; kushtet e akomodimit, sigurisë dhe konfidencialitetit; ushqimin dhe nevojat bazë; ndihmën psikologjike, psikosociale dhe juridike; kujdesin shëndetësor dhe ekzaminimet mjekoligjore; kujdesin për fëmijët; vlerësimin e riskut; menaxhimin e rastit; si dhe rehabilitimin, riintegrimin, dokumentimin dhe monitorimin.
Megjithatë, shumica e këtyre akteve janë miratuar përpara hyrjes në fuqi të ligjeve të reja dhe janë ndërtuar kryesisht rreth konceptit të dhunës në familje. Ligji nr. 11/2026 e zgjeron ndjeshëm fushën e mbrojtjes, duke përfshirë forma të tjera të dhunës ndaj grave, dhunën seksuale, dhunën e lehtësuar nga teknologjia dhe dhunën ndaj grave në zgjedhje dhe politikë. Në të njëjtën kohë, Ligji nr. 64/2025 kërkon që planifikimi, financimi, zbatimi dhe monitorimi të mbështeten në integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.

Kjo krijon një mospërputhje të përkohshme ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve më të gjera të parashikuara nga ligjet e reja dhe standardeve operative ende të bazuara në kuadrin e mëparshëm. Rishikimi i akteve nënligjore duhet, për rrjedhojë, të harmonizojë terminologjinë dhe fushën e zbatimit, të përcaktojë paketën minimale të shërbimeve dhe kostot standarde për njësi, si dhe të qartësojë ndarjen e përgjegjësive financiare ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Ai duhet gjithashtu të krijojë procedura të qëndrueshme për kontraktimin e organizatave jofitimprurëse dhe të garantojë akses për viktimat me aftësi të kufizuara ose që përballen me forma të shumëfishta diskriminimi.

Deri në miratimin e akteve të reja, përllogaritja e kostove duhet të mbështetet në standardet ekzistuese, të plotësuara me detyrimet më të gjera që burojnë nga Ligji nr. 11/2026, Ligji nr. 64/2025 dhe Konventa e Stambollit. Për këtë arsye, rezultatet e këtij studimi duhet të konsiderohen në kontekstin e një kuadri kalimtar dhe të rishikohen nëse aktet e reja ndryshojnë standardet, paketën minimale të shërbimeve, kostot për njësi ose ndarjen e përgjegjësive financiare.

**Implikimet për metodologjinë e kostimit**

Kuadri i ri ligjor kërkon kalimin nga llogaritja e shpenzimeve të disa institucioneve ekzistuese drejt përllogaritjes së kostos së një pakete të plotë të drejtash dhe shërbimesh. Njësia kryesore e analizës duhet të jetë rruga e plotë e viktimës, duke filluar nga identifikimi dhe raportimi dhe duke vazhduar me vlerësimin e riskut, mbrojtjen dhe transportin emergjent, strehimin, kujdesin shëndetësor dhe mjekoligjor, mbështetjen psikologjike dhe psikosociale, ndihmën

juridike, menaxhimin e rastit, mbështetjen ekonomike, rehabilitimin, strehimin afatgjatë, punësimin dhe ndjekjen pas përfundimit të ndërhyrjes.

Për çdo hallkë të kësaj rruge duhet të përcaktohen institucioni përgjegjës, standardi minimal, numri i pritshëm i përfitueseve, kapaciteti ekzistues dhe ai i nevojshëm, intensiteti dhe kohëzgjatja e shërbimit, kostoja për njësi, burimi i financimit dhe mbulimi territorial. Analiza duhet të evidentojë veçmas kontributet e organizatave të shoqërisë civile dhe të donatorëve, në mënyrë që financimi i jashtëm të mos paraqitet gabimisht si financim i garantuar nga shteti.

Është gjithashtu e nevojshme të bëhet dallimi ndërmjet katër kategorive financiare:

- kostos normative të zbatimit të standardit;
- buxhetit publik të alokuar;
- shpenzimit faktik;
- nevojave që mbeten të pambuluara.

Në këtë analizë duhet të përfshihen edhe kontributet në natyrë, puna e papaguar dhe shpenzimet e mbuluara nga organizatat ose donatorët. Këto burime mund ta mbajnë përkohësisht në funksion sistemin, por nuk përbëjnë financim publik të qëndrueshëm. Diferenca ndërmjet kostos normative, financimit të garantuar dhe shpenzimit faktik përfaqëson hendekun real të financimit.

**Përfundime**

Ligji nr. 64/2025 dhe Ligji nr. 11/2026 krijojnë një bazë më të fortë për financimin e parandalimit dhe reagimit ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ligji për barazinë gjinore kërkon integrimin e nevojave dhe objektivave gjinorë në të gjitha fazat e procesit buxhetor, ndërsa ligji i ri kundër dhunës përcakton një paketë më të gjerë shërbimesh falas dhe përgjegjësi më të qarta për autoritetet qendrore dhe vendore.

Ligji nr. 11/2026 parashikon të drejtën për shërbime të përgjithshme dhe të specializuara, strehim emergjent, ndihmë psikosociale, mbështetje ekonomike, integrim social dhe ekonomik, qendra të integruara për viktimat e dhunës seksuale, trajnimin e profesionistëve dhe përmirësimin e sistemeve të të dhënave. Ai krijon gjithashtu mundësi për financim përmes fondit social vendor dhe për kontraktimin e organizatave jofitimprurëse.

Megjithatë, zgjerimi i të drejtave ligjore nuk shoqërohet ende me përcaktimin e plotë të kostos standarde për çdo shërbim, nivelit të mbështetjes për përfituese apo formulës së ndarjes së financimit ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Pa këto elemente, ekziston rreziku që detyrimet e reja të mbeten të nënfinancuara ose të zbatohen në mënyrë të pabarabartë ndërmjet bashkive.

Për rrjedhojë, analiza e kostos nuk duhet të kufizohet në riprodhimin e shpenzimeve të strukturave ekzistuese. Ajo duhet të përcaktojë se sa kushton zbatimi i plotë i standardeve të vendosura nga legjislacioni kombëtar dhe Konventa e Stambollit. Vetëm krahasimi ndërmjet kësaj kostoje normative, financimit të alokuar dhe shpenzimit faktik mund të japë një pasqyrë të saktë të hendekut financiar dhe të burimeve shtesë që duhet të mobilizohen.

**Strategjitë kombëtare dhe financimi i masave kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje**

**Qëllimi dhe fusha e analizës**

Ky seksion vlerëson nëse dokumentet kryesore strategjike të Shqipërisë krijojnë një bazë të mjaftueshme për planifikimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e masave kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Analiza nuk kufizohet në shqyrtimin formal të pranisë së dhunës me bazë gjinore në këto dokumente, por vlerëson nëse angazhimet strategjike janë përkthyer në masa të kostuara, përgjegjësi të qarta institucionale, burime të identifikueshme financimi dhe rezultate të matshme.
Në këtë kuptim, një strategji konsiderohet e përshtatshme për qëllime të planifikimit dhe buxhetimit vetëm nëse përcakton qartë se çfarë shërbimi duhet të ofrohet, nga cili institucion, për sa përfituese, me çfarë kostoje, nga cili program buxhetor dhe brenda cilit afat. Po aq e rëndësishme është që dokumenti të mundësojë krahasimin ndërmjet kostos së vlerësuar, financimit të planifikuar, alokimit të miratuar, shumës së disbursuar, shpenzimit faktik dhe rezultateve të arritura.
Analiza mbulon të gjithë vazhdimësinë e mbështetjes për viktimat: nga identifikimi, raportimi dhe ndërhyrja emergjente deri te strehimi, mbështetja psikologjike, ndihma juridike, rehabilitimi dhe riintegrimi afatgjatë. Në këtë kuadër, ajo shqyrton gjithashtu nëse dokumentet strategjike dallojnë kostot fillestare për ngritjen ose përshtatjen e një shërbimi nga kostot e vazhdueshme të funksionimit dhe nëse përcaktojnë qartë ndarjen e përgjegjësive financiare ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore.

**Dokumentet strategjike të analizuara**
Analiza përqendrohet në tri dokumente me lidhje të drejtpërdrejtë me masat dhe shërbimet e trajtuara në këtë studim:

1. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030;
2. Strategjia Kombëtare e Mirëqenies Sociale 2024–2030;
3. Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030.

Këto strategji mbulojnë dimensione të ndryshme, por plotësuese, të përgjigjes shtetërore: politika kundër dhunës me bazë gjinore dhe shërbimet e specializuara; sistemi i kujdesit shoqëror, strehimit dhe riintegrimit; si dhe mbrojtja e viktimave gjatë procedimeve dhe aksesi në drejtësi.

Strategji të tjera sektoriale, përfshirë dokumentet për rininë, shëndetin dhe shëndetin seksual e riprodhues, përmbajnë masa me ndikim të tërthortë në parandalimin ose trajtimin e dhunës. Megjithatë, ato nuk janë analizuar më vete, sepse nuk parashikojnë financim të dallueshëm për shërbimet që përbëjnë objektin e këtij studimi: Linjën Kombëtare të Këshillimit për Gra dhe Vajza, Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, Qendrën LILIUM, strehëzat emergjente dhe qendrat rezidenciale afatgjata. Përfshirja e tyre do të rriste rrezikun e mbivendosjes dhe të numërimit të dyfishtë të masave ose burimeve financiare të raportuara në disa dokumente njëkohësisht.

**Standardi i ri ligjor për planifikimin strategjik dhe buxhetor**

Të tria strategjitë janë miratuar përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 64/2025 "Për barazinë gjinore"[38] dhe Ligjit nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje"[39]. Për rrjedhojë, ato vazhdojnë të përbëjnë bazën kryesore të planifikimit strategjik, por nuk mund të konsiderohen automatikisht të mjaftueshme për përmbushjen e

[38] Ligji nr. 64/2025, datë 06.11.2025, "Për barazinë gjinore" https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/c94610c7-8f7f-4274-a3a7-bdf6ff2459f6
[39] Ligji nr. 11/2026, datë 28.01.2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje" https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/26a84a4d-1b39-4a51-80b9-5f159f8edaad

standardeve të reja ligjore. Planet e veprimit, kostot, treguesit dhe përgjegjësitë institucionale e financiare duhet të rishikohen dhe të harmonizohen me këto detyrime.

Ligji nr. 64/2025 kërkon që institucionet publike qendrore dhe vendore të zbatojnë buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit të politikave dhe të buxhetit. Në praktikë, kjo do të thotë se masat strategjike duhet të mbështeten në një analizë të nevojave dhe pabarazive gjinore, të përcaktojnë grupet e synuara dhe numrin e pritshëm të përfitueseve, të identifikojnë shërbimet që duhet të financohen dhe të përllogarisin kostot përkatëse. Çdo masë duhet të lidhet me një institucion zbatues, një institucion financues dhe një program të identifikueshëm buxhetor. Treguesit duhet të mundësojnë matjen jo vetëm të realizimit të aktiviteteve, por edhe të mbulimit, cilësisë dhe rezultateve për viktimat.

Ligji nr. 11/2026 zgjeron njëkohësisht fushën e mbrojtjes dhe paketën e shërbimeve që duhet të pasqyrohen në planifikimin strategjik dhe buxhetor. Kjo paketë përfshin informimin dhe mbështetjen gjatë raportimit, vlerësimin individual të nevojave dhe të riskut, këshillimin juridik, psikologjik dhe psikosocial falas, ndihmën mjekësore dhe ekzaminimet mjekoligjore, transportin dhe strehimin emergjent 24/7, ndihmën ekonomike, mbështetjen për fëmijët, shërbimet për viktimat e dhunës seksuale, rehabilitimin dhe riintegrimin social-ekonomik. Ajo përfshin gjithashtu funksionimin e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit, trajnimin e profesionistëve, administrimin e të dhënave, strukturat e specializuara dhe programet për rehabilitimin e viktimave dhe autorëve të dhunës.
Harmonizimi me ligjin e ri nuk mund të realizohet vetëm duke shtuar aktivitete të reja në planet ekzistuese. Çdo detyrim duhet të shoqërohet me një standard shërbimi, një kosto të vlerësuar, një burim të qëndrueshëm financimi, një institucion përgjegjës, një afat zbatimi dhe tregues të matshëm.

**Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030**
Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, e miratuar me VKM nr. 400, datë 30.6.2021, përbën dokumentin kryesor politik për avancimin e barazisë gjinore dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore në Shqipëri[40]. Drejtimi Strategjik III synon zvogëlimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe praktikave të dëmshme.
Strategjia mbulon parandalimin dhe ndërgjegjësimin, përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, forcimin e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit, zgjerimin e aksesit në shërbime të përgjithshme dhe të specializuara, ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve, rehabilitimin dhe riintegrimin, si dhe përmirësimin e mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka përgjegjësinë kryesore për koordinimin dhe monitorimin, ndërsa detyra të tjera u janë ngarkuar ministrive të linjës, Policisë së Shtetit, institucioneve të drejtësisë, Shërbimit Social Shtetëror, INSTAT-it dhe njësive të vetëqeverisjes vendore.

Nga pikëpamja e planifikimit, Strategjia dhe plani i saj i veprimit përmbajnë masa, afate, institucione përgjegjëse, tregues dhe vlerësime financiare. Ky është një zhvillim i rëndësishëm, por struktura aktuale e kostimit nuk mundëson gjithmonë identifikimin e financimit të parashikuar për çdo shërbim. Kostot paraqiten kryesisht në nivel mase ose aktiviteti dhe jo si kosto të dallueshme për Linjën Kombëtare të Këshillimit, Qendrën LILIUM, strehëzat emergjente, qendrat rezidenciale afatgjata, menaxhimin e rasteve nga Mekanizmat e Koordinuar të Referimit apo mbështetjen pas daljes nga strehëza.

[40] Government of Albania. (2021). *Decision of the Council of Ministers No. 400/2021 on the approval of the National Strategy for Gender Equality 2021–2030*. Available at: https://qbz.gov.al.

Një tjetër kufizim është mungesa e kostove standarde për njësi shërbimi. Dokumentet nuk japin në mënyrë sistematike informacion për koston e një telefonate ose rasti të trajtuar nga Linja Kombëtare, koston e një rasti të menaxhuar nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit, koston ditore për një grua ose fëmijë në strehëz apo koston e një pakete të plotë rehabilitimi dhe riintegrimi. Pa këto të dhëna, është e vështirë të lidhet buxheti me numrin e përfitueseve, kapacitetin e shërbimit dhe standardin e kërkuar të cilësisë.

Plani i veprimit identifikon buxhetin e shtetit, buxhetet vendore dhe mbështetjen e partnerëve të zhvillimit si burime financimi. Megjithatë, nuk dallohet gjithmonë qartë se cila pjesë është e miratuar dhe e siguruar dhe cila mbetet e kushtëzuar nga financimi i ardhshëm ose nga mbështetja e donatorëve[41]. Në të njëjtën mënyrë, përcaktimi i institucionit përgjegjës për një masë nuk shoqërohet domosdoshmërisht me identifikimin e programit buxhetor që duhet të mbulojë shpenzimin[42].

Strategjia ofron, pra, një kornizë të gjerë dhe të rëndësishme politike, por lidhja ndërmjet masave, shërbimeve konkrete dhe buxheteve mbetet e pjesshme. Harmonizimi me ligjet e reja duhet të shërbejë për ta kthyer atë nga një dokument kryesisht programatik në një instrument më të fortë të planifikimit financiar dhe të llogaridhënies[43].

**Strategjia Kombëtare e Mirëqenies Sociale 2024–2030**
Strategjia Kombëtare e Mirëqenies Sociale 2024–2030 dhe plani i saj i veprimit, të miratuara me VKM nr. 152, datë 13.3.2024, përbëjnë kuadrin kryesor për zhvillimin e asistencës sociale dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror[44]. Strategjia synon përmirësimin e mbulimit dhe efektivitetit të sistemit, zgjerimin e shërbimeve komunitare dhe rezidenciale, forcimin e fondit social, përmirësimin e planeve sociale vendore, standardizimin e shërbimeve dhe ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve.

Lidhja e saj me objektin e këtij studimi është e drejtpërdrejtë, sepse strehëzat emergjente, qendrat rezidenciale, shërbimet komunitare dhe masat e rehabilitimit dhe riintegrimit funksionojnë brenda sistemit të kujdesit shoqëror. Plani i veprimit përmban vlerësime financiare dhe parashikon kombinimin e buxhetit të shtetit, buxheteve vendore, fondit social, programeve të institucioneve përgjegjëse dhe financimit të partnerëve të zhvillimit.

Megjithatë, shërbimet për viktimat e dhunës nuk paraqiten gjithmonë si produkte të dallueshme buxhetore. Ato përfshihen shpesh në kategoritë më të gjera të shërbimeve për grupet në nevojë. Kjo e vështirëson ndjekjen e shumave që planifikohen dhe shpenzohen posaçërisht për strehëzat, mbështetjen psikologjike dhe psikosociale, menaxhimin e rasteve, strehimin kalimtar dhe riintegrimin e viktimave.

Kostimi nuk bën gjithmonë dallimin e nevojshëm ndërmjet investimit fillestar për ngritjen ose përshtatjen e një shërbimi, kostos vjetore të funksionimit, kostos për përfituese dhe financimit të nevojshëm për respektimin e standardeve. Ky është një kufizim veçanërisht i rëndësishëm

[41] Council of Europe, GREVIO. *First Thematic Evaluation Report – Albania: Building trust by delivering support, protection and justice.* UN Doc. GREVIO (2024)6, 17 September 2024, paras. 174–180.
[42] GADC & AWEN. Monitoring Report on the Implementation of the Law on Measures against Violence in Family Relations. Tirana, 2021.
[43] Council of Europe, GREVIO. *First Thematic Evaluation Report – Albania: Building trust by delivering support, protection and justice.* UN Doc. GREVIO (2024)6, 17 September 2024, paras. 174–180.
[44] Republic of Albania, DCM No. 152, dated 13 March 2024, "On the Approval of the National Social Protection Strategy 2024–2030 and Its Action Plan" Official Gazette of Albania. Ministry of Health and Social Protection, *Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024–2030,* at: https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2024/03/13/152.

për strehëzat emergjente. Ekzistenca formale e një strukture ose e një numri të caktuar vendesh nuk provon se janë financuar personeli, siguria, infrastruktura, ushqimi dhe shërbimet mbështetëse të nevojshme për funksionimin e saj të vazhdueshëm.

Strategjia evidenton rolin e bashkive në vlerësimin e nevojave, hartimin e planeve sociale vendore, planifikimin buxhetor, ngritjen dhe administrimin e shërbimeve, bashkëfinancimin përmes fondit social dhe kontraktimin e ofruesve jopublikë. Megjithatë, ndarja e kostove ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore nuk është gjithmonë e qartë apo e garantuar. Kjo krijon rrezikun që përgjegjësitë ligjore t'u transferohen bashkive pa burimet e nevojshme, duke prodhuar pabarazi territoriale në disponueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve.

Problemi bëhet më i dukshëm për shërbimet që mbulojnë disa bashki ose kanë funksion rajonal. Në mungesë të mekanizmave të qartë të financimit ndërvendor dhe bashkëfinancimit, bashkia ku ndodhet fizikisht shërbimi mund të përballojë një pjesë joproporcionale të kostos. Po kështu, financimi përmes fondit social nuk duhet të kufizohet në ngritjen fillestare të një shërbimi, por duhet të sigurojë vazhdimësinë e funksionimit dhe respektimin e standardeve.
Strategjia krijon një bazë të rëndësishme për zhvillimin e sistemit të shërbimeve shoqërore, por nuk e bën ende plotësisht të dukshëm financimin e dedikuar për viktimat e dhunës. Harmonizimi me Ligjin nr. 11/2026 duhet të qartësojë paketën minimale të shërbimeve, ndarjen e përgjegjësive financiare dhe mekanizmat që garantojnë mbulim të barabartë në nivel kombëtar.

**Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030**
Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030[45], plani i saj i veprimit dhe pasaporta e treguesve janë miratuar me VKM nr. 729, datë 13.12.2023. Strategjia synon krijimin e një sistemi të koordinuar për informimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe garantimin e aksesit në drejtësi për viktimat e veprave penale. Ajo mbulon, ndër të tjera, viktimat e dhunës në familje, viktimat e dhunës seksuale, fëmijët viktima ose dëshmitarë dhe viktimat e trafikimit.

Ministria e Drejtësisë është institucioni drejtues, ndërsa përgjegjësi të tjera u caktohen institucioneve të drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe njësive të vetëqeverisjes vendore.
Rëndësia e Strategjisë për këtë studim lidhet kryesisht me kostot e informimit të viktimave, ndihmës dhe përfaqësimit juridik, mbrojtjes gjatë procedimeve, mjediseve të përshtatshme për intervistim, mbështetjes psikologjike, ekzaminimeve mjekësore dhe mjekoligjore, trajnimit të profesionistëve dhe referimit në shërbimet sociale. Ajo nuk duhet të përdoret si dokumenti kryesor për kostimin e strehëzave ose të shërbimeve rezidenciale, pasi fokusi i saj kryesor është aksesi në drejtësi dhe mbrojtja gjatë procedimeve penale.

Plani i veprimit identifikon kosto, institucione përgjegjëse dhe burime të pritshme financimi. Megjithatë, kostot për viktimat e dhunës ndaj grave përfshihen shpesh në kategori më të gjera të viktimave të krimit. Për pasojë, financimi posaçërisht për dhunën ndaj grave nuk mund të veçohet plotësisht. Edhe shpenzimet për trajnime, mbështetje psikologjike dhe referim paraqiten shpesh në mënyrë të agreguar, ndërsa rehabilitimi dhe riintegrimi afatgjatë mbeten jashtë fokusit qendror të Strategjisë[46].

[45] Republic of Albania DCM No. 729, dated 13 December 2023, "On the Approval of the Intersectional Strategy for the Protection of Crime Victims 2024–2030, Its Action Plan and Indicator Passport" Official Gazette for Albania, at: https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2023/12/13/729.
[46] Council of Europe, GREVIO. First Thematic Evaluation Report – Albania: Building trust by delivering support, protection and justice. UN Doc. GREVIO (2024)6, 17 September 2024, paras. 117–123, 174–178.

Harmonizimi me Ligjin nr. 11/2026 duhet të forcojë kostimin e vlerësimit individual dhe të riskut, masave kundër viktimizimit dytësor, trajtimit nga profesionistë të specializuar, referimit të menjëhershëm në strehim, ekzaminimeve mjekësore dhe mjekoligjore falas, zbatimit dhe monitorimit të urdhrave të mbrojtjes, masave kundër dhunës së lehtësuar nga teknologjia, administrimit të të dhënave për dhunën ndaj grave dhe femicidin, si dhe mekanizmave të kompensimit të viktimave.

**Koherenca dhe plotësueshmëria ndërmjet strategjive**

Tri strategjitë mbulojnë hallka të ndryshme të të njëjtit sistem sipas tabelës më poshtë.

**Tabela 1. Koherenca dhe plotësueshmëria ndërmjet strategjive**

| Dokumenti strategjik | Fusha kryesore |
|---|---|
| Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore | Parandalimi, koordinimi, politikat kundër dhunës me bazë gjinore dhe shërbimet e specializuara |
| Strategjia Kombëtare e Mirëqenies Sociale | Shërbimet e kujdesit shoqëror, strehimi, rehabilitimi dhe riintegrimi |
| Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit | Informimi, mbrojtja gjatë procedimeve, ndihma juridike dhe aksesi në drejtësi |

***Burimi: Analiza e autorëve mbi tri strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit e kornizat e treguesve që i shoqërojnë.***

Kjo ndarje mund të mbështesë një përgjigje gjithëpërfshirëse vetëm nëse masat, përgjegjësitë, treguesit dhe buxhetet koordinohen ndërmjet dokumenteve. Aktualisht, e njëjta ndërhyrje mund të paraqitet në disa strategji pa u përcaktuar qartë institucioni drejtues, programi financues, pjesa e kostos që duhet të mbulojë secili institucion dhe mënyra e raportimit të rezultateve. Ky rrezik është veçanërisht i pranishëm në fushat e trajnimit të profesionistëve, ndërgjegjësimit, mbledhjes së të dhënave, ndihmës juridike, mbështetjes psikologjike, menaxhimit të rasteve dhe riintegrimit.

Për të shmangur fragmentimin dhe numërimin e dyfishtë, nevojitet një hartë e përbashkët ndërinstitucionale që ta lidhë çdo masë me detyrimin ligjor përkatës, rezultatin e pritshëm, institucionin drejtues, programin dhe produktin buxhetor, burimin e financimit, numrin e përfitueseve dhe treguesit e performancës. Kjo hartë duhet të mundësojë ndjekjen e shumës së planifikuar, alokuar, disbursuar dhe shpenzuar për çdo shërbim.

**Tabela 2. Vlerësimi i konsoliduar**

| Kriteri | Barazia gjinore | Mirëqenia sociale | Mbrojtja e viktimave të krimit |
|---|---|---|---|
| Përmban masa të drejtpërdrejta kundër dhunës | Po | Po, brenda sistemit të shërbimeve sociale | Po, brenda sistemit të mbrojtjes së viktimave |
| Përmban kosto për të gjitha masat | Pjesërisht | Pjesërisht | Pjesërisht |
| Veçon kostot e shërbimeve të specializuara | Jo plotësisht | Jo plotësisht | Jo plotësisht |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Përcakton institucionet përgjegjëse | Po | Po | Po |
| Identifikon programin buxhetor financues | Pjesërisht | Pjesërisht | Pjesërisht |
| Dallon financimin e siguruar nga financimi i pritshëm | Jo plotësisht | Jo plotësisht | Jo plotësisht |
| Garantimi i mbulimit kombëtar vetëm përmes financimit public | Jo plotësisht | Jo plotësisht | Jo plotësisht |
| Përmban kosto të dallueshme për riintegrimin | Pjesërisht | Pjesërisht | Në mënyrë të kufizuar |
| Pasqyron plotësisht ligjet e reja | Jo; kërkohet harmonizim | Jo; kërkohet harmonizim | Jo; kërkohet harmonizim |
| Lejon ndjekjen e shpenzimit faktik sipas shërbimit | Jo në mënyrë sistematike | Jo në mënyrë sistematike | Jo në mënyrë sistematike |

**Burimi: Analiza e autorëve mbi tri strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit e kornizat e treguesve që i shoqërojnë.**

### Vlerësimi i përgjithshëm i financimit strategjik

Analiza tregon se Shqipëria disponon një kuadër relativisht të gjerë strategjik për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave dhe ofrimin e shërbimeve. Problemi kryesor nuk është mungesa e plotë e masave, por fragmentimi i tyre ndërmjet dokumenteve, institucioneve, niveleve të qeverisjes dhe burimeve të financimit.

Kostot nuk përcaktohen sistematikisht në nivel shërbimi dhe përdorimi i kostove standarde për njësi mbetet i kufizuar. Shpenzimet paraqiten shpesh në kategori të përgjithshme, duke e bërë të vështirë identifikimin e shumës së planifikuar dhe të shpenzuar për secilin shërbim të specializuar. Nuk është gjithmonë e qartë nëse kostot e përfshira në planet e veprimit mbulohen nga fonde publike të miratuara apo varen nga financimi i ardhshëm dhe mbështetja e donatorëve.

Gjithashtu, lidhja ndërmjet masës strategjike dhe programit përkatës buxhetor mbetet e pjesshme. Kjo është veçanërisht problematike kur përgjegjësia ndahet ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Në mungesë të një formule të qartë financimi, kapaciteti fiskal i bashkisë mund të përcaktojë nivelin e mbrojtjes që merr viktima, duke krijuar pabarazi territoriale.

Përcaktimi i një institucioni si përgjegjës për zbatimin nuk provon se ky institucion ka një fond të dedikuar dhe të mjaftueshëm. Po kështu, përfshirja e një vlere në një plan veprimi nuk provon se ajo është miratuar, disbursuar ose shpenzuar. Për këtë arsye, analiza financiare duhet të dallojë qartë ndërmjet kostos së vlerësuar, financimit të planifikuar, alokimit të miratuar, shumës së disbursuar, shpenzimit faktik dhe rezultatit të arritur.

Kur dokumentacioni nuk mundëson këtë krahasim, përfundimi metodologjik duhet të jetë se të dhënat janë të pamjaftueshme. Mungesa e informacionit nuk duhet të interpretohet automatikisht si provë se fondet nuk janë alokuar ose shpenzuar; ajo dëshmon, megjithatë, mungesë transparence dhe gjurmueshmërie të mjaftueshme financiare.

### Përfundime dhe drejtimet kryesore të harmonizimit

Strategjitë kombëtare krijojnë një bazë të rëndësishme për planifikimin e masave kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, por nuk formojnë ende një kuadër të vetëm, të koordinuar dhe plotësisht të gjurmueshëm financiar. Ligji nr. 64/2025 dhe Ligji nr. 11/2026 kërkojnë kalimin nga një planifikim i përgjithshëm, i orientuar kryesisht drejt aktiviteteve, në një qasje të bazuar në të drejta, standarde shërbimi, mbulim territorial, kosto të matshme dhe rezultate të verifikueshme.

Në këtë kuadër, harmonizimi duhet të përqendrohet në disa drejtime themelore:

- përcaktimin e një pakete minimale kombëtare të shërbimeve që duhet të jetë e aksesueshme në të gjithë territorin;
- vendosjen e standardeve dhe kostove për njësi për çdo lloj shërbimi;
- lidhjen e çdo mase me institucionin dhe programin konkret buxhetor;
- ndarjen e qartë të përgjegjësive financiare ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore;
- krijimin e mekanizmave barazues për bashkitë me kapacitete të kufizuara dhe për shërbimet që mbulojnë disa bashki;
- garantimin e financimit publik të vazhdueshëm për shërbimet që përbëjnë detyrime ligjore;
- krijimin e mekanizmave shumëvjeçarë për kontraktimin e organizatave të specializuara;
- monitorimin e mbulimit, aksesueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve krahas realizimit financiar;
- raportimin e konsoliduar të kostove, alokimeve, disbursimeve, shpenzimeve dhe rezultateve.

Kostimi i kryer në kuadër të këtij studimi duhet të përdoret jo vetëm për të dokumentuar shpenzimet ekzistuese, por edhe për të vlerësuar burimet që nevojiten për zbatimin e plotë të legjislacionit kombëtar dhe të Konventës së Stambollit. Diferenca ndërmjet kostos normative të shërbimeve, financimit të miratuar dhe shpenzimit faktik përbën bazën për identifikimin e hendekut real financiar të sistemit të mbrojtjes, mbështetjes, rehabilitimit dhe riintegrimit të viktimave.

## Detyrimet ligjore për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në financimin e masave kundër dhunës me bazë gjinore

### Qëllimi dhe objekti i analizës

Kjo pjesë analizon mënyrën se si kuadri ligjor dhe sistemi i menaxhimit të financave publike në Shqipëri kërkojnë integrimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në planifikimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e masave kundër dhunës me bazë gjinore. Vëmendja përqendrohet te përgjegjësitë institucionale, integrimi i objektivave gjinorë në Programin Buxhetor Afatmesëm, identifikimi dhe gjurmimi i financimit, si dhe raportimi mbi rezultatet e arritura.
Detyrimet që lidhen me ngritjen, organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të përgjithshme dhe të specializuara trajtohen në pjesën përkatëse të analizës së kuadrit ligjor. Për të shmangur përsëritjen, ky seksion shqyrton kryesisht mënyrën se si këto detyrime duhet të përkthehen në objektiva politikash, programe buxhetore, produkte të matshme, tregues performance dhe alokime financiare të identifikueshme.
Analiza mbështetet në parimin se njohja e një të drejte ose përcaktimi i një përgjegjësie institucionale nuk është i mjaftueshëm nëse nuk shoqërohet me burimet e nevojshme për zbatimin e saj. Për këtë arsye, vlerësohet nëse sistemi buxhetor mundëson krijimin e një

lidhjeje të verifikueshme ndërmjet detyrimit ligjor, shërbimit që duhet të ofrohet, kostos së tij, financimit të miratuar, shpenzimit faktik dhe rezultatit të arritur për viktimat.

**Baza ligjore e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor**

Ligji nr. 64/2025 "Për barazinë gjinore"[47] përbën bazën kryesore dhe më të përditësuar ligjore për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor. Ai e përcakton këtë të fundit si zbatimin e integrimit gjinor në procesin buxhetor, duke kërkuar vlerësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve nga këndvështrimi gjinor dhe ristrukturimin e tyre në funksion të arritjes së barazisë ndërmjet grave dhe burrave.

Sipas nenit 12, institucionet publike qendrore dhe vendore duhet ta zbatojnë buxhetimin e përgjigjshëm gjinor përgjatë të gjithë ciklit buxhetor: gjatë planifikimit dhe programimit, menaxhimit dhe zbatimit të buxhetit, monitorimit të programeve, vlerësimit të rezultateve dhe raportimit mbi përdorimin e burimeve publike. Ky formulim e shtrin detyrimin përtej përfshirjes formale të një objektivi gjinor në dokumentet buxhetore. Institucionet duhet të dëshmojnë se si politikat dhe shpenzimet e tyre adresojnë pabarazitë gjinore, cilat grupe përfitojnë dhe nëse burimet e përdorura kanë prodhuar rezultatet e synuara.

Ligji kërkon gjithashtu vlerësimin e ndikimit gjinor të projektligjeve, prodhimin dhe përdorimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe integrimin e perspektivës gjinore në politikat, programet, projektet dhe buxhetet publike. Këto kërkesa kanë rëndësi të veçantë për masat kundër dhunës me bazë gjinore, pasi krijojnë bazën ligjore për identifikimin e nevojave, përllogaritjen paraprake të kostove, përcaktimin e grupeve të synuara dhe matjen e mbulimit dhe të rezultateve.

Kuadri plotësohet nga Ligji nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, aktet që rregullojnë përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe udhëzimet vjetore të Ministrisë së Financave[48]. Këto instrumente përcaktojnë mënyrën se si objektivat e politikave duhet të lidhen me programet buxhetore, produktet, treguesit e performancës dhe burimet financiare.

Në nivel vendor, Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, duhet të zbatohet së bashku me Ligjin nr. 64/2025 dhe udhëzimet për përgatitjen e buxheteve vendore[49]. Bashkitë duhet t'i lidhin nevojat e identifikuara në territor me planet sociale vendore, programet buxhetore, shërbimet e planifikuara dhe burimet e alokuara. Kjo është thelbësore për masat kundër dhunës, pasi një pjesë e shërbimeve sociale, mekanizmave të referimit dhe mbështetjes për viktimat organizohet ose financohet në nivel vendor.

Ligji nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, vendos parimet e përgjegjshmërisë menaxheriale, kontrollit të brendshëm dhe përdorimit të rregullt, ekonomik, efikas dhe efektiv të fondeve publike[50]. Megjithëse ky ligj mbështet disiplinën financiare dhe llogaridhënien, ai nuk përbën burimin kryesor të detyrimit specifik për

---

[47] Ligji nr. 64/2025, datë 06.11.2025, "Për barazinë gjinore" https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/c94610c7-8f7f-4274-a3a7-bdf6ff2459f6

[48] Republic of Albania, Law No. 64/2025, dated 6 November 2025, "On Gender Equality" (Për barazinë gjinore), repealing Law No. 9970/2008, dated 24 July 2008, "On Gender Equality in Society", Official Publications Centre (Qendra e Botimeve Zyrtare) https://shendetesia.gov.al/mireqenia-sociale-ligje/

[49] Republic of Albania, Law No. 68/2017, dated 27 April 2017, "On Local Self-Government Finance", as amended by Law No. 40/2023, Ministry of Finance. https://financa.gov.al/financat-vendore-2/

[50] Republic of Albania, Law No. 10296, dated 8 July 2010, "On Financial Management and Control", as amended by Laws No. 110/2015 and No. 14/2023, Official Gazette No. 97/2010, Ministry of Finance https://arkiva.financa.gov.al/ligji-2/

buxhetimin e përgjigjshëm gjinor. Ky detyrim rrjedh drejtpërdrejt nga Ligji nr. 64/2025 dhe konkretizohet përmes legjislacionit dhe udhëzimeve buxhetore.
Në tërësi, kuadri ligjor krijon bazën e nevojshme për integrimin e perspektivës gjinore në sistemin e financave publike. Megjithatë, efektiviteti i tij varet nga mënyra se si këto dispozita përkthehen në kërkesa konkrete për kostimin, alokimin, gjurmimin dhe raportimin e shpenzimeve.

**Përgjegjësitë institucionale**
Zbatimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor kërkon një ndarje funksionale të përgjegjësive ndërmjet institucioneve që hartojnë politikat e barazisë gjinore, institucioneve që drejtojnë procesin buxhetor dhe institucioneve që administrojnë programet dhe shërbimet.

Ministria e Financave ka përgjegjësinë kryesore për kuadrin procedural të përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit. Ajo përfshin kërkesat për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në udhëzimet e përgatitjes së buxhetit dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm, përcakton mënyrën e paraqitjes së objektivave, produkteve dhe treguesve gjinorë, shqyrton kërkesat buxhetore dhe administron sistemet e raportimit financiar dhe të performancës. Roli i saj nuk kufizohet në verifikimin formal të dokumenteve, por përfshin edhe vlerësimin e cilësisë së lidhjes ndërmjet objektivit gjinor, produktit të financuar, treguesit dhe burimeve të kërkuara.
Ministria përgjegjëse për barazinë gjinore, aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ka funksion koordinues dhe monitorues për politikat e barazisë gjinore dhe masat kundër dhunës me bazë gjinore. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, ajo duhet të mbështesë institucionet në analizimin e nevojave gjinore, formulimin e objektivave, hartimin e treguesve dhe vlerësimin e ndikimit të politikave dhe shpenzimeve.

Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera publike janë përgjegjëse për integrimin e perspektivës gjinore në programet që administrojnë. Ato duhet të përcaktojnë rezultatet që synojnë të arrijnë, shërbimet dhe produktet që do të financohen, numrin e pritshëm të përfitueseve, kostot përkatëse dhe treguesit që do të përdoren për matjen e performancës. Gjithashtu, duhet të raportojnë jo vetëm mbi realizimin financiar, por edhe mbi rezultatet konkrete për gratë dhe vajzat.

Ligji nr. 64/2025 parashikon funksione dhe struktura institucionale për zbatimin e barazisë gjinore. Terminologjia, pozicioni dhe detyrat e strukturave ose personave përgjegjës duhet të harmonizohen me ligjin e ri dhe me aktet nënligjore që do të miratohen në zbatim të tij. Përgjegjësia për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor nuk duhet t'i ngarkohet vetëm një punonjësi ose strukture të barazisë gjinore. Ajo duhet të integrohet në punën e njësive të politikave, financës, statistikave, monitorimit dhe menaxhimit të programeve.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë përgjegjësi të drejtpërdrejta për planifikimin dhe financimin e një pjese të shërbimeve sociale dhe mbrojtëse. Këto përgjegjësi duhet të pasqyrohen në planet sociale vendore, programet buxhetore, fondin social vendor dhe mekanizmat e monitorimit. Kur shërbimet financohen bashkërisht nga qeverisja qendrore, bashkitë dhe donatorët, duhet të identifikohen qartë burimi i financimit, institucioni përgjegjës dhe pjesa e financimit që është realisht e siguruar.

Kjo ndarje përgjegjësish kërkon koordinim të vazhdueshëm. Pa një lidhje funksionale ndërmjet institucioneve të politikave, financës dhe zbatimit, ekziston rreziku që objektivat gjinorë të mbeten të shkëputur nga vendimmarrja buxhetore ose që përgjegjësitë ligjore t'u transferohen institucioneve pa burimet e nevojshme.

**Integrimi në Programin Buxhetor Afatmesëm**

Programi Buxhetor Afatmesëm[51] është instrumenti kryesor për përkthimin e politikave të barazisë gjinore dhe detyrimeve kundër dhunës në angazhime financiare shumëvjeçare. Udhëzimet për përgatitjen e tij kanë kërkuar prej disa vitesh që institucionet buxhetore të përfshijnë objektiva, produkte dhe tregues të lidhur me barazinë gjinore, të mbështetur, kur është e mundur, në të dhëna të ndara sipas gjinisë.

Integrimi efektiv i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm duhet të fillojë me identifikimin e problemit dhe të pabarazisë gjinore. Më pas duhet të përcaktohen grupi i synuar, rezultati i pritshëm, shërbimi që do të financohet dhe kostoja e tij. Vetëm pas kësaj mund të identifikohet burimi financiar, të vendosen treguesit bazë dhe objektivat vjetorë dhe të miratohen alokimet përkatëse. Zbatimi duhet të pasohet nga gjurmimi i disbursimeve dhe shpenzimeve, monitorimi i performancës dhe vlerësimi i ndikimit.
Këto faza duhet të dallohen qartë. Një kërkesë buxhetore nuk përbën financim të miratuar; një alokim i miratuar nuk provon se fondet janë disbursuar; ndërsa disbursimi nuk dëshmon se shpenzimi ka prodhuar rezultatin e synuar. Po kështu, monitorimi i shpenzimit pas përfundimit të vitit nuk mund ta zëvendësojë përllogaritjen paraprake të kostos së një mase ose shërbimi.

Analizat mbi zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në Shqipëri tregojnë se vendi ka bërë përparim në institucionalizimin formal të tij, veçanërisht përmes udhëzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm, etiketimit gjinor dhe përfshirjes së objektivave gjinorë në programet buxhetore. Megjithatë, cilësia e integrimit ndryshon ndërmjet institucioneve dhe lidhja ndërmjet problemit gjinor, produktit të financuar, treguesit dhe rezultatit nuk është gjithmonë e plotë.

Edhe të dhënat mbi numrin e programeve të konsideruara "të përgjigjshme gjinore" duhet të interpretohen me kujdes. Dokumente të ndryshme mund të numërojnë kërkesat buxhetore, objektivat gjinorë, programet e etiketuara ose programet me tregues gjinorë. Këto kategori nuk janë domosdoshmërisht të krahasueshme. Për më tepër, përqindja e përgjithshme e buxhetit e klasifikuar si e përgjigjshme gjinore nuk tregon automatikisht shumën e shpenzuar për masat kundër dhunës me bazë gjinore dhe as cilësinë e rezultateve të arritura.

### AFMIS-i, etiketimi gjinor dhe gjurmueshmëria e financimit

Sistemi Shqiptar i Informacionit të Menaxhimit Financiar mbështet përgatitjen dhe monitorimin e programeve buxhetore, duke mundësuar regjistrimin e objektivave, produkteve, treguesve dhe alokimeve. Etiketimi gjinor në këtë sistem ndihmon në identifikimin e programeve ose produkteve që synojnë barazinë gjinore.

Megjithatë, etiketimi është një instrument identifikimi dhe jo provë e mjaftueshmërisë ose efektivitetit të financimit. Vlera e tij varet nga cilësia dhe hollësia e informacionit të regjistruar. Për të qenë i dobishëm në monitorimin e masave kundër dhunës me bazë gjinore, etiketimi duhet të shoqërohet me një përkufizim të qartë të shërbimit, grupin e synuar, treguesit bazë dhe objektivat vjetorë, një lidhje të drejtpërdrejtë me alokimin buxhetor dhe raportimin mbi shpenzimin faktik, mbulimin territorial dhe rezultatet.

Një program i etiketuar si gjinor mund të përmbajë vetëm një komponent të kufizuar të lidhur me barazinë gjinore. Për këtë arsye, vlera e përgjithshme e programit nuk duhet të paraqitet

[51] Ministry of Finance and Economy of Albania. (2024). *Tabela 4 – Treguesit fiskalë 2022–2027.* Available at: https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/Tabela-4-Treguesit-fiskale-2022-2027.xls

automatikisht si shpenzim për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor ose për masat kundër dhunës. Kur është e mundur, gjurmimi duhet të kryhet në nivel produkti, aktiviteti ose shërbimi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për programet e mëdha sociale, shëndetësore, të drejtësisë ose të rendit, brenda të cilave shërbimet për viktimat përbëjnë vetëm një pjesë të shpenzimeve.

**Zbatimi për masat kundër dhunës me bazë gjinore**

Ligji nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje" zgjeron ndjeshëm detyrimet materiale dhe institucionale të shtetit. Në zbatim të Ligjit nr. 64/2025[52], këto detyrime duhet të përkthehen në objektiva, produkte, tregues dhe fonde të identifikueshme në Programin Buxhetor Afatmesëm dhe në buxhetet vjetore.

Kjo do të thotë se institucionet përgjegjëse duhet të jenë në gjendje të përcaktojnë se cilat detyrime ligjore mbulohen nga secili program buxhetor, sa është kostoja e zbatimit, cila pjesë financohet nga buxheti qendror, buxheti vendor ose burimet e jashtme dhe sa fonde janë miratuar, disbursuar dhe shpenzuar. Raportimi duhet të tregojë gjithashtu numrin dhe profilin e përfitueseve, shpërndarjen territoriale të shërbimeve dhe rezultatet e arritura për mbrojtjen, rikuperimin dhe riintegrimin e viktimave.

Në këtë drejtim, rëndësi të veçantë ka neni 45 i Ligjit nr. 11/2026, i cili lidh organizimin e trajnimit të vazhdueshëm të profesionistëve me parashikimin e buxhetit të nevojshëm nga institucionet përgjegjëse. Kjo dispozitë ilustron parimin se një detyrim ligjor nuk duhet të konsiderohet i zbatueshëm pa një planifikim financiar përkatës. E njëjta logjikë duhet të zbatohet për strehimin emergjent, këshillimin, ndihmën juridike, kujdesin shëndetësor, menaxhimin e rasteve, rehabilitimin dhe riintegrimin.

Dispozitat për financimin vendor dhe fondin social vendor kërkojnë gjithashtu që bashkitë të mos kufizohen në përfshirjen formale të shërbimeve në planet sociale. Ato duhet të identifikojnë burimin, shumën, afatin dhe mekanizmin konkret të financimit. Kur kapaciteti fiskal vendor është i pamjaftueshëm, duhet të evidentohen burimet plotësuese nga buxheti qendror ose mekanizmat e bashkëfinancimit.

Varësia nga donatorët duhet të paraqitet veçmas dhe me transparencë. Financimi i jashtëm mund të mbështesë zhvillimin, zgjerimin ose përmirësimin e shërbimeve, por nuk duhet të trajtohet si financim i garantuar për të gjithë periudhën kur bazohet në projekte të kufizuara në kohë. Për shërbimet që burojnë nga detyrime ligjore të vazhdueshme duhet të identifikohet një nivel bazë financimi publik që garanton funksionimin e tyre edhe pas përfundimit të projekteve të donatorëve.

**Monitorimi dhe raportimi**

Shqipëria ka zhvilluar mekanizma për integrimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në fazën e planifikimit, por gjurmimi i zbatimit dhe vlerësimi i rezultateve mbeten më pak të konsoliduara. Ministria e Financave publikoi për vitin 2020 një raport të posaçëm për monitorimin e performancës së buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, por kjo praktikë nuk rezulton të jetë vijuar rregullisht me të njëjtën strukturë dhe hollësi.

[52] Ligji nr. 64/2025, datë 06.11.2025, "Për barazinë gjinore"
https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/c94610c7-8f7f-4274-a3a7-bdf6ff2459f6

Raportet e zbatimit të buxhetit paraqesin përgjithësisht informacion në nivel programi ose sektori dhe jo sipas produkteve të lidhura me barazinë gjinore ose shërbimeve kundër dhunës. Për pasojë, shpesh është e vështirë të vendoset një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet alokimit të paraqitur në Programin Buxhetor Afatmesëm, objektivit gjinor, shpenzimit faktik, numrit të përfitueseve dhe rezultatit të arritur.

Përmirësimi i monitorimit kërkon që raportet periodike të dallojnë të paktën pesë faza financiare: kërkesën buxhetore, alokimin e miratuar, financimin e disbursuar, shpenzimin faktik dhe rezultatin e arritur. Raportimi duhet të përfshijë tregues për mbulimin, aksesueshmërinë, cilësinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve, jo vetëm tregues të realizimit financiar.

Të dhënat duhet të ndahen sipas gjinisë dhe, kur është e nevojshme, sipas moshës, aftësisë së kufizuar, territorit, përkatësisë etnike dhe karakteristikave të tjera që mund të ndikojnë në akses. Në këtë mënyrë, monitorimi do të tregonte jo vetëm sa është shpenzuar, por edhe nëse fondet kanë arritur te grupet që përballen me pengesat më të mëdha dhe nëse kanë përmirësuar realisht mbrojtjen e tyre.

**Vlerësimi i përgjithshëm**

**Tabela 3. Vlerësim i përgjithshëm**

| Kriteri | Vlerësimi |
|---|---|
| Ekziston detyrim ligjor për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor | Po. Ligji nr. 64/2025[53] e përcakton shprehimisht në nenin 12. |
| Detyrimi zbatohet në nivel qendror dhe vendor | Po ligjërisht, por kapacitetet dhe cilësia e zbatimit ndryshojnë ndërmjet institucioneve. |
| Përgjegjësitë institucionale janë të përcaktuara | Kryesisht po. Nevojitet harmonizim i mëtejshëm nënligjor dhe koordinim më i fortë ndërinstitucional. |
| Objektivat gjinorë integrohen në Programin Buxhetor Afatmesëm | Po, përmes udhëzimeve dhe etiketimit gjinor, por cilësia e objektivave dhe treguesve nuk është e njëtrajtshme. |
| Financimi për masat kundër dhunës identifikohet veçmas | Pjesërisht. Shumë ndërhyrje përfshihen në programe më të gjera sociale, shëndetësore, të drejtësisë ose të rendit. |
| Shpenzimi faktik mund të gjurmohet | Pjesërisht. Gjurmueshmëria në nivel produkti, aktiviteti ose shërbimi mbetet e kufizuar. |
| Monitorohen rezultatet dhe ndikimi | Në mënyrë të pamjaftueshme. Raportimi përqendrohet më shumë te alokimet dhe realizimi financiar. |
| Financimi publik dallohet nga financimi i donatorëve | Jo gjithmonë. Nevojitet raportim i veçantë për buxhetin qendror, buxhetet vendore dhe burimet e jashtme. |
| Kuadri lejon vlerësimin e mjaftueshmërisë së financimit | Vetëm pjesërisht, për shkak të mungesës së kostove standarde dhe të raportimit të lidhur me rezultatet. |

**Përfundim**

[53] Ligji nr. 64/2025, datë 06.11.2025, "Për barazinë gjinore"
https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/c94610c7-8f7f-4274-a3a7-bdf6ff2459f6

Shqipëria disponon tashmë një bazë më të fortë ligjore për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor. Ligji nr. 64/2025 e shndërron atë në një detyrim që shtrihet përgjatë gjithë ciklit buxhetor, ndërsa Ligji nr. 11/2026 përcakton detyrime konkrete për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen, mbështetjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave. Këto detyrime duhet të mbështeten me burime publike të mjaftueshme, të parashikueshme dhe të qëndrueshme.
Sfida kryesore nuk është më vetëm përfshirja formale e objektivave gjinorë në Programin Buxhetor Afatmesëm. Çështja thelbësore është krijimi i një lidhjeje të matshme dhe të verifikueshme ndërmjet detyrimit ligjor, shërbimit të planifikuar, kostos së tij, burimit të financimit, alokimit të miratuar, shpenzimit faktik dhe rezultatit të arritur.
Pa këtë lidhje, nuk mund të vlerësohet nëse financimi është i mjaftueshëm, nëse fondet janë përdorur për qëllimin e përcaktuar dhe nëse ato kanë përmirësuar realisht sigurinë, mbrojtjen dhe pavarësinë e viktimave. Për rrjedhojë, forcimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në këtë fushë kërkon jo vetëm etiketim më të mirë buxhetor, por edhe kostim të standardizuar të shërbimeve, gjurmim në nivel produkti, të dhëna të disagreguara dhe raportim të lidhur drejtpërdrejt me rezultatet.

### Ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor: Mundësitë për të ndikuar në procesin buxhetor

Kjo pjesë synon të mbështesë kontributin e bazuar në të dhëna dhe prova gjatë procesit buxhetor, duke paraqitur në mënyrë të përmbledhur kalendarin e përgatitjes së buxhetit në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë, ajo shqyrton afatet gjatë të cilave projektbuxhetet afatmesme dhe vjetore:

1. përgatiten nga institucionet përkatëse përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për parandalimin dhe trajtimin e DhBGj-së;
2. i nënshtrohen konsultimit publik;
3. shqyrtohen dhe miratohen nga autoritetet përgjegjëse.

Sipas ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ministritë e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe disa institucione të pavarura kanë detyrimin të përgatisin Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA). Nëpërmjet PBA-së, planifikimi i politikave lidhet me planifikimin financiar për një periudhë trevjeçare, duke përcaktuar objektivat, programet, produktet, treguesit e performancës dhe burimet e nevojshme për realizimin e tyre.[54] Sipas këtij kuadri, afatet e procesit buxhetor për njësitë e qeverisjes qendrore përcaktohen nga kalendari i PBA-së, i hartuar nga Ministria e Financave dhe i miratuar çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Një përmbledhje e procesit buxhetor është:

- **Përgatitja nga institucionet përkatëse:** Ministritë dhe institucionet e tjera që ofrojnë shërbime përgatisin projektbuxhetet e tyre gjatë periudhës prill–qershor, si pjesë e procesit të PBA-së. Në këtë fazë, ato duhet të integrojnë analizën gjinore, të përcaktojnë të paktën një objektiv gjinor dhe treguesit kryesorë të performancës.
- **Konsultimi publik:** Institucioneve u kërkohet të zhvillojnë konsultime publike për projektbuxhetet e tyre gjatë periudhës korrik–gusht, duke siguruar kontributin e shoqërisë civile.
- **Miratimi:** PBA-ja finalizohet në shtator dhe ligji i buxhetit vjetor i paraqitet Kuvendit në mesin e muajit tetor. Diskutimet parlamentare dhe miratimi zhvillohen gjatë periudhës tetor–dhjetor, ndërsa buxheti përfundimtar miratohet përpara përfundimit të vitit financiar.

[54] Republic of Albania, Law No. 9936, dated 26 June 2008, "On the Management of the Budgetary System in the Republic of Albania", as amended by Law No. 114/2012, Law No. 57/2016, and subsequent normative acts, Government of Albania. https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2024/08/Ligj-nr.-9936-date-26.06.2008-Per-menaxhimin-e-sistemit-buxhetor-ne-Republiken-e-Shqiperise.pdf

Në nivel vendor, procesi i përgatitjes së buxhetit rregullohet nga Ligji për financat e vetëqeverisjes vendore dhe nga "Udhëzimet standarde për PBA-në në nivel vendor" të Ministrisë së Financave të vitit 2018. Procesi i buxhetimit bashkiak zhvillohet në tri faza kryesore:

1. **Planifikimi dhe miratimet fillestare (dhjetor–mars):** Këshilli bashkiak miraton kalendarin buxhetor, shqyrton parashikimet e të ardhurave dhe miraton tavanet paraprake të shpenzimeve. Më pas, kryetari i bashkisë nxjerr udhëzimet për përgatitjen e buxhetit.
2. **Hartimi dhe paraqitja (prill–korrik):** Strukturat bashkiake përgatisin PBA-në, të cilën kryetari i bashkisë ia paraqet Ministrisë së Financave. Pas shqyrtimit dhe përfshirjes së rekomandimeve të Ministrisë së Financave, këshilli bashkiak u komunikon të gjitha njësive shpenzuese tavanet e përditësuara të shpenzimeve.
3. **Rishikimi dhe miratimi përfundimtar (shtator–dhjetor):** Procesi përfundon me miratimin nga këshilli bashkiak të PBA-së përfundimtare dhe të buxhetit vjetor, të cilat më pas publikohen përpara përfundimit të vitit.

**Përfundime**

Në përgjithësi, kuadri ligjor dhe i politikave i Shqipërisë tregon përputhshmëri të fortë me angazhimet ndërkombëtare, përfshirë Konventën e Stambollit dhe CEDAW-n, dhe krijon një kuadër institucional gjithëpërfshirës për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës me bazë gjinore (DhBGj). Megjithatë, këto angazhime nuk shoqërohen ende me një kuadër financimi mjaftueshëm koherent dhe të qëndrueshëm.

Megjithëse buxhetimi i përgjigjshëm gjinor është i detyrueshëm për të gjitha institucionet publike, DhBGj-ja pasqyrohet vetëm pjesërisht në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), me alokime të përqendruara në një numër të kufizuar sektorësh dhe shërbimesh. Në të gjitha strategjitë dhe planet e veprimit të shqyrtuara, shumë ndërhyrje për DhBGj-në nuk janë kostuar plotësisht, alokimet e dedikuara buxhetore shpesh mungojnë dhe financimi bashkiak përjashtohet në masë të madhe nga dokumentet e planifikimit. Si rezultat, kërkesat për burime për zbatimin e angazhimeve kombëtare nuk mund të vlerësohen në mënyrë gjithëpërfshirëse. Analiza e buxheteve vjetore tregon më tej se financimi për shërbimet sociale të lidhura me DhBGj-në është i fragmentuar në disa mekanizma buxhetorë, pa zëra të dedikuar buxhetorë ose raportim mjaftueshëm të disagreguar. Kjo e bën të vështirë identifikimin e nivelit të përgjithshëm të shpenzimeve publike të dedikuara për DhBGj-në, vlerësimin nëse financimi është i mjaftueshëm ose monitorimin efektiv të zbatimit. Mbështetja te financimi i donatorëve dhe bashkëfinancimi bashkiak zvogëlon më tej parashikueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e ofrimit të shërbimeve, ndërsa informacioni për shpenzimet mbetet tepër i kufizuar për të vlerësuar nëse alokimet e planifikuara janë përkthyer në shpenzime faktike.


Në përgjithësi, gjetjet tregojnë një hendek të konsiderueshëm ndërmjet angazhimeve politike të Shqipërisë dhe mekanizmave financiarë që mbështesin zbatimin e tyre. Forcimi i kostimit të ndërhyrjeve për DhBGj-në, përmirësimi i integrimit të DhBGj-së brenda PBA-së, vendosja e klasifikimit dhe raportimit buxhetor më transparent dhe sigurimi i financimit të parashikueshëm si në nivel qendror, ashtu edhe bashkiak, do të forconin në mënyrë të konsiderueshme qëndrueshmërinë dhe llogaridhënien e ofrimit të shërbimeve për DhBGj-në. Perspektiva e favorshme makroekonomike e Shqipërisë sugjeron se ekziston hapësirë fiskale për të rritur në mënyrë progresive investimet në shërbimet e specializuara për DhBGj-në, me kusht që alokimet e ardhshme buxhetore të udhëhiqen nga parimet e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, për të cilat vendi është angazhuar.

## Angazhimet buxhetore afatmesme për adresimin e dhunës me bazë gjinore

Ky seksion shqyrton masën në të cilën financimi për adresimin e dhunës me bazë gjinore pasqyrohet në objektivat e kuadrit buxhetor afatmesëm, si dhe nëse janë përcaktuar tregues, vlera bazë dhe objektiva të matshëm për vlerësimin e progresit.

Gjatë periudhës 2022–2027, ecuria fiskale e Shqipërisë pasqyron një rritje të qëndrueshme si të të ardhurave, ashtu edhe të shpenzimeve publike, në përputhje me objektivat e planifikimit fiskal afatmesëm të vendit.[55]

**Grafiku 1. Shqipërie: Trendet fiskale Afatmesme (milionë lekë)**




**Burimi:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Shqipërisë (2024), Tabela 4 "Treguesit fiskalë 2022–2027".
**Shënim:** Vlerat paraqiten në milionë lekë. Të dhënat për periudhën 2024–2027 janë parashikime.

Të ardhurat e përgjithshme parashikohet të rriten nga 572,8 miliardë lekë në vitin 2022 në 846,7 miliardë lekë në vitin 2027, çka përfaqëson një rritje kumulative prej rreth 48%. Kjo prirje mbështetet në forcimin e administrimit tatimor, zgjerimin e aktivitetit ekonomik dhe përfitimet e pritshme nga formalizimi i ekonomisë dhe përmirësimi i përmbushjes së detyrimeve tatimore. Gjatë së njëjtës periudhë, shpenzimet e përgjithshme parashikohet të rriten nga 651,0 miliardë lekë në vitin 2022 në 888,1 miliardë lekë në vitin 2027, që përkon me një rritje kumulative prej rreth 36%. Megjithëse niveli i shpenzimeve mbetet më i lartë se ai i të ardhurave, hendeku fiskal ngushtohet proporcionalisht me kalimin e kohës, duke treguar përparim gradual drejt konsolidimit fiskal.

Rritja e parashikuar e të ardhurave dhe kontrolli i rritjes së shpenzimeve mund të krijojnë hapësirë të mundshme për prioritizimin strategjik të burimeve, përfshirë financimin e

[55] Ministry of Finance and Economy of Albania. (2024). *Tabela 4 – Treguesit fiskalë 2022–2027* Available at: https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/Tabela-4-Treguesit-fiskale-2022-2027.xls

shërbimeve sociale dhe masave të lidhura me barazinë gjinore. Rritja e të ardhurave mund të ofrojë mundësi për shtimin e alokimeve buxhetore për shërbime prioritare, si kujdesi shëndetësor, arsimi, si dhe parandalimi dhe trajtimi i dhunës me bazë gjinore, duke ruajtur njëkohësisht qëndrueshmërinë fiskale.
Planifikimi afatmesëm i shpenzimeve u mundëson ministrive të linjës të parashikojnë financim shumëvjeçar për programet e përgjegjshme gjinore, duke përmirësuar vazhdimësinë e shërbimeve. Përmirësimi i administrimit tatimor dhe i menaxhimit të shpenzimeve mund të krijojë hapësirë fiskale shtesë për investime të synuara, përfshirë shërbimet e specializuara për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Prirja drejt konsolidimit fiskal mund të forcojë gjithashtu besueshmërinë e Shqipërisë përpara donatorëve dhe të krijojë mundësi për bashkëfinancim, ku fondet e buxhetit të shtetit plotësohen nga programe të financuara nga burime të jashtme.
Në përmbledhje, perspektiva makroekonomike mund të krijojë një bazë për rritjen dhe qëndrueshmërinë e financimit të prioriteteve të barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale, me kusht që hapësira fiskale shtesë të përdoret në mënyrë strategjike dhe të mbështetet në prioritete të qarta, kostim të argumentuar dhe rezultate të matshme.
Megjithëse planifikimi financiar afatmesëm i ka kushtuar vëmendje buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, ai nuk i ka integruar ende në mënyrë të plotë dhe të dallueshme shpenzimet që lidhen posaçërisht me dhunën me bazë gjinore. Alokimet e parashikuara për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm paraqiten të përmbledhura në tabelën më poshtë.

**Tabela 4. Alokimet për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në PBA**

| Periudha | Numri i programeve buxhetore me BPGj (kërkesa) | Vlera e shpenzimeve të planifikuara për BPGj-në për vitin e parë të PBA-së (në lekë) | Përqindja e shpenzimeve të planifikuara për BPGj-në ndaj shpenzimeve të përgjithshme |
|---|---|---|---|
| **PBA 2023–2025** | 48 (nga 75 programe) | 60 380 387 485 | 9% |
| **PBA 2024–2026** | 76 (nga 130 programe) | 74 391 692 193 | 10,1% |
| **PBA 2025–2027** | 77 (nga 131 programe) | 88 937 832 664 | 10,8% |
| **PBA 2026–2028** | 81 (nga 131 programe) | Ende e paidentifikuar | Ende e paidentifikuar |

***Burimi i të dhënave:*** *Ministria e Financave, Aneksi 2 "Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor", pjesë e dokumenteve të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) për periudhat 2023–2025, 2024–2026, 2025–2027 dhe 2026–2028. Të dhënat pasqyrojnë numrin e programeve buxhetore që përmbajnë kërkesa të lidhura me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, si dhe vlerën dhe peshën e shpenzimeve të planifikuara përkatëse, sipas informacionit të paraqitur në secilin dokument të PBA-së.*

Megjithëse vëmendja ndaj përmirësimit të mekanizmave të planifikimit buxhetor dhe monitorimit të politikave gjinore është rritur, zbatimi aktual i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor nuk duket se përfshin ende një qasje të posaçme dhe sistematike për planifikimin, analizimin dhe monitorimin e të dhënave dhe shpenzimeve që lidhen me dhunën me bazë gjinore. Nga shqyrtimi i Aneksit 2 të PBA-së 2025–2027 rezulton se financimi për DhBGj-në pasqyrohet vetëm pjesërisht dhe në mënyrë jo të njëtrajtshme në kuadrin buxhetor afatmesëm:

- Financimi i lidhur me DhBGj-në përfshihet shprehimisht në disa programe sektoriale, kryesisht në fushat e mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe rendit publik. Megjithatë, ai nuk integrohet në mënyrë sistematike në të gjithë sektorët përkatës, si shëndetësia dhe

arsimi, ndonëse këta sektorë kanë përgjegjësi të rëndësishme në parandalimin, identifikimin, referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës.

- Për disa produkte që lidhen drejtpërdrejt me DhBGj-në, PBA-ja përmban kosto të përllogaritura për periudhën përkatëse, për shembull për zbatimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, shërbimet e strehimit dhe format e specializuara të mbështetjes për viktimat. Në raste të tjera, dokumentet paraqesin vetëm vlera të pjesshme ose orientuese dhe nuk ofrojnë një kostim të plotë paraprak. Informacioni i prodhuar gjatë monitorimit pas zbatimit të buxhetit mund të tregojë shpenzimin faktik, por nuk e zëvendëson nevojën për kostimin e plotë të ndërhyrjeve përpara miratimit të buxhetit.
- Lidhja ndërmjet financimit të DhBGj-së dhe objektivave të PBA-së është më e fortë në programet ku janë përcaktuar objektiva të posaçëm për DhBGj-në, të shoqëruar me tregues të matshëm, vlera bazë dhe objektiva të synuar. Në programe të tjera përdoren formulime të përgjithshme, si "përmirësimi i shërbimeve sociale", pa një dimension të qartë të performancës që të mundësojë matjen e rezultateve në parandalimin dhe trajtimin e DhBGj-së.
- Alokimet për shërbimet e financuara në nivel vendor nuk pasqyrohen në mënyrë të plotë në dokumentacionin e analizuar të PBA-së qendrore. Kjo kufizon mundësinë për të krijuar një panoramë të konsoliduar të financimit nga buxheti i shtetit, buxhetet bashkiake, fondi social dhe burimet e jashtme.

Në përfundim, financimi për DhBGj-në është i identifikueshëm në disa pjesë të PBA-së, por pasqyrimi i tij mbetet i paplotë. Disa shërbime të specializuara dhe masa të institucioneve ligjzbatuese janë të kostuara dhe të lidhura me objektiva të matshëm, por mbulimi ndryshon ndërmjet sektorëve dhe nuk përfshin në mënyrë të plotë të gjitha nivelet e qeverisjes. Kostimi është shpesh i pjesshëm ose orientues, ndërsa mungesa e të dhënave të konsoliduara për financimin vendor pengon vlerësimin e përgjithshëm të burimeve të planifikuara dhe të shpenzuara për parandalimin dhe trajtimin e DhBGj-së.

Në të njëjtën kohë, perspektiva makroekonomike e Shqipërisë mund të krijojë kushte më të favorshme për forcimin e financimit të shërbimeve që lidhen me DhBGj-në. Rritja e parashikuar e të ardhurave, e kombinuar me menaxhimin e shpenzimeve dhe konsolidimin gradual fiskal, mund të krijojë hapësirë potenciale për financimin e shërbimeve sociale prioritare. Megjithatë, rritja e të ardhurave nuk garanton automatikisht krijimin ose përdorimin e hapësirës fiskale për DhBGj-në. Kjo varet nga kufizimet fiskale, prioritetet qeveritare, cilësia e kërkesave buxhetore dhe vendimet për shpërndarjen e fondeve.

Mekanizmat ekzistues të BPGj-së tregojnë përparim në përfshirjen e perspektivës gjinore në planifikimin buxhetor, por ende nuk mundësojnë identifikimin dhe gjurmimin sistematik të të gjitha shpenzimeve që lidhen me DhBGj-në, sipas sektorëve dhe niveleve të qeverisjes. Përmirësimi i kësaj situate kërkon:

- integrimin e DhBGj-së në të gjitha programet buxhetore përkatëse;
- hartimin e metodologjive të standardizuara për kostimin paraprak;
- ndarjen e qartë ndërmjet kërkesave, alokimeve të miratuara, disbursimeve dhe shpenzimeve faktike;
- përdorimin e treguesve të matshëm, me vlera bazë dhe objektiva të synuar;
- përfshirjen e financimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- dallimin ndërmjet financimit publik të siguruar dhe kontributeve të përkohshme të donatorëve;
- raportimin mbi mbulimin, cilësinë dhe rezultatet e shërbimeve, jo vetëm mbi realizimin financiar.

Forcimi i këtyre elementeve do t'i mundësonte Shqipërisë të përdorte më mirë çdo hapësirë fiskale të krijuar dhe të siguronte financim më të qëndrueshëm, të parashikueshëm dhe institucional për parandalimin dhe trajtimin e dhunës me bazë gjinore.

**Angazhimet e buxhetit vjetor për adresimin e dhunës me bazë gjinore**

Kjo pjesë shqyrton masën në të cilën buxhetet vjetore të shtetit për periudhën 2022–2025 kanë parashikuar financim për secilin prej shërbimeve të identifikuara më parë për parandalimin dhe trajtimin e dhunës me bazë gjinore. Analiza synon të përcaktojë nëse ekzistojnë zëra buxhetorë të posaçëm për këto shërbime, vlerën e fondeve të planifikuara dhe institucionet përgjegjëse për administrimin dhe zbatimin e tyre. Kur mungojnë zëra të veçantë, shqyrtohet mundësia e identifikimit të financimit brenda programeve, produkteve ose kategorive më të gjera buxhetore.

Shpenzimet e qeverisjes qendrore dhe vendore për shërbimet e kujdesit shoqëror regjistrohen kryesisht në Programin e Mirëqenies Socialenr. 10430. Ky program përfshin një gamë të gjerë shpenzimesh, ndër të cilat:

- transfertat monetare, përfshirë ndihmën ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuara;
- financimin e ofruesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- kostot administrative të Shërbimit Social Shtetëror;
- financimin nëpërmjet Fondit Social;
- si dhe shpenzime të tjera të lidhura me politikat dhe administrimin e mbrojtjes sociale.

Brenda këtij programi nuk rezulton të ketë një zë buxhetor të vetëm, të posaçëm dhe gjithëpërfshirës për shërbimet që lidhen me DhBGj-në. Fondet për këto shërbime mund të përfshihen në produkte ose kategori më të gjera të mbrojtjes sociale, së bashku me shpenzime për grupe dhe shërbime të tjera. Për pasojë, në shumë raste është e vështirë — dhe ndonjëherë e pamundur — të identifikohet drejtpërdrejt se sa është planifikuar, alokuar dhe shpenzuar posaçërisht për parandalimin dhe trajtimin e DhBGj-së.

Kjo mungesë e ndarjes buxhetore kufizon mundësinë për të krahasuar financimin e miratuar me nevojat dhe kostot reale të shërbimeve. Ajo vështirëson gjithashtu monitorimin e disbursimeve, të shpenzimeve faktike, të numrit të përfituesve dhe të rezultateve të arritura.

Financimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror administrohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Socialepërmes tri kanaleve kryesore të financimit, të cilat analizohen në nënseksionet në vijim.

**Financimi i i drejtpërdrejtë nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror**

Shërbimi Social Shtetëror kryen çdo vit transferta të drejtpërdrejta për financimin e institucioneve të përzgjedhura të kujdesit shoqëror. Shqyrtimi i transaksioneve të thesarit për periudhën 2020–2022 dhe i të dhënave të siguruara nga Shërbimi Social Shtetëror për vitet 2023–2024 evidentoi alokime të identifikueshme posaçërisht për shërbimet e lidhura me dhunën me bazë gjinore vetëm për dy institucione. Këto alokime paraqiten në në tabelën më poshtë.

**Tabela 5. Shpenzimet për dy shërbime të lidhura me DhBGj-në, të financuara nga Shërbimi Social Shtetëror**

| Ofruesi i shërbimit të kujdesit shoqëror (në milionë lekë) | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|
| Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit | 20,9 | 22,5 | 20,0 | 24,1 | 28,5 |
| Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje | 22,7 | 21,7 | 21,9 | 25,4 | 29,7 |
| **Gjithsej** | **43,6** | **44,2** | **41,9** | **49,5** | **58,2** |

**Burimi:** Përllogaritje e ekipit kërkimor bazuar në analizën e transaksioneve të Thesarit për periudhën 2020–2022 dhe në të dhënat e siguruara nga Shërbimi Social Shtetëror për vitet 2023–2024.

## 2. Financimi i tërthortë nëpërmjet Fondit Social

Fondi Social funksionon si një mekanizëm publik financimi me procedurë konkurruese, nëpërmjet të cilit fondet u alokohen njësive të vetëqeverisjes vendore ose qarqeve nga zëri i buxhetit qendror "Fondi Social" (91307AH).
Shqyrtimi i transaksioneve të Thesarit nuk mundësoi përcaktimin e mënyrës se si këto fonde u shpërndanë ndërmjet ofruesve të ndryshëm të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Megjithatë, Shërbimi Social Shtetëror vuri në dispozicion informacion të pjesshëm mbi shumat e përfituara nga disa ofrues nëpërmjet Fondit Social.

Tabela më poshtë paraqet shpenzimet e identifikueshme për shërbimet që lidhen me DhBGj-në brenda këtij mekanizmi financimi, bazuar vetëm në të dhënat për fondet e buxhetit të shtetit. Duhet theksuar se këta ofrues të shërbimeve sociale mund të marrin financim edhe nga donatorë, organizata joqeveritare ose burime të tjera. Megjithatë, të dhënat për këto kontribute nuk raportohen në mënyrë të konsoliduar dhe nuk janë të disponueshme publikisht. Për pasojë, shumat e paraqitura nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht financimin e përgjithshëm të secilit ofrues ose koston e plotë të shërbimeve të ofruara.

**Tabela 6. Shpenzimet e lidhura me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, të financuara nëpërmjet Fondit Social**

| Ofruesi i shërbimit të kujdesit shoqëror (në milionë lekë) | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|
| Qendra për Shërbime Mbrojtëse dhe Emergjente për Fëmijët dhe Familjet, Durrës | 3,5 | 3,5 | 3,5 |
| Tjetër Vizion, Elbasan | 9,0 | 9,0 | 12,9 |
| Qendra "Vatra", Vlorë | 11,8 | 11,8 | 17,4 |
| Qendra e Strehimit, Kukës | 2,0 | 1,7 | 1,7 |
| Qendra ALO 116 111, Tiranë | 6,0 | 6,0 | 7,1 |
| Qendra për Ofrimin e Shërbimeve për Viktimat e Dhunës me Bazë Gjinore, Tiranë | 6,8 | 6,8 | 8,4 |
| Ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore, Gjirokastër | 2,0 | 2,0 | 2,0 |
| Strehëza për viktimat e dhunës në familje, Berat | 3,1 | 1,2 | 1,2 |
| Integrimi social dhe ekonomik i vajzave të mitura në situata vulnerabiliteti, Lezhë | – | 4,4 | 13,2 |
| "Të Ndryshëm & Të Barabartë", Tiranë | – | 9,1 | 13,4 |

***Burimi i të dhënave:*** *Të dhëna të vëna në dispozicion nga Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH).*

## Transfertat e përgjithshme të pakushtëzuara

Transfertat e përgjithshme të pakushtëzuara u jepen çdo vit njësive të vetëqeverisjes vendore dhe qarqeve, në përputhje me ligjin vjetor të buxhetit. Autoritetet përfituese kanë të drejtë t'i përdorin këto fonde sipas prioriteteve dhe nevojave të përcaktuara në nivel vendor.
Disa ofrues të shërbimeve për viktimat e DhBGj-së mund të financohen pjesërisht nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar. Megjithatë, raportimi financiar nuk i paraqet shumat të ndara sipas ofruesit, llojit të shërbimit ose kategorisë së shpenzimit. Shpenzimet për ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror raportohen përgjithësisht në mënyrë të përmbledhur në kuadër të një programi të vetëm buxhetor — Programit të Mbrojtjes Sociale — ndërsa buxhetet vjetore nuk paraqesin një ndarje të qartë të alokimeve për secilin ofrues.

Një nga arsyet kryesore për mungesën e këtij informacioni është se shumë ofrues nuk njihen si njësi shpenzuese më vete. Për pasojë, ata nuk përgatisin buxhete të veçanta dhe nuk identifikohen në transaksionet e Thesarit me kode të dallueshme. Kjo pengon gjurmimin e fondeve publike nga momenti i alokimit deri te ofruesi dhe shërbimi konkret.

Gjithashtu, financimi i siguruar drejtpërdrejt nga donatorët për ofruesit zakonisht nuk pasqyrohet në të dhënat e buxhetit të shtetit. Për këtë arsye, nuk është e mundur të krijohet një panoramë e plotë që të përfshijë financimin nga buxheti qendror, buxhetet vendore, Fondi Social dhe burimet e jashtme.
Në përgjithësi, kuadri aktual i planifikimit buxhetor dhe raportimit financiar nuk siguron transparencë të mjaftueshme për të përcaktuar shumën e fondeve publike që alokohet dhe shpenzohet për shërbimet e lidhura me DhBGj-në. Financimi i shpërndarë ndërmjet disa mekanizmave, mungesa e zërave të dedikuar buxhetorë, raportimi i kufizuar në nivel ofruesi dhe mospërfshirja e financimit nga donatorët e bëjnë të pamundur krijimin e një pasqyre të konsoliduar të burimeve të përgjithshme të përdorura për adresimin e DhBGj-së.
Për pasojë, institucionet publike dhe aktorët e tjerë të interesuar nuk mund të vlerësojnë me saktësi nëse financimi ekzistues përputhet me angazhimet e politikave, detyrimet ligjore, standardet e shërbimeve dhe nevojat reale të të mbijetuarave.

# KAPITULLI 2. KOSTOT E SHËRBIMEVE TË SPECIALIZUARA PËR TRAJTIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE

Ky kapitull shqyrton, për secilin shërbim të specializuar, masën në të cilën Qeveria e Shqipërisë ka alokuar dhe shpenzuar fonde të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve për DhBGj-në, në përputhje me Konventën e Stambollit, gjatë periudhës 2022–2024, si dhe nëse ka buxhetuar në mënyrë të përshtatshme për periudhën 2025–2028. Periudha e përzgjedhur mundëson identifikimin e prirjeve shumëvjeçare, në përputhje me praktikat e mira të BPGj-së.

Për çdo shërbim të trajtuar në këtë kapitull, analiza fillon duke paraqitur mandatet institucionale dhe përgjegjësitë ligjore që lidhen me shërbimet e specializuara për DhBGj-në. Më pas, për të vlerësuar kërkesën, ajo shqyrton disponueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave administrative të aksesueshme publikisht për përfitueset, duke evidentuar, kur është e nevojshme, mangësitë në administrimin institucional të të dhënave.

Kapitulli nuk vlerëson njohuritë institucionale, aftësitë ose kapacitetet profesionale për zbatimin e detyrimeve ligjore, pasi kjo do të kërkonte një kërkim të veçantë, por evidenton mangësitë në sistemet e të dhënave që pengojnë planifikimin dhe buxhetimin efektiv.

Për t'iu përgjigjur pyetjes mbi kostot e vlerësuara të ofrimit të shërbimeve të specializuara, në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit, për periudhën 2026–2028, është zbatuar një qasje e strukturuar kostimi. Kjo qasje ndërthur analizën e shpenzimeve historike me parashikimet për të ardhmen. Të dhënat mbi shpenzimet faktike për periudhën 2022–2024 dhe parashikimet për vitin 2025, që përfshijnë si shërbimet e ofruara nga institucionet publike, ashtu edhe ato të ofruara nga organizatat e shoqërisë civile të grave, kur të dhënat janë të disponueshme, përdoren për të përcaktuar strukturën e kostos bazë dhe për të identifikuar prirjet në ofrimin e shërbimeve dhe shpërndarjen e burimeve.

Këto kosto bazë më pas projektohen për vitet e ardhshme duke përdorur një normë vjetore rritjeje prej 5%, e përbërë nga 3% për të pasqyruar inflacionin e parashikuar në Shqipëri dhe 2% shtesë për të marrë parasysh përshtatjet e moderuara të pagave dhe

shpenzimeve operative. Supozimi për inflacionin është në përputhje me parashikimet afatmesme prej rreth 3%, siç raportohet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN, 2024)[56].

Paralelisht, të dhënat cilësore të mbledhura nëpërmjet intervistave me ofruesit e shërbimeve janë përdorur për të identifikuar boshllëqet ndërmjet ofrimit aktual të shërbimeve dhe standardeve të Konventës së Stambollit, përfshirë mangësitë në mbulim, personel, aksesueshmëri dhe vazhdimësi të kujdesit. Burimet shtesë të nevojshme për adresimin e këtyre mangësive janë kostuar veçmas dhe përfshijnë, ndër të tjera, zgjerimin e personelit, forcimin e mbështetjes për riintegrim, përmirësimin e aksesueshmërisë dhe krijimin e mekanizmave më të parashikueshëm dhe të përshtatshëm të financimit për organizatat e shoqërisë civile të grave.

Për rrjedhojë, kostoja e përgjithshme e vlerësuar për ofrimin e shërbimeve të specializuara gjatë periudhës 2026–2028 përfaqëson shumën e: (i) shpenzimeve bazë të projektuara dhe (ii) burimeve shtesë të nevojshme për të mbyllur boshllëqet e identifikuara në ofrimin e shërbimeve dhe për të siguruar përputhshmëri të plotë me kërkesat e Konventës së Stambollit.

## Linja e Këshillimit për gra e vajza

### Përgjegjësitë dhe kuadri ligjor

Ky shërbim u përfshi në studim sepse është e vetmja linjë e specializuar këshillimi në shkallë kombëtare, e dedikuar ekskluzivisht për gratë dhe vajzat që përjetojnë dhunë me bazë gjinore në Shqipëri. Megjithëse nuk është një strukturë e administruar nga shteti, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGV) funksionon me mbështetje financiare publike të pjesshme dhe të vazhdueshme nëpërmjet mekanizmit të Fondit Social dhe ka përgjegjësi kombëtare për referimin dhe koordinimin brenda Mekanizmit të Koordinuar të Referimit. Për rrjedhojë, ajo është shërbimi kryesor i specializuar me akses në distancë, që u ofron të mbijetuarave në të gjithë vendin këshillim në situata krize, vlerësim të riskut, planifikim të sigurisë, informacion juridik dhe mbështetje për referim.

LKGV-ja vepron brenda kuadrit të Ligjit nr. 9669/2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (i ndryshuar), Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" dhe në përputhje me detyrimet e Shqipërisë sipas Konventës së Stambollit, veçanërisht nenit 24 për linjat telefonike të ndihmës që funksionojnë 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë. Shërbimi funksionon si një mekanizëm i specializuar mbështetës që plotëson institucionet shtetërore dhe shërbimet bashkiake, duke siguruar këshillim të menjëhershëm, konfidencial dhe pa pagesë nëpërmjet telefonit dhe platformave digjitale. Mandati i tij përfshin ndërhyrjen në situata krize, këshillimin psikosocial, planifikimin e sigurisë, informacionin juridik, shoqërimin dhe referimin pranë policisë, strehëzave, shërbimeve shëndetësore dhe gjykatave, si dhe mbështetjen pasuese kur kërkohet.

Linja drejtohet nga një Bord Drejtues dhe udhëhiqet nga një Drejtore Ekzekutive, e cila mban përgjegjësinë e përgjithshme menaxheriale dhe strategjike. Struktura drejtuese përfshin një menaxhere financiare, një menaxhere projekti, një koordinatore, personel administrativ, një oficere komunikimi dhe një specialiste të monitorimit dhe vlerësimit. Ofrimi i drejtpërdrejtë i shërbimit sigurohet nga një ekip bazë prej afërsisht dhjetë këshillueseve me kohë të plotë, të mbështetura nga vullnetare të trajnuara. Të gjitha këshillueset janë të angazhuara me kohë të plotë në ofrimin e shërbimeve që lidhen me dhunën me bazë gjinore, duke përfshirë reagimin emergjent, dokumentimin e rasteve dhe koordinimin ndërinstitucional.

[56] International Monetary Fund (IMF), *Albania: Staff Report for the Article IV Consultation*, 2024. The report projects inflation to gradually converge toward the Bank of Albania's target of 3% over the medium term.

Linja nuk administron struktura akomoduese. Megjithatë, modeli i saj operacional kërkon disponueshmëri të vazhdueshme, mbulim kombëtar dhe nivele të larta koordinimi ndërsektorial. Megjithëse personeli mundëson ofrimin e shërbimit 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, numri i këshillueseve dhe i punonjësve administrativë mbetet i kufizuar në raport me ngarkesën e punës, veçanërisht gjatë periudhave me numër të lartë raportimesh dhe në rastet me risk të lartë që kërkojnë shoqërim dhe ndjekje intensive.

Përgjegjësitë për buxhetimin i takojnë Drejtores Ekzekutive, e mbështetur nga Menaxherja Financiare. Plani financiar vjetor përgatitet në bazë të kërkesës së parashikuar për shërbime, kostove të personelit dhe shpenzimeve operative dhe paraqitet për miratim nëpërmjet mekanizmit përkatës të Fondit Social dhe autoriteteve publike përgjegjëse. Megjithatë, duke qenë se shërbimi funksionon me një model të përzier financimi, të përbërë nga fonde publike dhe kontribute të donatorëve, planifikimi financiar mbetet i varur nga alokimet vjetore të financimit dhe jo nga angazhimet shumëvjeçare të buxhetit të shtetit.

**Kapacitetet për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor**

Zyrtarët përgjegjës për buxhetimin brenda Linjës së Këshillimit tregojnë njohuri të përgjithshme për BPGj-në. Personeli e njeh BPGj-në si një detyrim ligjor dhe procedural brenda kuadrit të PBA-së në Shqipëri dhe konfirmon se dokumentacioni i buxhetimit gjinor kërkohet gjatë aplikimit për financim publik nëpërmjet mekanizmit të Fondit Social. Organizata gjithashtu ka mbështetur më parë autoritetet e nivelit vendor për të kuptuar dhe zbatuar parimet e buxhetimit gjinor, duke pasqyruar një ndërgjegjësim të fortë konceptual për këtë qasje.

Megjithëse kërkesa formale pranohet, zbatimi praktik i BPGj-së mbetet kryesisht procedural. Propozimet buxhetore përgatiten çdo vit dhe paraqiten nëpërmjet kanaleve përkatëse administrative, por integrimi i analizës gjinore në parashikimet e detajuara të kostove është i kufizuar. Në praktikë, buxhetimi përqendrohet kryesisht te pagat e personelit dhe shpenzimet operative bazë, me përfshirje më pak sistematike të nevojave të diferencuara të grupeve të veçanta të grave dhe vajzave, si gratë me aftësi të kufizuara, gratë rome dhe egjiptiane, të mbijetuarat nga zonat rurale ose gratë që kanë nevojë për mbështetje psikosociale afatgjatë.

Organizata kreu për herë të parë një përllogaritje të strukturuar të kostos së shërbimit në vitin 2019 dhe, që prej asaj kohe, përgatit vlerësime vjetore të kostove, veçanërisht kur aplikon për financim shtetëror. Këto përllogaritje mbulojnë kryesisht shpenzimet e personelit dhe kostot e ofrimit të drejtpërdrejtë të shërbimeve. Megjithatë, kostot e tërthorta dhe strukturore — përfshirë infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, përmirësimet e sigurisë kibernetike, sistemet elektronike të arkivimit të të dhënave dhe zhvillimin afatgjatë të kapaciteteve — nuk përfshihen në mënyrë të vazhdueshme në parashikime gjithëpërfshirëse buxhetore shumëvjeçare. Si rezultat, kostoja e plotë e ofrimit të një shërbimi të specializuar këshillimi në shkallë kombëtare, që funksionon 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, nuk pasqyrohet gjithmonë në aplikimet për financim ose në alokimet shtetërore.

Të dhënat për përfitueset mblidhen nëpërmjet një sistemi digjital të bazës së të dhënave, të zhvilluar me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë. Baza e të dhënave përmban informacion të hollësishëm në nivel rasti, duke përfshirë gjininë, moshën, llojin e dhunës, rrugën e referimit dhe shërbimin e ofruar. Megjithatë, të dhënat nuk përdoren në mënyrë sistematike për të prodhuar simulime të kostove të ardhshme ose skenarë afatmesëm të shpenzimeve. Parashikimi i numrit të përfitueseve kryhet mbi bazë vjetore, për shkak të pasigurisë së burimeve të financimit, dhe jo nëpërmjet parashikimeve të strukturuara trevjeçare, në përputhje me ciklin e PBA-së.

Planifikimi buxhetor koordinohet kryesisht ndërmjet Drejtores Ekzekutive dhe Menaxheres Financiare. Megjithëse personeli i programeve jep kontribut lidhur me nevojat e shërbimit, nuk zhvillohen seanca të formalizuara të planifikimit të brendshëm buxhetor që integrojnë në mënyrë sistematike analizën financiare dhe atë programore. Asnjë nëpunës i

posaçëm për barazinë gjinore ose buxhetimin gjinor nuk është i angazhuar zyrtarisht në ciklin buxhetor. Analiza e ndikimit gjinor nuk përfshihet në mënyrë të vazhdueshme në planifikimin financiar.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit kryhet periodikisht, kryesisht për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e raportimit të donatorëve dhe të institucioneve publike. Megjithatë, nuk ka mekanizma të strukturuar që lidhin të dhënat e shpenzimeve me treguesit e rezultateve që lidhen me parandalimin dhe trajtimin e dhunës me bazë gjinore në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030. Kjo dobëson lidhjen analitike ndërmjet burimeve të alokuara, prirjeve të kërkesës për shërbime dhe ndikimit të matshëm.

**Përfitueset dhe kërkesa për shërbime**

Si e vetmja linjë e specializuar këshillimi në shkallë kombëtare, e dedikuar ekskluzivisht për gratë dhe vajzat që përjetojnë dhunë me bazë gjinore, Linja e Këshillimit luan një rol qendror në kuadrin institucional të reagimit të Shqipërisë. Ndryshe nga strehëzat rezidenciale ose shërbimet sociale bashkiake, Linja ofron mbështetje të menjëhershme, në distancë dhe konfidenciale dhe shpesh shërben si pika e parë e kontaktit për të mbijetuarat, përpara çdo angazhimi formal institucional. Shtrirja e saj kombëtare mundëson akses për gratë si në zonat urbane, ashtu edhe në ato të largëta, përfshirë bashkitë ku shërbimet e specializuara për DhBGj-në janë të kufizuara ose nuk ekzistojnë.

Linja u shërben grave të mbijetuara të dhunës në familje, dhunës nga partneri intim, dhunës seksuale, përndjekjes, abuzimit psikologjik dhe ekonomik, si dhe grave të përfshira në procese ndarjeje me konflikt të lartë ose mosmarrëveshje për kujdestarinë, ku ekzistojnë rreziqe për sigurinë. Përfitueset përfshijnë gjithashtu të mitur të shoqëruar dhe fëmijë viktima të drejtpërdrejta, si dhe gra nga komunitetet rome dhe egjiptiane, gra me sëmundje kronike dhe gra që jetojnë në zona rurale ose periurbane. Megjithëse Linjën e kontaktojnë edhe të mbijetuara me aftësi të kufizuara, pengesat në akses vazhdojnë, veçanërisht në rastet që kërkojnë shoqërim fizik ose koordinim me shërbimet që ofrohen me prani fizike.

Shërbimi funksionon 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, duke kërkuar personel dhe menaxhim të vazhdueshëm të rasteve. Kërkesa ndryshon gjatë vitit dhe priret të rritet gjatë periudhave të ndërgjegjësimit më të lartë publik, vështirësive ekonomike ose reformave institucionale.

Parashikimi i numrit të përfitueseve kryhet mbi bazë vjetore dhe jo nëpërmjet parashikimeve shumëvjeçare. Bazuar në gjetjet e intervistave, pasiguria e alokimeve të financimit publik — të cilat zakonisht miratohen mbi bazë vjetore — kufizon masën në të cilën planifikohet në praktikë zgjerimi afatgjatë i shërbimit. Megjithëse nevojat e përfitueseve mund të parashikohen në mënyrë të pavarur nga burimet e disponueshme, mungesa e financimit të parashikueshëm dhe shumëvjeçar kufizon përkthimin e këtyre parashikimeve në planifikim konkret dhe zhvillim të shërbimit.

Të dhënat për përfitueset ruhen në një sistem të brendshëm digjital, i cili regjistron variabla kryesorë, si gjinia, mosha, lloji i dhunës, rrugët e referimit dhe shërbimet e ofruara. Megjithëse baza e të dhënave përmban informacion të hollësishëm në nivel rasti, disagregimi sistematik sipas përkatësisë etnike, statusit të aftësisë së kufizuar dhe origjinës gjeografike nuk përdoret në mënyrë të vazhdueshme për qëllime të modelimit financiar. Kjo kufizon aftësinë e organizatës për të kryer parashikime të diferencuara të kostove ose për të vlerësuar ndikimet specifike në burime të ofrimit të shërbimeve për grupet me cenueshmëri të lartë.

Linja koordinon shpesh referimet te policia, strehëzat, institucionet shëndetësore, gjykatat dhe Mekanizmat e Koordinuar të Referimit në nivel bashkie. Në rastet që kërkojnë shoqërim — si paraqitja në gjykatë, trajtimi mjekësor ose vendosja në strehim emergjent — shërbimi përballet me ngarkesa operative shtesë, veçanërisht për sa u përket transportit dhe kohës së personelit. Këto kosto nuk pasqyrohen plotësisht në alokimet bazë të financimit dhe shpesh kërkojnë rregullime rast pas rasti.

Pavarësisht financimit të pjesshëm publik, Linja mbetet strukturalisht e varur nga mbështetja e donatorëve për të ruajtur mbulimin kombëtar. Si një pikë qendrore hyrëse në sistemin e

mbrojtjes, çdo ndërprerje e financimit do të kishte pasoja më të gjera sistemike për koordinimin e referimeve dhe aksesin e të mbijetuarave në shërbime.

## Ushtrimet e kostimit dhe alokimet buxhetore 2022–2024

LKGV-ja vazhdon të financohet kryesisht nëpërmjet projekteve të financuara nga donatorët. Megjithëse organizata merr financim nga Fondi Social, i administruar nga Qarku i Tiranës, ky mekanizëm mbulon vetëm kostot e personelit për 10 anëtare të stafit këshillues dhe nuk financon asnjë shpenzim tjetër operacional. Është e rëndësishme të theksohet se alokimi nga Fondi Social nuk garantohet çdo vit; ai varet nga vendimet e miratimit në nivel qendror dhe nga fondet buxhetore të disponueshme.

Në mënyrë të ngjashme, në nivel bashkiak nuk ekziston një zë buxhetor i dedikuar dhe i qëndrueshëm që të mbulojë kostot e plota operative të këtij shërbimi të specializuar për DhBGj-në. Bashkia nuk kryen një vlerësim të kostimit të Linjës të bazuar në nevoja. As alokimi nga Fondi Social nuk lidhet me parashikimet për numrin e rasteve ose me kostimin në nivel shërbimi.

Në nivel qendror nuk ekziston një metodologji e institucionalizuar kostimi për këtë shërbim të specializuar. Megjithëse organizata kryen vlerësime të brendshme vjetore të kostove — kryesisht për nevojat e personelit, me qëllim aplikimin për mbështetje nga Fondi Social — këto përllogaritje janë të pjesshme dhe të orientuara nga projektet. Kostot që nuk lidhen me personelin, përfshirë qiranë, shërbimet utilitare, infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, sistemet e sigurisë, mbrojtjen digjitale të të dhënave, boshllëqet në transport, mbikëqyrjen, mbështetjen për riintegrim, ndihmën emergjente dhe veprimtaritë parandaluese, nuk përfshihen në asnjë kuadër kostimi të njohur nga shteti.

Për rrjedhojë, financimi operacional mbetet strukturalisht i orientuar nga donatorët. Përtej kontributit të Fondit Social, i kufizuar vetëm te pagat e këshillueseve, funksionimi i LKGV-së varet pothuajse tërësisht nga donatorët e jashtëm. Qeveria mbetet kontribuuesi më i vogël në krahasim me burimet e tjera të financimit. Ndërkohë, donatorët kryesorë të identifikuar përmes intervistës përfshijnë Fondacionin IAMANEH (International Association for Maternal and Neonatal Health) si donatori më afatgjatë, Sida përmes Rrjetit të Fuqizimit të Gruas Shqiptare, programet e Bashkimit Evropian dhe agjencitë e Kombeve të Bashkuara, të cilat ofrojnë mbështetje periodike dhe të bazuar në projekte.

Financimi nga donatorët është shpesh i kufizuar në veprimtaritë e projekteve dhe nuk mbulon në mënyrë të vazhdueshme kostot e përgjithshme ose nevojat e paparashikuara operative. Mungesa e financimit bazë fleksibël krijon dobësi strukturore në funksionim dhe kufizon kapacitetin për planifikim afatgjatë. Për pasojë, qëndrueshmëria financiare mbetet e brishtë. Financimi publik, si në nivel bashkiak, ashtu edhe në nivel qendror, mbulon vetëm një pjesë të kufizuar të kostove të personelit dhe nuk trajton gamën e plotë të kërkesave të shërbimit të specializuar, duke e lënë strehëzën shumë të varur nga financimi i jashtëm i donatorëve, i kufizuar në kohë.

Përveç funksionimit të Linjës së Këshillimit, Qendra ofron një gamë të gjerë shërbimesh plotësuese, të cilat shkojnë përtej menaxhimit të rasteve të DhBGj-së. Këto përfshijnë Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem, e cila përqendrohet në rehabilitimin e autorëve burra të dhunës dhe në veprimtaritë parandaluese që synojnë kryesisht djemtë e rinj dhe baballarët, si dhe në këshillimin dhe mbështetjen e ofruar brenda dhe jashtë sistemit penitenciar.

Qendra gjithashtu përfshin "Qendrën për Siguri dhe Paqe Shqipëri", një departament të posaçëm që trajton ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin fetar. Ky departament punon kryesisht me gratë dhe fëmijët e kthyer nga kampet al-Hol dhe Roj, si dhe mbështet të 12 qarqet e vendit në funksionimin e Komiteteve Rajonale kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

Përveç kësaj, organizata zbaton veprimtari për ngritjen e kapaciteteve institucionale, ndërhyrje ligjore, studime kërkimore, angazhime monitorimi dhe punë që lidhen me politikat

në sektorë të ndryshëm. Këto ndërhyrje të larmishme zbatohen shpesh nëpërmjet projekteve të integruara, në të cilat koha e personelit, kostot administrative, mjediset dhe burimet operative ndahen ndërmjet disa komponentëve të shërbimit dhe fushave tematike.

Si rezultat, shpenzimet nuk janë strukturuar në një mënyrë që mundëson ndarjen e qartë dhe të qëndrueshme të kostove që i atribuohen ekskluzivisht Linjës së Këshillimit për Gra dhe Vajza. Duke pasur parasysh këtë model të integruar të ofrimit të shërbimeve, përdorimin e ndërthurur të burimeve njerëzore dhe operative, si dhe mungesën e kontabilitetit të kostove të ndara sipas linjës së shërbimit, një analizë e saktë e kostimit, e kufizuar vetëm te Linja e Këshillimit për periudhën 2022–2025, nuk është e realizueshme brenda fushës së këtij studimi.

## Parashikimet për periudhën 2026–2028 (PBA)

Ekipi kërkimor përgatiti parashikimet e shpenzimeve për vitet pasuese në përputhje me metodologjinë e përshkruar në këtë kapitull, duke përdorur si bazë buxhetin e vitit 2026 të vënë në dispozicion nga Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza. Nënseksionet në vijim paraqesin: (1) shpenzimet bazë të parashikuara për periudhën 2026–2028; (2) vlerësimet e kostove shtesë të nevojshme për plotësimin e boshllëqeve në shërbime dhe përafrimin me Konventën e Stambollit; dhe (3) buxhetin e përgjithshëm të vlerësuar, duke përfshirë kostot shtesë.

## Shpenzimet bazë të parashikuara për periudhën 2026–2028

Vlerësimet buxhetore të paraqitura në në tabelën më poshtë pasqyrojnë strukturën aktuale të shpenzimeve dhe modelin e funksionimit të Qendrës, siç janë evidentuar gjatë viteve të fundit.

**Tabela 7. Vlerësimet buxhetore të Linjës së Këshillimit për periudhën 2026–2028, në lekë**

| Zëri buxhetor (numri dhe emërtimi) | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| Pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore | 13 493 484 | 14 168 158 | 14 876 566 |
| Shpenzimet operative | 19 820 860 | 20 811 903 | 21 852 498 |
| Parandalimi dhe promovimi | 1 500 000 | 1 575 000 | 1 653 750 |
| Shpenzimet kapitale | 610 000 | 640 500 | 672 525 |
| Kostot e përgjithshme | 35 424 344 | 37 195 561 | 39 055 339 |

***Burimi:*** *Të dhënat e LKGV-së për vitin 2026 dhe përllogaritjet e ekipit kërkimor për vitet 2027–2028.*

Buxheti i përgjithshëm i parashikuar për vitin 2026 arrin në 35 424 344 lekë, me shpenzimet të përqendruara kryesisht te kostot operative dhe të personelit. Shpenzimet operative përfaqësojnë pjesën më të madhe, duke përbërë afërsisht 56% të buxhetit të përgjithshëm, çka pasqyron natyrën e punës së Qendrës, e cila është intensive dhe e varur nga shërbimet. Brenda kësaj kategorie, zërat më të mëdhenj të shpenzimeve janë shërbimet e këshillimit, afërsisht 33% e kostove operative, trajnimet dhe seminaret, rreth 18% e kostove operative, dhe shërbimet juridike, afërsisht 12% e kostove operative. Vetëm qiraja e zyrës përbën rreth 10% të shpenzimeve operative.

Në krahasim, pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore përfaqësojnë 38% të shpenzimeve të përgjithshme, duke treguar një strukturë relativisht të balancuar, në të cilën kostot e pagave nuk mbizotërojnë në mënyrë joproporcionale në shpenzimet e përgjithshme. Veprimtaritë e parandalimit dhe promovimit përbëjnë 4% të buxhetit të përgjithshëm, ndërsa

shpenzimet kapitale përfaqësojnë vetëm 2%, duke treguar hapësirë të kufizuar për investime në infrastrukturë.

Në përgjithësi, struktura e shpenzimeve tregon se Qendra funksionon kryesisht si një organizatë që ofron drejtpërdrejt shërbime, me shumicën e burimeve të alokuara për kostot operative dhe kostot e shërbimeve të vijës së parë, dhe jo për shpenzimet e përgjithshme administrative ose zgjerimin kapital.

**Vlerësimet e kostove shtesë të nevojshme për të plotësuar boshllëqet në shërbime dhe për t'u përafruar me Konventën e Stambollit**

Këto vlerësime mbështeten në intervistat me LKGV-në. Ato duhet të interpretohen si kosto shtesë që plotësojnë buxhetin ekzistues të organizatës.

**Personel shtesë**

- Për të adresuar boshllëqet në kapacitete, propozohet shtimi i tri pozicioneve të personelit, me kostot mujore të vlerësuara si më poshtë, duke përfshirë kontributet shoqërore prej 16,7%. Duhet të theksohet se pagat e propozuara janë në përputhje me kostot aktuale të personelit dhe, në përgjithësi, përputhen me nivelet e pagave në treg. Nevojitet një Koordinator/e shtesë Projekti për shkak të ngarkesës së lartë të punës që aktualisht përballohet nga personeli ekzistues. Me një pagë mujore bruto prej 150 000 lekësh, kostoja e përgjithshme mujore, duke përfshirë kontributet shoqërore, arrin në 175 050 lekë, që përkon me një kosto vjetore prej 2 100 600 lekësh. Ky pozicion do të zvogëlojë presionin operacional, do të përmirësojë koordinimin dhe do të sigurojë përputhshmërinë me standardet e donatorëve për raportimin dhe zbatimin.
- Nevojitet mbështetje e dedikuar financiare/kontabël për të adresuar kapacitetin e kufizuar të menaxhimit financiar. Me një pagë mujore bruto prej 100 000 lekësh, kostoja e përgjithshme mujore, duke përfshirë kontributet shoqërore, arrin në 116 700 lekë, që përkon me një kosto vjetore prej 1 400 400 lekësh. Ky rol do të forcojë mbikëqyrjen financiare, kontrollet e brendshme dhe saktësinë e raportimit.
- Propozohet një Specialist/e Prokurimi me kohë të pjesshme, pasi aktualisht nuk ekziston një funksion i dedikuar prokurimi. Me një pagë mujore bruto prej 60 000 lekësh, kostoja e përgjithshme mujore, duke përfshirë kontributet shoqërore, arrin në 70 020 lekë, që përkon me një kosto vjetore prej 840 240 lekësh. Krijimi i këtij funksioni do të rrisë transparencën, përputhshmërinë me standardet e prokurimit dhe efikasitetin operacional.

Kostoja e përgjithshme mujore shtesë e vlerësuar për këto tri pozicione është 361 770 lekë, e barasvlershme me një kosto të përgjithshme vjetore prej 4 341 240 lekësh, duke përfaqësuar një investim të nevojshëm për të siguruar ofrimin e qëndrueshëm të shërbimeve dhe përputhshmërinë institucionale.

**Mbikëqyrja profesionale e personelit**

Seancat e rregullta të mbikëqyrjes profesionale të personelit janë thelbësore për parandalimin e ezaurimit profesional dhe traumës dytësore te këshillueset dhe punonjëset sociale që trajtojnë çdo ditë raste të DhBGj-së me nivel të lartë stresi. Natyra e punës, përfshirë ndërhyrjen në situata krize, shoqërimin në gjykatë dhe ekspozimin e vazhdueshëm ndaj përvojave traumatike, ushtron trysni të konsiderueshme psikologjike mbi personelin e vijës së parë.

Për të siguruar mbështetje të përshtatshme psikologjike, janë planifikuar seanca mujore të mbikëqyrjes profesionale në grup për të gjithë personelin e vijës së parë, duke përfshirë 10 anëtare të përhershme të personelit dhe 8 vullnetare, gjithsej 18 pjesëmarrëse. Me një kosto

prej 2 500 lekësh për pjesëmarrëse, për çdo seancë, kostoja mujore arrin në 45 000 lekë. Në bazë vjetore, kostoja e përgjithshme është 540 000 lekë.
Ky alokim pasqyron nivelin minimal të mbikëqyrjes së strukturuar profesionale, të nevojshme për të mbrojtur mirëqenien e personelit, për të ruajtur standardet e shërbimit dhe për të mundësuar ofrimin e qëndrueshëm të shërbimeve të specializuara për DhBGj-në.

**Paketa emergjente ushqimore dhe higjienike**
| Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore | 3,960,000 | 3,960,000 | 4,158,000 | 4,365,900 |
| Shpenzime operative | 1,533,300 | 1,533,300 | 1,609,965 | 1,690,463 |
| Parandalim dhe ndërgjegjësim | – | – | – | – |
| Pajisje teknike | – | – | – | – |
| Kostot gjithsej | 5,493,300 | 5,493,300 | 5,767,965 | 6,056,363 |

***Burimi: Gruaja te Gruaja për vitin 2025 dhe analizë e autorëve të studimit për periudhën 2026–2028.***

Buxheti aktual vjetor prej 5,493,300 lekësh i lejon strehës të kryejë vetëm operacionet thelbësore, me pagat e stafit që përbëjnë gati 72% të shpenzimeve totale. Struktura e stafit përfshin tre pozicione me kohë të pjesshme - një psikolog, një punonjës social dhe një koordinator financiar - secili me një pagë prej 60,000 lekësh në muaj, të plotësuara nga një ekip në gatishmëri që ofron mbulim emergjence 24-orësh për rreth 100 ditë në vit (1.8 milion lek në vit).

Shpenzimet operative arrijnë në total 28% të buxhetit dhe drejtohen kryesisht drejt shërbimeve (120,000 lek/vit), ushqimit (198,000 lek), ilaçeve dhe analizave mjekësore (220,000 lek) dhe materialeve që lidhen me fëmijët (190,000 lek). Këto shpërndarje mbulojnë vetëm nevojat më themelore, duke lënë pak hapësirë për trajnimin e stafit, shtrirjen në terren ose mbështetjen për riintegrimin e të mbijetuarve. Kështu, struktura financiare mbështet ofrimin minimal të shërbimeve, duke siguruar kujdes në nivelin e jetesës, por duke kufizuar aftësinë e strehës për të ofruar shërbime të vazhdueshme psikosociale, mjekësore dhe për mbështetjen e fëmijëve, të cilat janë thelbësore për rimëkëmbjen afatgjatë dhe fuqizimin e përfituesve, siç parashikohet në IC.

**Përllogaritja e kostove shtesë të nevojshme për plotësimin e mangësive në shërbime dhe përafrimin me Konventën e Stambollit**Vlerësimet e mëposhtme u morën nga intervistat me OJQ-në. Ato duhet të interpretohen si kosto shtesë që plotësojnë buxhetin ekzistues të strehës.

**Staf shtesë**

Aktualisht, OJQ-ja punëson Menaxherin Administrativ dhe Financiar me kohë të plotë, ndërsa Psikologu dhe Punonjësi Social janë të angazhuar me kohë të pjesshme; parashikohet që stafi shtesë (aktualisht në pritje) të ofrojë 100 ditë mbulim 24-orësh me një kosto të vlerësuar prej 18,000 lekësh në ditë. Megjithatë, intervistat zbuluan se numri i kufizuar i stafit nuk lejon ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve ose pajtueshmërinë e plotë me standardet kombëtare për kujdesin multidisiplinar 24/7. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 505, datë 13.07.2011, strehëzat duhet të garantojnë akses në mbështetje menaxhuese, psikosociale, mjekësore dhe riintegrimi për të gjithë përfituesit dhe fëmijët që i shoqërojnë. Kodi i Sigurimeve Shoqërore (Neni 23) urdhëron më tej që shërbime të tilla të jenë të disponueshme në mënyrë të vazhdueshme dhe të integruar. Për të adresuar këto boshllëqe, kërkohen disa pozicione shtesë për të siguruar ofrimin efektiv dhe të qëndrueshëm të shërbimeve dhe nivelet e propozuara të pagave bazohen në kostot aktuale të stafit dhe

krahasohen me normat mbizotëruese të tregut për pozicione të krahasueshme. Të gjitha pozicionet shtesë të kërkuara për strehën përfshijnë:

- Nevojitet një Drejtor për të siguruar menaxhimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të të gjitha operacioneve në strehë. Kostoja e këtij pozicioni vlerësohet në 140,000 lekë në muaj, duke arritur në 1,680,000 lekë në vit.
- Një Menaxher Rasti është i nevojshëm për të koordinuar ndërhyrjet shumëdisiplinore, për të mbikëqyrur përgatitjen e planeve individuale të shërbimit dhe për të ruajtur lidhjet me institucionet e punësimit dhe mbrojtjes sociale. Kostoja e Menaxherit të Rastit vlerësohet në 90,000 lekë në muaj ose 1,080,000 lekë në vit.
- Një infermiere kërkohet për të ofruar ndihmën e parë, për të monitoruar gjendjen e vazhdueshme shëndetësore dhe për të koordinuar aksesin në shërbime të specializuara shëndetësore. Ky pozicion është kritik duke pasur parasysh rastet e shpeshta të traumave fizike, sëmundjeve kronike dhe varësisë nga substancat midis banorëve. Kostoja e vlerësuar për një Infermiere me kohë të pjesshme është 70,000 lekë në muaj për gjashtë muaj, ose 420,000 lekë në vit.
- Një Kujdestar për Fëmijë/Staf Edukativ do të ofrojë ndihmë të përditshme për të miturit përmes aktiviteteve të të nxënit, lojës dhe mbështetjes emocionale, duke siguruar që nevojat e tyre zhvillimore dhe arsimore të përmbushen. Ky pozicion i përgjigjet Nenit 18 të Kodit të Brendshëm Individual, i cili përfshin detyrimin për të ofruar kujdes të përshtatshëm për moshën dhe të ndjeshëm ndaj fëmijës. Kostoja e vlerësuar për këtë pozicion është 86,000 lekë në muaj, që korrespondon me 1,032,000 lekë në vit
- Një avokat me kohë të pjesshme është thelbësor për t'u ofruar të mbijetuarve ndihmë ligjore në kohë, duke përfshirë përgatitjen e urdhrave të mbrojtjes, dokumentacionin ligjor, përfaqësimin në procedurat gjyqësore dhe administrative, si dhe referimet brenda sistemit të drejtësisë. Ndërsa Shqipëria ofron ndihmë ligjore falas të financuar nga shteti, mbështetja ligjore brenda strehimoreve mbetet e nevojshme sepse të mbijetuarit shpesh kërkojnë ndihmë ligjore të menjëhershme, të informuar mbi traumën dhe të integruar, e cila koordinohet ngushtë me menaxhimin e rasteve, mbështetjen psikosociale dhe planifikimin e sigurisë. Kjo u mundëson të mbijetuarve të kenë akses në mbrojtje ligjore menjëherë gjatë periudhës kritike pas pranimit në strehimore. Përfshirja e mbështetjes ligjore është në përputhje me nenet 57–59 të Konventës së Stambollit, të cilat garantojnë aksesin e viktimave në ndihmë ligjore dhe mjete efektive gjyqësore. Kostoja e një avokati me kohë të pjesshme vlerësohet në 60,000 lekë në muaj për 12 muaj, duke arritur në 720,000 lekë në vit.
- Propozohet një pozicion Sanitar/Kuzhinier për të trajtuar detyrat e përgatitjes së ushqimit, higjienës dhe dezinfektimit brenda objektit. Kostoja vjetore për këtë pozicion është 744,000 lekë, bazuar në një pagë mujore prej 62,000 lekësh. • Përveç pozicioneve të reja të mësipërme, rregullimi ekzistues i personelit kërkon përshtatje për të siguruar ofrimin e vazhdueshëm të shërbimit. Psikologu dhe Punonjësi Social, aktualisht të angazhuar me kohë të pjesshme, duhet të shndërrohen në pozicione me kohë të plotë për të garantuar mbështetje psikosociale dhe menaxhim të pandërprerë të rasteve, me një kosto bruto mujore prej 90,000 lekësh (1,080,000 lekësh në vit) dhe 80,000 lekësh (960,000 lekësh në vit), përkatësisht. Ekipi i gatishmërisë që ofron 100 ditë mbulim 24-orësh në vit mbahet me 18,000 lekësh në ditë (1,800,000 lekësh në vit), ekuivalent me afërsisht 2.5 staf shtesë me kohë të plotë. Krahasuar me buxhetin aktual të pagave prej 3,960,000 lekësh, këto përshtatje sjellin një kosto shtesë prej 600,000 lekësh në vit, e cila, së bashku me pozicionet e reja (5,676,000 lekësh), e çon koston totale shtesë të personelit në 6,276,000 lekësh.

**Mbikëqyrja profesionale e personelit**

Seancat e rregullta të mbikëqyrjes profesionale të personelit janë thelbësore për parandalimin e ezaurimit profesional dhe traumës dytësore te këshilluesit dhe punonjësit socialë që trajtojnë çdo ditë raste të DhBGj-së me nivel të lartë stresi. Mbikëqyrja mujore në grup (2 500 lekë × 5 pjesëmarrës) është planifikuar për të siguruar mbështetje të strukturuar psikologjike për personelin e vijës së parë, me një shumë të përgjithshme prej 150 000 lekësh.

**Shërbimet e specializuara shëndetësore (të jashtme)**

Disa të mbijetuara kanë nevojë për ndërhyrje mjekësore përtej paketës së përgjithshme të kujdesit shëndetësor që mbulohet nga strehëza. Bazuar në përvojën e mëparshme, mesatarisht dy përfituese në muaj referohen për vizita mjekësore të jashtme dhe secila ka nevojë për dy seanca. Kjo rezulton në afërsisht 48 seanca në vit.

Bazuar në tarifat zyrtare që zbatohen në spitalet universitare, 3 000 lekë për vizitë, spitalet rajonale, 2 000 lekë për vizitë, dhe spitalet e rretheve, 1 500 lekë për vizitë, kostoja mesatare për njësi e një vizite mjekësore vlerësohet në 2 167 lekë. Për rrjedhojë, kostoja vjetore e parashikuar arrin në 104 016 lekë (48 seanca × 2 167 lekë).

Nëse shteti nuk i heq tarifat për personat që kanë pësuar dhunë, këto shpenzime janë thelbësore për të garantuar përputhshmërinë me standardet e Konventës së Stambollit, të cilat kërkojnë që strehëzat të sigurojnë aksesin e të mbijetuarave në kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës, përfshirë mbështetjen e specializuar mjekësore dhe psikologjike.

**Mbështetja për qiranë dhe ushqimin pas largimit nga strehëza**

Në përputhje me nenin 23 të Konventës së Stambollit, i cili kërkon strehim të përshtatshëm dhe të aksesueshëm, si dhe me politikat kombëtare të riintegrimit, ofrohet mbështetje e përkohshme për qiranë dhe shpenzimet e jetesës për të mbijetuarat që largohen nga strehëza. Modeli supozon se 25 përfituese, gjysma e rasteve vjetore, do të kenë nevojë për këtë mbështetje, secila për tre muaj, me 25 000 lekë në muaj, duke përfshirë 15 000 lekë për qiranë dhe 10 000 lekë për ushqimin. Kjo rezulton në një kosto prej 1 875 000 lekësh në vit.

Veprimtaritë informuese dhe të komunikimit

Për të forcuar ndërgjegjësimin e komunitetit dhe rrjetet e referimit, strehëza parashikon zbatimin e veprimtarive mujore informuese dhe promovuese. Këto do të përfshijnë fushata ndërgjegjësimi, veprimtari të angazhimit të komunitetit dhe prodhimin e materialeve promovuese dhe informuese, me një kosto të përgjithshme të vlerësuar prej 12 000 lekësh në muaj, e barasvlershme me 144 000 lekë në vit.

**Pajisjet e zyrës (shpenzim i njëhershëm)**

Për të ruajtur vazhdimësinë e shërbimit dhe dokumentimin efikas, strehëzës i nevojiten dy kompjuterë portativë dhe një printer. Investimi, megjithëse i vogël, është rreth 171 000 lekë si blerje e njëhershme.

**Përshtatjet për aksesueshmërinë (shpenzim i njëhershëm)**

Për të siguruar që strehëza përmbush standardet e miratuara të shërbimit dhe ofron akses të barabartë për të gjithë përfituesit, në buxhet janë përfshirë punimet e përshtatjes për aksesin e personave me aftësi të kufizuara. Këto punime janë thelbësore për të akomoduar të mbijetuarat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët me kufizime në lëvizje, duke e përafruar strukturën me parimet e përfshirjes dhe mosdiskriminimit.

Shpenzimet kapitale të parashikuara përfshijnë ndërtimin e rampave, të vlerësuara në 50 000 lekë, për të siguruar hyrje pa pengesa; instalimin e sinjalistikës së aksesueshme të brendshme dhe të jashtme, të vlerësuar në 20 000 lekë, për të orientuar personat me kufizime në lëvizje ose dëmtime të shikimit; dhe përshtatjen e dy tualeteve, me një kosto prej 100 000 lekësh, për të siguruar që mjediset sanitare të mund të përdoren nga personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet dyerve më të gjera, shufrave mbështetëse dhe pajisjeve të aksesueshme.

Kostoja e përgjithshme e vlerësuar e këtyre punimeve është 170 000 lekë, duke përfaqësuar një investim të nevojshëm për të garantuar që të mbijetuarat me aftësi të kufizuara të mund të kenë akses në shërbimet e strehëzës në mënyrë të sigurt, dinjitoze dhe të pavarur.

**Sistemi i sigurisë (shpenzim i njëhershëm)**
Duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të rasteve të DhBGj-së dhe rreziqet e mundshme për sigurinë, nevojitet një sistem kamerash sigurie dhe alarmi për të mbrojtur banoret dhe personelin. Kjo kosto e njëhershme është 80 000 lekë, bazuar në çmimin mesatar të tregut.
Në total, kostot shtesë të vlerësuara për tri vitet e ardhshme paraqiten në mënyrë të detajuar në në tabelën më poshtë.

**Tabela 15. Kostot shtesë të parashikuara për organizatën "Gruaja te Gruaja" (2026–2028)**

| Shërbimi sipas Konventës së Stambollit | Zëri buxhetor (numri dhe emërtimi) | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|---|
| Personel shtesë | Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore | 6,276,000 | 6,589,800 | 6,919,290 |
| Supervizimi i stafit (në grup dhe individual çdo tremujor) | Shpenzime operative – Trajnime (llogaria nr. 602) | 150,000 | 157,500 | 165,375 |
| Shërbime të specializuara shëndetësore (të jashtme) | Shpenzime operative – Shërbime mjekësore (llogaria nr. 602) | 104,016 | 109,217 | 114,678 |
| Mbështetje për pagesën e qirasë pas largimit nga strehëza | Shpenzime operative – Qira (llogaria nr. 602) | 1,875,000 | 1,968,750 | 2,067,188 |
| Informim në komunitet dhe komunikim | Parandalim dhe ndërgjegjësim (llogaria nr. 602) | 144,000 | 151,200 | 158,760 |
| Pajisje zyre | Shpenzime kapitale – Pajisje zyre (llogaria nr. 231) | 171,000 | – | – |
| Përshtatje për përmirësimin e aksesueshmërisë (shpenzim kapital i njëhershëm) | Shpenzime kapitale (llogaria nr. 231) | 170,000 | – | – |
| Sistem sigurie | Shpenzime kapitale – Pajisje zyre (llogaria nr. 231) | 80,000 | – | – |
| **Gjithsej** | | **8,970,016** | **8,976,467** | **9,425,290** |

**Buxheti i vlerësuar për periudhën 2026–2028, duke përfshirë kostot shtesë**
Ekipi kërkimor ka hartuar një buxhet të përgjithshëm për strehëzën për periudhën 2026–2028, duke u mbështetur në strukturën aktuale të kostove të Qendrës, siç paraqitet në seksionin "Buxheti i vlerësuar për periudhën 2026–2028". Parashikimet përdorin buxhetin e vitit 2025 si bazë, duke pasqyruar kostot ekzistuese, dhe përfshijnë kostot shtesë të nevojshme për forcimin dhe zgjerimin e ofrimit të shërbimeve.

**Tabela 16. Buxheti i vlerësuar për Qendrën "Gruaja tek Gruaja", duke përfshirë kostot shtesë të nevojshme për periudhën 2026–2028, në lekë**

| Zëri buxhetor (numri dhe emërtimi) | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore | 10,236,000 | 10,747,800 | 11,285,190 |
| Shpenzime operative | 3,662,316 | 3,845,432 | 4,037,703 |
| Parandalim dhe ndërgjegjësim | 144,000 | 151,200 | 158,760 |
| Shpenzime kapitale | 421,000 | – | – |
| Kostot gjithsej | 14,463,316 | 14,744,432 | 15,481,653 |

### Sfidat dhe përparësitë

Për strehëzën e Qendrës "Gruaja tek Gruaja", kufizimet e kapaciteteve janë të theksuara. Me vetëm tetë shtretër dhe tri hapësira familjare, kërkesa arrin ose tejkalon rregullisht kapacitetin e disponueshëm. Mungesa e një mekanizmi shtetëror që e lidh financimin me numrin e rasteve do të thotë se rritja e kërkesës nuk mund të shoqërohet me burime përkatëse. Kjo sjell akses të kufizuar, kohë pritjeje ose mbështetje te zgjidhjet rast pas rasti, të cilat cenojnë cilësinë e shërbimeve.

Kufizimet në të dhëna i shtojnë më tej këto vështirësi. Megjithëse Qendra administron të dhëna për përfitueset të ndara sipas gjinisë dhe moshës, asaj i mungon ndarja sistematike e të dhënave sipas përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar ose origjinës gjeografike. Për pasojë, gratë rome dhe egjiptiane, gratë me aftësi të kufizuara, të mbijetuarat LGBTQ+ dhe gratë rurale mund të jenë të nënpërfaqësuara në proceset e planifikimit dhe buxhetimit, edhe kur përballen me pengesa në mënyrë joproporcionale të larta për aksesin në shërbime. Kjo kufizon aftësinë e organizatës për të zbatuar buxhetimin ndërsektorial ose për të përllogaritur nevojat e diferencuara në përputhje me standardet e BPGj-së.

Sistemi i bazuar në Excel për gjurmimin e përfitueseve e kufizon më tej analizën e prirjeve afatgjata, vlerësimin e kostos për përfituese dhe kryqëzimin e të dhënave që nevojitet për të lidhur planifikimin financiar me rezultatet e shërbimeve. Në fund, këto mangësi pengojnë si buxhetimin e bazuar në të dhëna, ashtu edhe advokimin strategjik për sigurimin e financimit publik.

Megjithëse Qendra "Gruaja tek Gruaja" nuk publikon të dhëna të përmbledhura për përfitueset, personeli tregoi se kjo lidhet me kapacitetet e kufizuara të brendshme dhe me mungesën e një kërkese formale për publikimin e përmbledhjeve statistikore që nuk përmbajnë të dhëna personale. Për këtë arsye, gjatë intervistës nuk u vunë në dispozicion të dhëna të hollësishme për numrin e përfitueseve.

## Qendra Vatra (Strehëz afatgjatë)

### Përgjegjësitë dhe kuadri ligjor

Organizata jofitimprurëse "Vatra" është një qendër e specializuar psikosociale shqiptare që ofron shërbime parandalimi, mbrojtjeje, rehabilitimi dhe riintegrimi për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore dhe shoqërore. E themeluar në vitin 1999 dhe e licencuar që prej vitit 2004 nga Qendra Kombëtare

e Licencimit, "Vatra" ofron shërbime rezidenciale dhe komunitare në përputhje me legjislacionin kombëtar që rregullon shërbimet e kujdesit dhe të mbrojtjes sociale.

Në përputhje me Ligjin nr. 9669/2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" dhe angazhimet e Shqipërisë sipas Konventës së Stambollit, "Vatra" ka mandatin të ofrojë mbështetje gjithëpërfshirëse për të mbijetuarat, duke përfshirë strehimin emergjent, këshillimin psikosocial, ndihmën juridike, menaxhimin e rasteve, mbështetjen shëndetësore dhe shërbimet e riintegrimit afatgjatë. Puna e saj është gjithashtu në përputhje me kuadrin kombëtar për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave.

Përgjegjësia operative për përmbushjen e këtyre detyrimeve i takon Drejtorit/es së Strehëzës dhe Koordinatorit/es së Riintegrimit, të mbështetur nga një ekip shumëdisiplinor që përfshin punonjës/e socialë/e dhe menaxherë/e rastesh, psikologë/e, specialistë/e juridikë/e, profesionistë/e të shëndetësisë, specialistë/e të arsimit dhe punësimit, si dhe personel administrativ dhe financiar. Kjo strukturë siguron si ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve të specializuara për përfitueset, ashtu edhe përmbushjen e kërkesave rregullatore, të licencimit dhe të raportimit.

Qendra "Vatra" u përfshi në këtë studim sepse përmbushi kriteret e kampionimit të përcaktuara në metodologji. Ajo është një nga strehëzat e pakta të specializuara në Shqipëri që mundi të siguronte të dhëna financiare të plota, të verifikueshme dhe shumëvjeçare, informacion të detajuar për personelin dhe dokumentacion të strukturuar të programeve, të nevojshëm për një analizë të qëndrueshme të kostimit dhe buxhetit. Gjetjet e paraqitura në këtë seksion mbështeten në dokumentacionin institucional, të dhënat e detajuara të buxhetit dhe shpenzimeve për periudhën 2022–2025 dhe informacionin cilësor të siguruar nëpërmjet intervistave me drejtuesit e lartë dhe personelin e programeve.

**Kapacitetet për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor**

Përfaqësuesit e Qendrës "Vatra" tregojnë një kuptim të qëndrueshëm të parimeve të BPGj-së, veçanërisht për sa lidhet me detyrimet ligjore të Shqipërisë sipas Konventës së Stambollit dhe legjislacionit kombëtar për shërbimet e kujdesit shoqëror. Megjithatë, ashtu si te shumë ofrues të shërbimeve të specializuara, BPGj-ja zbatohet më shumë si një kuadër raportimi sesa si një instrument i integruar buxhetimi dhe planifikimi.

Buxhetimi vjetor strukturohet rreth komponentëve kryesorë të shërbimit, duke përfshirë funksionimin e strehëzës, programet e rehabilitimit dhe riintegrimit, pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore të personelit, ushqimin dhe artikujt thelbësorë, shpenzimet operative dhe pajisjet teknike. Ushtrime të pjesshme kostimi kryhen rregullisht për të përmbushur kërkesat e raportimit të donatorëve dhe të shtetit, veçanërisht për shërbimet e rehabilitimit dhe riintegrimit. Ende nuk është kryer një ushtrim gjithëpërfshirës kostimi, i harmonizuar në mënyrë të qartë me standardet e Konventës së Stambollit.

Përgatitja e buxhetit koordinohet brenda organizatës nga punonjësi/ja i/e financës, në bashkëpunim të ngushtë me drejtuesit e programeve dhe personelin administrativ. Megjithëse ky koordinim siguron vazhdimësinë e funksionimit, proceset e buxhetimit nuk lidhen në mënyrë sistematike me treguesit e bazuar në rezultate, planifikimin afatgjatë të qëndrueshmërisë financiare ose mekanizmat formalë të monitorimit të BPGj-së. Monitorimi i shpenzimeve dhe alokimeve mbështetet kryesisht në kuadrin e raportimit të donatorëve dhe në rishikimet e brendshme vjetore, pa ndonjë lidhje formale me PBA-në e Shqipërisë.

Qëndrueshmëria financiare e Qendrës "Vatra" mbetet shumë e varur nga një model i përzier financimi. Financimi shtetëror, kryesisht nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nëpërmjet Këshillit të Qarkut Vlorë dhe Bashkisë Vlorë, mbulon pagat e personelit dhe kostot e ushqimit dhe ka shfaqur një prirje rritëse graduale. Megjithatë, financimi nga donatorët vazhdon të luajë një rol thelbësor në mbështetjen e veprimtarive të rehabilitimit, riintegrimit, parandalimit, ngritjes së kapaciteteve dhe advokimit, me parashikueshmëri të kufizuar përtej cikleve afatshkurtra ose afatmesme të projekteve.

**Përfitueset dhe kërkesa për shërbime**
Qendra "Vatra" mban të dhëna të strukturuara për përfitueset që marrin shërbime nëpërmjet strehëzës dhe programeve të saj të riintegrimit. Të dhënat për përfitueset ndahen rregullisht sipas gjinisë dhe moshës, duke i mundësuar organizatës të gjurmojë gratë e mbijetuara dhe fëmijët e tyre si përdoruesit kryesorë të shërbimeve. Vetëm gjatë vitit 2025, "Vatra" mbështeti 166 të mbijetuara dhe 54 fëmijë, duke përfshirë raste të reja dhe raste në vazhdim nga viti i mëparshëm.

Megjithatë, të dhënat nuk ndahen në mënyrë sistematike sipas përkatësisë etnike, statusit të aftësisë së kufizuar ose historikut të migrimit, pavarësisht rëndësisë së pranuar të këtyre dimensioneve për planifikimin dhe buxhetimin e shërbimeve. Kjo kufizon kapacitetin e Qendrës për të kryer analiza shumëdimensionale të kërkesës për shërbime, për të vlerësuar kostot e diferencuara sipas grupit të përfitueseve ose për të integruar plotësisht parimet e BPGj-së në planifikimin financiar.

Kërkesa për shërbimet e Qendrës "Vatra" e tejkalon vazhdimisht kapacitetin e disponueshëm. Gratë e mbijetuara, shpesh të shoqëruara nga fëmijët, përbëjnë shumicën e rasteve, duke përfshirë një numër të konsiderueshëm viktimash të trafikimit, shtetasish të huaj dhe personash që kanë nevojë për mbështetje afatgjatë për riintegrim. Megjithëse ndër përfitueset ka gra nga komunitetet rome dhe egjiptiane dhe gra me aftësi të kufizuara, ka të ngjarë që ato t'i përdorin shërbimet më pak sesa kanë nevojë. Për rrjedhojë, niveli i nevojës ka të ngjarë të nënvlerësohet për shkak të pengesave që lidhen me aksesueshmërinë, stigmën dhe shtrirjen e kufizuar në komunitet.

Qendra "Vatra" nuk publikon në mënyrë rutinë statistika të përmbledhura për përfitueset, pasi nuk ekziston një kërkesë formale për publikimin e të dhënave operative jopersonale. Si rezultat, prirjet e kërkesës vlerësohen kryesisht brenda organizatës. Personeli raporton një rritje të vazhdueshme si të kompleksitetit, ashtu edhe të numrit të rasteve, të nxitur nga përmirësimi i identifikimit, shtrirja në komunitet nëpërmjet njësive të lëvizshme dhe koordinimi më i fortë me mekanizmat e referimit.

Kërkesa e ardhshme pritet të rritet më tej me zgjerimin e veprimtarive ndërgjegjësuese, përmirësimin e koordinimit nëpërmjet Mekanizmave të Koordinuar të Referimit dhe shtrirjen e shërbimeve te popullatat në situatë vulnerabiliteti dhe migrantët. Të dhënat cilësore të disponueshme nga ofruesit e shërbimeve sugjerojnë se përpjekjet e shtuara për shtrirje dhe identifikim kanë kontribuar tashmë në zbulimin e një numri më të lartë rastesh, megjithëse kjo prirje nuk pasqyrohet ende në mënyrë sistematike në të dhënat kombëtare. Kjo nënkupton se alokimet e ardhshme buxhetore duhet të marrin në konsideratë jo vetëm kërkesën bazë, por edhe rritjen e nevojave për shërbime që lidhet me përmirësimin e raportimit, identifikimit dhe kërkesave për riintegrim, veçanërisht për të mbijetuarat e huaja dhe rastet komplekse të trafikimit.

**Ushtrimet e kostimit dhe alokimet buxhetore 2022–2024**

Qendra "Vatra" ka kryer ushtrimet e veta të brendshme të kostimit, kryesisht me kërkesë të donatorëve. Kostimi më i fundit gjithëpërfshirës u krye në vitin 2024, me fokus të fortë në shërbimet e rehabilitimit dhe riintegrimit. Parashikimet e kostove mbështeten në analizën e shpenzimeve të mëparshme, prirjet në numrin dhe profilet e përfitueseve dhe llojet e shërbimeve të ofruara në kuadër të pesë programeve kryesore të Qendrës "Vatra": parandalimi; ndihma e drejtpërdrejtë dhe strehimi; aksesi në drejtësi; ngritja e kapaciteteve; dhe advokimi.

Procesi i buxhetimit mbështetet në të dhënat historike të shpenzimeve, të dhënat e menaxhimit të rasteve dhe prirjet e kërkesës për shërbime. Qendra "Vatra" merr gjithashtu në konsideratë kohëzgjatjen mesatare të qëndrimit dhe nevojat në ndryshim të grupeve të ndryshme të përfitueseve, duke përfshirë të mbijetuarat e trafikimit dhe të dhunës me bazë gjinore. Që prej mesit të vitit 2024, një bazë e përmirësuar e të dhënave për përfitueset ka mbështetur parashikime më të sakta.

Financimi i Qendrës "Vatra" vjen nga një strukturë e përzier dhe relativisht e paqëndrueshme financimi. Financimi shtetëror merret kryesisht nëpërmjet mekanizmit të Fondit Social, si dhe thirrjeve periodike të Ministrisë së Drejtësisë dhe ministrive të tjera. Këto alokime nuk garantohen çdo vit dhe varen nga proceset konkurruese të aplikimit.
Bashkia Vlorë ofron mbështetje në natyrë, si mbulimi i qirasë së strehëzës, shërbimeve utilitare dhe disa kostove operative. Financimi nga donatorët luan një rol thelbësor dhe përfshin mbështetje nga UN Women, UNDP, UNHCR-ja, GIZ-i, AWEN-i, Terre des Hommes dhe organizata të tjera, zakonisht mbi bazë projekti dhe pa siguri afatgjatë. Tabela më poshtë paraqet shpenzimet për periudhën 2022–2025.

**Tabela 17. Struktura vjetore e kostove të strehëzës sipas zërave buxhetorë (2022–2025, në lekë)**

| Zëri buxhetor (numri dhe emërtimi) | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 (parashikim) |
|---|---|---|---|---|
| **Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore** | 13,683,612 | 13,925,114 | 17,900,000 | 18,398,142 |
| **Kostot e rehabilitimit dhe riintegrimit** | 17,220,664 | 18,083,430 | 18,743,600 | 18,769,470 |
| **Shpenzime operative** | 6,378,603 | 6,021,924 | 7,086,380 | 8,013,120 |
| **Pajisje teknike** | 114,300 | 341,000 | 231,000 | 229,801 |
| **Kostot gjithsej** | **37,397,179** | **38,371,468** | **43,960,980** | **45,410,533** |

**Tabela 18. Annual Cost Structure of the Shelter by Budget Line (2022–2025, ALL)**

| Budget line (# name) | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 (forecast) |
|---|---|---|---|---|
| Salaries and social contributions | 13,683,612 | 13,925,114 | 17,900,000 | 18,398,142 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Rehabilitation and reintegration cost | 17,220,664 | 18,083,430 | 18,743,600 | 18,769,470 |
| Operational expenditures | 6,378,603 | 6,021,924 | 7,086,380 | 8,013,120 |
| Technical equipment | 114,300 | 341,000 | 231,000 | 229,801 |
| **Total costs** | **37,397,179** | **38,371,468** | **43,960,980** | **45,410,533** |

Ndërmjet viteve 2022 dhe 2023, kostot e përgjithshme të Qendrës "Vatra" mbetën përgjithësisht të qëndrueshme (+2,6%). Pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore u rritën lehtë (+1,8%). Kostot e rehabilitimit dhe riintegrimit u rritën në mënyrë të moderuar (+5,0%), duke treguar një zgjerim gradual të shërbimeve të mbështetjes së drejtpërdrejtë. Shpenzimet operative u ulën lehtë (-5,6%), ndërsa shpenzimet për pajisjet teknike u rritën ndjeshëm (+198%), të lidhura me disa investime të njëhershme në pajisjet dhe mjetet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve.
Nga viti 2023 në vitin 2024, shpenzimet e përgjithshme u rritën ndjeshëm (+14,6%), duke shënuar një zgjerim të veprimtarive. Faktori kryesor ishte rritja e pagave (+28,6%) në vitin 2024. Shpenzimet operative gjithashtu u rritën përsëri (+17,7%), duke pasqyruar intensitetin më të lartë të programeve dhe nevojat në rritje të funksionimit të strehëzës, mbështetjes juridike, këshillimit dhe logjistikës. Kostot e rehabilitimit dhe riintegrimit vazhduan të rriteshin (+3,6%), duke konfirmuar angazhimin e vazhdueshëm për mbështetjen e të mbijetuarave. Shpenzimet për pajisjet teknike u ulën (-32,3%) pas investimeve të vitit të mëparshëm.
Për vitin 2025, kostot e përgjithshme parashikohej të rriteshin në mënyrë më të moderuar (+3,3%). Shpenzimet për rehabilitimin dhe riintegrimin mbetën të qëndrueshme, duke sugjeruar një nivel të pandryshuar të ofrimit të shërbimeve. Shpenzimet operative parashikohej të rriteshin (+13,1%) për shkak të zgjerimit të nivelit të veprimtarive, ndërsa shpenzimet për pajisjet teknike mbetën përgjithësisht të pandryshuara.
Është e rëndësishme të theksohet se programet e parandalimit, ngritjes së kapaciteteve dhe promovimit financohen veçmas nga donatorët dhe nuk përfshihen në këto shifra. Struktura e financimit të tyre i mundëson Qendrës "Vatra" të zgjerojë përpjekjet për ndërgjegjësim dhe parandalim, duke ruajtur njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare të shërbimeve bazë të strehimit dhe mbështetjes.

**Parashikimet për periudhën 2026–2028 (PBA)**

Qendra përgatiti parashikimet e shpenzimeve për vitet pasuese në përputhje me metodologjinë e përshkruar në Kapitullin 2. Nënseksionet në vijim paraqesin: (1) shpenzimet bazë të parashikuara për periudhën 2026–2028; (2) vlerësimet e kostove shtesë të nevojshme për plotësimin e boshllëqeve në shërbime dhe përafrimin me Konventën e Stambollit; dhe (3) buxhetin e përgjithshëm të vlerësuar, duke përfshirë kostot shtesë.

**Shpenzimet bazë të parashikuara për periudhën 2026–2028**

Bazuar në përvojën e mëparshme dhe në kostot e parashikuara për periudhën e ardhshme, Qendra "Vatra" ka vlerësuar buxhetin e saj të përgjithshëm për periudhën 2026–2028 (shih Tabelën më poshtë). Ky buxhet pasqyron strukturën aktuale të shpenzimeve dhe modelin e funksionimit të Qendrës, siç janë evidentuar gjatë viteve të fundit.

**Tabela 19. Përllogaritjet buxhetore në lekë**

| Zëri buxhetor (numri dhe emërtimi) | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore | 22,700,560 | 27,129,428 | 27,219,933 |
| Programi i rehabilitimit dhe riintegrimit | 23,517,196 | 23,595,160 | 23,700,320 |
| Shpenzime operative | 8,313,120 | 8,213,120 | 8,415,122 |
| Shpenzime kapitale | 340,300 | 350,000 | 384,420 |
| **Kostot gjithsej** | **54,871,176** | **59,287,708** | **59,719,795** |

*Burimi: Vatra, për periudhën 2026–2028.*

**Tabela 20: Budget Estimates in ALL**

| Budget line (# name) | | | |
|---|---|---|---|
| | 2026 | 2027 | 2028 |
| Salaries and social contribution | 22,700,560 | 27,129,428 | 27,219,933 |
| Rehabilitation and reintegration program | 23,517,196 | 23,595,160 | 23,700,320 |
| Operational expenditures | 8,313,120 | 8,213,120 | 8,415,122 |
| Capital expenditures | 340,300 | 350,000 | 384,420 |
| **Total costs** | **54,871,176** | **59,287,708** | **59,719,795** |

*Source: Vatra for 2026-2028*

Buxheti vjetor i parashikuar prej 54,9 deri në 59,7 milionë lekësh për periudhën 2026–2028 i mundëson strehëzës të ruajë funksionimin bazë, duke forcuar njëkohësisht shërbimet e riintegrimit për të mbijetuarat. Pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore të personelit përbëjnë zërin më të madh të shpenzimeve, duke u rritur nga 41% e kostove të përgjithshme në vitin 2026 në rreth 46% në vitet 2027–2028. Kjo pasqyron nevojën për një ekip më të fuqishëm shumëdisiplinor për trajtimin e rasteve gjithnjë e më komplekse.

Programi i Rehabilitimit dhe Riintegrimit përfaqëson në mënyrë të vazhdueshme rreth 40–43% të buxhetit, duke mbuluar mbështetjen psikosociale, mjekësore, juridike, arsimore dhe të punësimit për përfitueset dhe fëmijët e tyre. Shpenzimet operative përbëjnë afërsisht 14–15%, duke siguruar funksionimin e përditshëm të strehëzës, ndërsa shpenzimet kapitale mbeten minimale, nën 1%, dhe kufizohen në pajisjet thelbësore. Në përgjithësi, parashikimi tregon një kalim nga ofrimi minimal i shërbimeve drejt një mbështetjeje më të qëndrueshme, të përqendruar te personeli dhe riintegrimi.

**Kostot shtesë të vlerësuara për periudhën 2026–2028**
Vlerësimet e mëposhtme të kostove për periudhën 2026–2028 u mbështetën në intervistat me Qendrën. Ato duhet të interpretohen si kosto shtesë që plotësojnë buxhetin ekzistues të Qendrës.

**Personeli – Kapacitete shtesë për menaxhimin e rasteve**
Strehëza siguron tashmë funksionet bazë të mbështetjes administrative dhe psikosociale. Megjithatë, intervistat konfirmuan se numri aktual i punonjësve për menaxhimin e rasteve

është i pamjaftueshëm për të garantuar mbështetje të vazhdueshme shumëdisiplinore dhe përputhshmëri të plotë me standardet kombëtare për kujdesin 24/7.

Sipas VKM-së nr. 505, datë 13.07.2011, strehëzat duhet të sigurojnë akses në shërbime psikosociale, mjekësore dhe riintegrimi për të gjitha përfitueset dhe fëmijët që i shoqërojnë. Neni 23 i Konventës së Stambollit kërkon më tej që këto shërbime të jenë të disponueshme në mënyrë të vazhdueshme dhe të integruar. Kompleksiteti në rritje i rasteve dhe kërkesa gjithnjë e më e madhe për mbështetje të individualizuar për riintegrim nxjerrin në pah nevojën urgjente për kapacitete shtesë në menaxhimin e rasteve.

Menaxhimi i rasteve është thelbësor për koordinimin e reagimeve emergjente, përgatitjen dhe monitorimin e planeve individuale të mbështetjes, menaxhimin e referimeve pranë institucioneve të punësimit dhe të mbrojtjes sociale, si dhe sigurimin e ndjekjes së rasteve pas largimit nga strehëza.

Vlerësimi i kostos mbështetet në standardet e sektorit publik për pozicione të krahasueshme të punës sociale në Shqipëri. Kostoja mesatare mujore për çdo menaxher/e rasti, duke përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është 119 124 lekë. Kostoja vjetore shtesë për tre menaxherë/e rasti, vetëm për vitin 2026, është 4 288 464 lekë, pasi për vitet e tjera kjo kosto ishte parashikuar tashmë në buxhetin e Qendrës.

**Supervizimi dhe mirëqenia e stafit**
Alokimi përfshin seanca mujore të mbikëqyrjes profesionale në grup për personelin e vijës së parë, me një kosto për njësi prej 2 500 lekësh për pjesëmarrës. Me 12 pjesëmarrës gjatë 12 muajve, kostoja vjetore e mbikëqyrjes profesionale në grup arrin në 360 000 lekë.
Përveç kësaj, buxheti përfshin shërbime plotësuese për mirëqenien e personelit, të cilat janë thelbësore për ruajtjen e qëndrueshmërisë së personelit, cilësisë së shërbimeve dhe vazhdimësisë së kujdesit. Këto masa shtesë për mirëqenien dhe mbështetjen psikologjike vlerësohen në 1 000 000 lekë në vit.

**Shërbimet e interpretimit dhe përkthimit**
Ofrimi i shërbimeve të interpretimit dhe përkthimit është i nevojshëm për të siguruar aksesueshmërinë për gratë e huaja që kërkojnë mbështetje në Qendër. Duke pasur parasysh numrin në rritje të përfitueseve të huaja, interpretimi nevojitet për të garantuar komunikim efektiv, për të siguruar kuptimin e saktë të rasteve të ndjeshme dhe për të ofruar akses të barabartë në shërbimet psikosociale, juridike dhe mjekësore.

Vlerësimi i kostos mbështetet në një tarifë prej 5 000 lekësh për orë, në përputhje me tarifat zyrtare të përcaktuara sipas Udhëzimit "Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e përkthimit zyrtar". Bazuar në përvojën e Qendrës, parashikohet që interpretimi të nevojitet për afërsisht pesë orë në muaj, gjatë 12 muajve, për 60 përfituese të huaja, duke rezultuar në një kosto të përgjithshme vjetore prej 1 500 000 lekësh.

**Shpenzimet noteriale dhe dokumentacioni ligjor**
Megjithëse ekziston tashmë një alokim i vogël për dokumentacionin ligjor, Qendra ka identifikuar nevojën për një rritje të kufizuar për të mbuluar raste shtesë. Të mbijetuarat shpesh kanë nevojë për disa dokumente ligjore, si karta identiteti, certifikata të gjendjes civile ose dokumente të tjera zyrtare, për të përfituar shërbime, për të ushtruar të drejtat e tyre ose për të përfunduar procedurat e riintegrimit.

Duke përdorur një kosto mesatare prej 2 500 lekësh për dokument, kostoja vjetore shtesë vlerësohet në 52 500 lekë. Ky alokim plotëson buxhetin minimal ekzistues dhe siguron që të mbijetuarat të mund të marrin pa vonesë dokumentacionin thelbësor.

**Mbështetje për pagesën e qirasë pas largimit nga strehëza**
Në përputhje me nenin 23 të Konventës së Stambollit, i cili kërkon zgjidhje strehimi të aksesueshme dhe të përshtatshme, mbështetja e përkohshme për qiranë është e nevojshme për të parandaluar kthimin e të mbijetuarave në mjedise të pasigurta ose përballjen e tyre me mungesën e strehimit pas largimit nga strehëza.

Modeli parashikon një alokim mujor prej 25 000 lekësh për person për një periudhë kalimtare gjashtëmujore. Për 50 përfituese në vit, kostoja e përgjithshme vjetore është 7 500 000 lekë. Kjo mbështetje është thelbësore për të mundësuar riintegrimin e sigurt dhe jetesën e pavarur.

**Shpenzimet e Qendrës për transportin e përfitueseve të huaja**
Ndihma për transportin është e nevojshme për të mbështetur kthimin e sigurt të të mbijetuarave të huaja në vendet e tyre të origjinës, në përputhje me standardet e mbrojtjes dhe planet individuale të riintegrimit. Kostoja për person vlerësohet në 120 000 lekë. Për një mesatare prej 40 rastesh të huaja në vit, kostoja e përgjithshme vjetore e transportit arrin në 4 800 000 lekë.

**Përshtatjet për aksesueshmërinë (investim kapital i njëhershëm)**
Për të siguruar që Qendra përmbush standardet e miratuara të shërbimit dhe ofron akses të barabartë për të gjithë përfituesit, kërkohen punime përshtatëse për aksesin e personave me aftësi të kufizuara. Këto ndërhyrje janë në përputhje me parimet e përfshirjes dhe mosdiskriminimit.

Punimet e planifikuara përfshijnë ndërtimin e rampave të aksesit, zgjerimin e dyerve dhe instalimin e pajisjeve sanitare të aksesueshme (tualeteve). Kostoja e përgjithshme e vlerësuar dhe e njëhershme për këto përshtatje të aksesueshmërisë është 170 000 lekë.

Në total, kostot shtesë të parashikuara për tre vitet e ardhshme paraqiten në në tabelën më poshtë.

**Tabela 21. Kostot shtesë të parashikuara për Qendrën Vatra (2026–2028)**

| Shërbimi sipas Konventës së Stambollit | Zëri buxhetor (numri dhe emërtimi) | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|---|
| Personel shtesë | Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore | 4,288,464 | – | – |
| Supervizimi i stafit (në grup dhe individual çdo tremujor) | Shpenzime operative – Trajnime (llogaria nr. 602) | 1,360,000 | 1,428,000 | 1,499,400 |
| Shërbime përkthimi | Shpenzime operative – Përkthime (llogaria nr. 602) | 1,500,000 | 1,575,000 | 1,653,750 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Mbështetje për pagesën e qirasë pas largimit nga strehëza | Shpenzime operative – Qira (llogaria nr. 602) | 7,500,000 | 7,875,000 | 8,268,750 |
| Shpenzime noteriale dhe dokumentacion ligjor | Shpenzime operative – Dokumentacion ligjor (llogaria nr. 602) | 52,500 | 55,125 | 57,881 |
| Shpenzime transporti | Shpenzime operative – Transport (llogaria nr. 602) | 4,800,000 | 5,040,000 | 5,292,000 |
| Përshtatje për përmirësimin e aksesueshmërisë (shpenzim kapital i njëhershëm) | Shpenzime kapitale (llogaria nr. 231) | 170,000 | – | – |
| **Gjithsej** | | **19,670,964** | **15,973,125** | **16,771,781** |

**Buxheti i parashikuar për periudhën 2026–2028, duke përfshirë kostot shtesë**

RA-ja ka përllogaritur buxhetin e përgjithshëm të Qendrës Vatra për periudhën 2026–2028, të përmbledhur në në tabelën më poshtë. Ky buxhet përfshin kostot shtesë të nevojshme për forcimin dhe zgjerimin e ofrimit të shërbimeve.

**Tabela 22. Buxheti i parashikuar për Qendrën Vatra, duke përfshirë kostot shtesë të nevojshme (2026–2028), në lekë**

| Zëri buxhetor (numri dhe emërtimi) | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore | 26,989,024 | 27,129,428 | 27,219,933 |
| Programi i rehabilitimit dhe riintegrimit | 23,517,196 | 23,595,160 | 23,700,320 |
| Shpenzime operative | 23,525,620 | 24,186,245 | 25,186,903 |
| Shpenzime kapitale | 510,300 | 350,000 | 384,420 |
| **Kostot gjithsej** | **74,542,140** | **75,260,833** | **76,491,576** |

**Sfidat dhe përparësitë**

Qendra Psikosociale "Vatra" përballet me një sërë sfidash të ndërlidhura që ndikojnë si në cilësinë, ashtu edhe në qëndrueshmërinë afatgjatë të shërbimeve të saj. Kufizimet e burimeve njerëzore përfaqësojnë një nga trysnitë më kritike. Megjithëse Qendra "Vatra" funksionon me një ekip shumëdisiplinor dhe e ka zgjeruar ndjeshëm gamën e shërbimeve të saj, niveli aktual i personelit është i pamjaftueshëm për t'iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme numrit në rritje dhe kompleksitetit gjithnjë e më të madh të rasteve. Në veçanti, kërkesa për menaxhim intensiv të rasteve, ndjekje afatgjatë gjatë fazës së riintegrimit dhe mbështetje të specializuar juridike dhe psikologjike e tejkalon kapacitetin ekzistues njerëzor. Mosmiratimi i punonjësve socialë shtesë të financuar nga fondet publike e thellon më tej këtë

boshllëk dhe rrit rrezikun e mbingarkesës dhe ezaurimit profesional të personelit, veçanërisht në kushtet e një strehëze afatgjatë.

Një sfidë e dytë madhore lidhet me mbikëqyrjen profesionale dhe mirëqenien e personelit. Megjithëse Qendra "Vatra" e njeh rëndësinë e mbikëqyrjes profesionale dhe të mbështetjes së personelit të informuar mbi traumën, financimi për këto veprimtari mbetet i kufizuar dhe kryesisht i varur nga burimet e donatorëve. Duke pasur parasysh ekspozimin e zgjatur të personelit ndaj rasteve komplekse të trafikimit dhe DhBGj-së, mungesa e mbikëqyrjes sistematike dhe të financuar në mënyrë të përshtatshme rrezikon të cenojë cilësinë e shërbimeve, mbajtjen e personelit dhe vazhdimësinë e kujdesit.

Qëndrueshmëria financiare përbën një sfidë strukturore. Megjithëse Qendra "Vatra" përfiton nga një model i përzier financimi, i cili përfshin kontribute shtetërore — kryesisht për pagat e personelit dhe ushqimin — si dhe mbështetje bashkiake për funksionimin e strehëzës, Qendra mbetet shumë e varur nga financimi afatshkurtër dhe i bazuar në projekte nga donatorët. Kjo krijon pasiguri në planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë, veçanërisht për shërbimet e riintegrimit, mbështetjen pas largimit nga strehëza dhe ndihmën e specializuar për përfitueset e huaja. Rritja e kostove operative që lidhet me inflacionin, kërkesat e sigurisë dhe transportin e shton më tej trysninë financiare. Kjo situatë evidenton një boshllëk më të gjerë sistemik: megjithëse nenet 22 dhe 23 të Konventës së Stambollit kërkojnë financim publik të qëndrueshëm për shërbimet e specializuara, financimi afatgjatë për strehëzat e administruara nga organizatat joqeveritare në Shqipëri mbetet i fragmentuar dhe i institucionalizuar në mënyrë të pamjaftueshme.

Ofrimi i shërbimeve kufizohet gjithashtu nga nevojat e grupeve të veçanta të përfitueseve, veçanërisht të të mbijetuarave të huaja të trafikimit. Këto raste kërkojnë ndihmë juridike të zgjatur, shërbime interpretimi dhe përkthimi, mbështetje për sigurimin e dokumentacionit dhe, në disa raste, transport për kthimin e sigurt në vendet e origjinës. Megjithëse Qendra "Vatra" i ofron në praktikë këto shërbime, kostot përkatëse nuk mbulohen plotësisht ose në mënyrë të parashikueshme nga zërat buxhetorë ekzistues, duke krijuar boshllëqe të përsëritura financimi.

Përveç kësaj, riintegrimi pas largimit nga strehëza përbën një sfidë të vazhdueshme. Kërkesa për strehim kalimtar, subvencione për qiranë dhe mbështetje ekonomike i tejkalon alokimet aktuale, veçanërisht në një kontekst të rritjes së çmimeve të qirave dhe aksesit të kufizuar në banesat publike ose skemat e bonusit të qirasë. Pa mbështetje të mjaftueshme pas largimit nga strehëza, të mbijetuarat përballen me rrezik të shtuar për të mbetur pa strehim, për t'u riviktimizuar ose për t'u kthyer në mjedise të pasigurta.

## Qendra "Të Ndryshëm & Të Barabartë" (strehëz afatgjatë)

### Përgjegjësitë dhe kuadri ligjor

Qendra "Të Ndryshëm & Të Barabartë" funksionon si ofruese e licencuar, joqeveritare, e shërbimeve afatgjata të kujdesit shoqëror, me mandat për të ofruar mbrojtje, rehabilitim dhe riintegrim për viktimat e dhunës dhe trafikimit. Përgjegjësitë e saj përcaktohen nga ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror.[73] si dhe nga Udhëzimi **"Për miratimin e standardeve të shërbimit të strehimit të sigurt emergjent"**[74], i cili përcakton kërkesat për strehëzat,

[73] Republic of Albania, Law No. 121/2016, dated 24 November 2016, "On Social Care Services in the Republic of Albania" (Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë), as amended by Law No. 99/2024, Official Publications Centre (Qendra e Botimeve Zyrtare

[74] Republic of Albania, Ministry of Health and Social Protection, Instruction No. 354, dated 2 June 2022, "On the Approval of Standards for Safe Emergency Shelter Services" (Për miratimin e standardeve për shërbimin e strehimit emergjent të sigurt), State Social Service. https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/UDHEZIM-354-Standartet-sherbim-emergjent-i-sigurte.pdf

duke përfshirë menaxhimin e rasteve, planet individuale të trajtimit dhe monitorimin e vazhdueshëm të respektimit të të drejtave të përfitueseve. Drejtoresha e Qendrës është përgjegjëse për mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve dhe garantimin e përputhshmërisë me këto standarde. Si përfituese e Fondit Social nëpërmjet Qarkut të Tiranës që prej vitit 2022, Qendra raporton pranë Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), duke garantuar njëkohësisht llogaridhënien nëpërmjet raportimit të rregullt pranë Bordit Drejtues.

**Kapacitetet për buxhetim të përgjigjshëm gjinor**
Qendra ka mbi 23 vjet përvojë në punën me gratë dhe vajzat dhe procesi i buxhetimit mbështetet fuqimisht në këtë mandat. Vëmendja ndaj nevojave specifike gjinore përbën një element thelbësor të planifikimit, ndërsa buxheti vjetor hartohet duke pasqyruar nevojat e të mbijetuarave të trafikimit dhe dhunës në familje.
Megjithatë, buxhetimi i përgjigjshëm gjinor ende nuk është institucionalizuar plotësisht. Ndonëse konsideratat gjinore integrohen në praktikë, kjo mbështetet kryesisht në përvojën dhe angazhimin e organizatës dhe jo në metodologji të formalizuara, instrumente sistematike për përllogaritjen e kostove apo procedura të standardizuara në përputhje me parimet e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

**Përfitueset dhe kërkesa për shërbime**
Qendra administron një sistem të strukturuar të dhënash në Excel, ku regjistrohen karakteristikat e hollësishme të çdo përfitueseje, duke përfshirë moshën, gjininë, shtetësinë, vendndodhjen gjeografike (zonë rurale/urbane), statusin e aftësisë së kufizuar, llojin e shfrytëzimit, shërbimet e përfituara, datat e hyrjes dhe të daljes, si dhe kostot e riintegrimit. Çdo rast pajiset me një kod për të garantuar konfidencialitetin. Këto të dhëna përdoren si për raportimin pranë autoriteteve shtetërore dhe donatorëve, ashtu edhe për parashikimin e kostove të ardhshme të shërbimeve.

Një kufizim i rëndësishëm mbetet mungesa e integrimit me bazat e centralizuara të të dhënave të institucioneve shtetërore, i cili do të mundësonte monitorim më sistematik dhe krahasueshmëri ndërmjet institucioneve. Gjithashtu, kostot që lidhen me fëmijët nuk përllogariten plotësisht, ndonëse shumë prej përfitueseve janë nëna me fëmijë, të cilët strehohen së bashku me to dhe kanë gjithashtu nevojë për shërbime të specializuara.

**Tabela 23. Numri faktik dhe i parashikuar i përfitueseve**

| Viti | Të dhënat | Numri i përfitueseve |
|---|---|---|
| **2022** | Faktike | 25 |
| **2023** | Faktike | 25 |
| **2024** | Faktike | 39 |
| **2025** | Parashikim | 40 |
| **2026** | Parashikim | 40 |
| **2027** | Parashikim | 40 |
| **2028** | Parashikim | 40 |

*Burimi: Të Ndryshëm & Të Barabartë, 2025.*

Parashikimet tregojnë një rritje graduale të kërkesës për shërbime, veçanërisht nga të miturit dhe shtetasit e huaj, të nxitur nga flukset globale të migracionit, paqëndrueshmëria rajonale dhe rritja e ndërgjegjësimit publik për shërbimet e Qendrës.75

[75] Interview with the Centre's Director, 2025.

Të dhënat tregojnë një rritje të ndjeshme në vitin 2024, kur numri i përfitueseve arriti në 39, krahasuar me 25 në vitet e mëparshme. Kjo rritje pasqyron si shtimin e rasteve të raportuara dhe të referuara, ashtu edhe njohjen më të madhe institucionale të nevojës për shërbime të specializuara për të mbijetuarat e dhunës seksuale. Për periudhën 2025–2028, Qendra parashikon të mbështesë rreth 40 përfituese në vit.

**Përllogaritja e kostove dhe alokimet buxhetore për periudhën 2022–2024**

Deri më sot, qeveria nuk ka realizuar ndonjë proces sistematik për përllogaritjen e kostove posaçërisht për shërbimet e strehëzave. Qendra ka kryer parashikime të brendshme të kostove në kuadër të projekteve të financuara nga donatorët, duke përgatitur përllogaritje vjetore për periudhën 2022–2027, të cilat mbulojnë personelin, kostot operative dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë për përfitueset. Procesi i buxhetimit merr parasysh kuotat ditore të ushqimit, të përcaktuara çdo vit me urdhër të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH)[76], pagat referuese, të përcaktuara çdo vit nga Këshilli i Ministrave, si dhe prirjet e shpenzimeve të mëparshme, bazuar në përvojën operative të strehëzës.

Financimi i Qendrës sigurohet nga ndërthurja e transfertave shtetërore me kontributet e donatorëve. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), nëpërmjet Fondit Social, ka siguruar financimet më të qëndrueshme shtetërore, të cilat janë rritur me kalimin e kohës dhe parashikohet të rriten më tej gjatë vitit 2025. Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) gjithashtu siguron mbështetje të rregullt vjetore. Burime të tjera, si GIZ-i, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), Terre des Hommes dhe fondacione të ndryshme, kontribuojnë mbi bazë projektesh, pa garantuar vijimësinë e financimit.

Zërat e planifikuar buxhetorë mbulojnë pagat e stafit dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, qiranë dhe shërbimet utilitare, ushqimin, veshmbathjen, barnat dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë për përfitueset, trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve, transportin, karburantin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, si dhe shërbimet e sigurisë. Gjatë periudhës 2022–2024, shpenzimet paraqesin një rritje graduale nominale, të shkaktuar kryesisht nga inflacioni i kostove operative dhe rritja e shpenzimeve për sigurinë.

**Tabela 24. Shpenzimet faktike në lekë**

| Zëri buxhetor (numri dhe emërtimi) | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 (parashikim) |
|---|---|---|---|---|
| **Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore** | 15,516,217* | 16,332,860* | 17,192,484 | 17,192,484 |
| **Shpenzime operative** | 20,649,713 | 19,777,378 | 23,819,540 | 23,301,409 |
| **Parandalim dhe ndërgjegjësim** | 1,191,000 | 456,560 | 350,000 | 1,191,000 |
| **Pajisje teknike** | 240,000 | 598,200 | 372,314 | 372,314 |
| **Kostot gjithsej** | **37,596,930** | **37,164,998** | **41,734,338** | **42,057,207** |

[76] Urdhri më i fundit, "Për indeksimin e kuotës ushqimore për vitin 2025", ishte Urdhri nr. 5398/3, datë 31.07.2025.

*Burimi: Të dhënat e organizatës "Të Ndryshëm & Të Barabartë" mbi shpenzimet; *pagat janë përllogaritur me një rritje vjetore prej 5%.*

Ndërmjet viteve 2022 dhe 2023, kostot e përgjithshme mbetën relativisht të qëndrueshme (−1,1%). Pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore shënuan një rritje të moderuar (+5,3%), ndërsa shpenzimet operative u ulën lehtë (−4,2%). Shpenzimet për parandalimin dhe ndërgjegjësimin ranë ndjeshëm (−61,7%), ndërsa shpenzimet për pajisjet teknike u rritën më shumë se dyfish (+149%), duke treguar një ndryshim të prioriteteve.

Nga viti 2023 në vitin 2024, shpenzimet e përgjithshme u rritën me 12,3%, kryesisht për shkak të rritjes së konsiderueshme të kostove operative (+20,4%) dhe vijimit të rritjes së pagave (+5,3%). Në të kundërt, fondet për parandalimin dhe ndërgjegjësimin u tkurrën më tej (−23,3%), ndërsa shpenzimet për pajisjet teknike u ulën (−37,8%). Në përgjithësi, prirja trevjeçare tregon një rritje të vazhdueshme të kostove të personelit dhe një rritje të fortë të shpenzimeve operative në vitin 2024, ndërkohë që parandalimi dhe ndërgjegjësimi mbeten vazhdimisht të nënfinancuara. Kostot e pajisjeve kanë luhatur në varësi të nevojave specifike.

Në vitin 2024, përveç pagave, pjesa më e madhe e shpenzimeve iu kushtua qirasë së banesave për viktimat (20%) dhe shërbimeve të sigurisë (12,5%), duke pasqyruar kostot e larta për garantimin e strehimit të sigurt dhe mbrojtjes së përfitueseve. Fonde të konsiderueshme u alokuan gjithashtu për ushqimin e viktimave (10,8%) dhe shërbimet e mësuesve/trajnerëve (7,6%). Së bashku, këto kategori përbëjnë mbi 50% të buxhetit të përgjithshëm vjetor, duke dëshmuar se strehimi, siguria dhe mbulimi i nevojave bazë përbëjnë kostot kryesore të Qendrës.

**Parashikimet për periudhën 2026–2028 (PBA)**
Siç u përmend më sipër, Qendra përgatit rregullisht parashikime të shpenzimeve, pasi pjesa më e madhe e financimit të saj sigurohet nga Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), nëpërmjet Fondit Social, si dhe nga donatorë që kërkojnë planifikimin në kohë të buxhetit për të garantuar vijimësinë e pandërprerë të aktiviteteve.

RA-ja përgatiti parashikimet e shpenzimeve për vitet pasuese, në përputhje me metodologjinë e përshkruar në këtë kapitull, duke përdorur si bazë të dhënat buxhetore të Qendrës. Nënseksionet në vijim paraqesin:

- parashikimin bazë të shpenzimeve për periudhën 2026–2028;
- përllogaritjen e kostove shtesë të nevojshme për plotësimin e mangësive në shërbime dhe përafrimin me Konventën e Stambollit; dhe
- buxhetin e përgjithshëm të parashikuar, duke përfshirë kostot shtesë.

Bazuar në përvojën e mëparshme dhe në kostot e parashikuara për periudhën e ardhshme, organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë" ka përllogaritur buxhetin e saj të përgjithshëm për vitin 2025. Ky buxhet pasqyron strukturën aktuale të shpenzimeve dhe modelin operacional të Qendrës, bazuar në ecurinë e vërejtur gjatë viteve të fundit.

**Tabela 25**. Parashikimi bazë i shpenzimeve për Qendrën "Të Ndryshëm & Të Barabartë" (2026–2028), në lekë

| Zëri buxhetor (numri dhe emërtimi) | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore | 17,192,484 | 18,052,108 | 18,954,714 |
| Shpenzime operative | 25,669,955 | 26,088,539 | 26,088,539 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Parandalim dhe ndërgjegjësim | 1,191,000 | 1,191,000 | 1,191,000 |
| Pajisje teknike | 372,314 | 372,314 | 372,314 |
| **Kostot gjithsej** | **44,425,753** | **45,703,961** | **46,606,567** |

*Burimi: "Të Ndryshëm & Të Barabartë", 2025, dhe RA-ja për periudhën 2026–2028.*

Përllogaritja e kostove shtesë për periudhën 2026–2028

Këto përllogaritje mbështeten në intervistat e zhvilluara me përfaqësuesit e Qendrës. Ato duhet të interpretohen si kosto shtesë që plotësojnë buxhetin ekzistues të Qendrës.

- Personeli – Dy menaxherë/e të rasteve dhe një psikolog/e
- Strehëza mbulon tashmë nevojat bazë mjekësore. Megjithatë, stafi theksoi se shumë të mbijetuara kanë nevojë për vlerësim psikiatrik dhe trajtim të specializuar të shëndetit mendor, përfshirë trajtimin e depresionit, çrregullimit të stresit post-traumatik (ÇSPT), përdorimit të substancave dhe rrezikut të vetëvrasjes.
- Këto shërbime nuk mund të sigurohen në mënyrë të qëndrueshme nëpërmjet institucioneve shëndetësore shtetërore. Ndonëse kujdesi për shëndetin mendor ofrohet formalisht pa pagesë, shërbimeve publike u mungojnë profesionistët e trajnuar për ofrimin e kujdesit të informuar nga trauma dhe trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave. Për më tepër, koha e pritjes është e gjatë, çka e bën të pamundur ndërhyrjen në kohë në rastet akute.
- Gjithashtu, GREVIO ka vërejtur se shërbimet publike të shëndetit dhe të shëndetit mendor në Shqipëri nuk ofrojnë në mënyrë sistematike mbështetjen e specializuar psikologjike, të përqendruar te e mbijetuara, siç kërkohet nga Konventa e Stambollit. GREVIO ka evidentuar mangësi në protokolle, në trajnimin e profesionistëve dhe në aksesueshmërinë e shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore.[77] Si rrjedhojë, nevojat e të mbijetuarave për shërbime të shëndetit mendor nuk mund të plotësohen në mënyrë të përshtatshme nëpërmjet mekanizmave ekzistues publikë, duke e bërë të domosdoshme ofrimin e mbështetjes shtesë nga strehëza.
- Meqenëse trajtimi i specializuar i shëndetit mendor nuk buxhetohet në mënyrë sistematike, strehëza duhet të mbështetet në zgjidhje rast pas rasti ose në referime pranë ofruesve të jashtëm. Sipas nenit 23 të Konventës së Stambollit, strehëzat duhet të garantojnë akses në mbështetje të gjithanshme psikologjike. Kur këto shërbime nuk mund të ofrohen brenda strehëzës, ato duhet të kontraktohen nga ofrues të jashtëm.
- Për të adresuar këtë mangësi kritike, strehëza duhet të punësojë një psikolog/e të aftë për të ofruar kujdes të vazhdueshëm për shëndetin mendor, të specializuar për trajtimin e traumës, si dhe për të garantuar vijimësinë e trajtimit.
- Gjithashtu, kompleksiteti i rasteve dhe kërkesa në rritje për mbështetje të individualizuar nxjerrin në pah nevojën urgjente për dy menaxherë/e shtesë të rasteve. Menaxhimi i rasteve është thelbësor për koordinimin e reagimit emergjent, administrimin e referimeve dhe ofrimin e ndjekjes së mëtejshme të rasteve.
- Përllogaritja e kostove bazohet në nivelet referuese të sektorit publik për pozicione të krahasueshme të punës sociale në Shqipëri. Për shembull, paga mesatare për një menaxher/e rasti ose psikolog/e është 95,033 lekë në muaj, ndërsa kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë rreth 15,870 lekë në muaj. Kështu, kostoja e përgjithshme mujore arrin në 110,903 lekë për çdo menaxher/e rasti. Kostoja shtesë vjetore për dy menaxherë/e rastesh do të jetë 2,661,672 lekë.

[77] GREVIO. *Baseline Evaluation Report: Albania*. Council of Europe, 2023. https://albania.un.org/en/doënload/174513/284898

**Mbështetja psikologjike dhe supervizimi i stafit**
Për të garantuar shërbime cilësore dhe të përqendruara te viktima, mbështetja psikologjike dhe supervizimi duhet të ofrohen në mënyrë sistematike për të gjithë punonjësit që trajtojnë drejtpërdrejt raste të dhunës.
Rritja e kapaciteteve të këshillimit, nëpërmjet punësimit të një psikologu/eje shtesë, është e nevojshme për përballimin e numrit në rritje të rasteve. Kostoja vjetore përllogaritet në 1,330,836 lekë, bazuar në një kosto mujore prej 110,903 lekësh për 12 muaj.

Për supervizimin, përllogaritja e kostove bazohet në numrin dhe kategoritë e punonjësve të përfshirë. Për 13 punonjës, me një kosto për njësi prej 2,500 lekësh në muaj[78], kostoja e përgjithshme arrin në 390,000 lekë në vit. Përllogaritja synon të garantojë përfshirjen në supervizim të të gjitha kategorive kryesore të stafit, duke marrë parasysh si shpeshtësinë e angazhimit të tyre në trajtimin e rasteve, ashtu edhe intensitetin e mbështetjes psikologjike të nevojshme, kostoja e përgjithshme arrin në 390,000 lekë në vit. Përllogaritja synon të garantojë përfshirjen në supervizim të të gjitha kategorive kryesore të stafit, duke marrë parasysh si shpeshtësinë e angazhimit të tyre në trajtimin e rasteve, ashtu edhe intensitetin e mbështetjes psikologjike të nevojshme.

**Shërbimet e interpretimit dhe përkthimit**
Ofrimi i shërbimeve të interpretimit dhe përkthimit është i nevojshëm për të garantuar aksesueshmërinë për gratë e huaja që kërkojnë mbështetje pranë Qendrës. Duke pasur parasysh rritjen e numrit të përfitueseve të huaja, interpretimi është i domosdoshëm për të garantuar komunikim efektiv, kuptimin e saktë të rasteve të ndjeshme dhe akses të barabartë në shërbimet psikosociale dhe mjekësore.

Përllogaritja e kostos së shërbimeve të interpretimit dhe përkthimit bazohet në një tarifë orare të barabartë me 50% të shumës prej 5,040 lekësh, e cila pasqyron tarifat zyrtare të përcaktuara në Udhëzimin **"Për përcaktimin e tarifave për ofrimin e shërbimeve të përkthimit zyrtar..."**.[79] Parashikohet që mbështetja me interpretim të nevojitet për rreth pesë orë në muaj, për të garantuar aksesueshmërinë për përfitueset e huaja që i drejtohen Qendrës, bazuar në përvojën e saj të mëparshme. Për një periudhë 12-mujore, kostoja e përgjithshme do të jetë 151,200 lekë në vit (5,040 lekë ÷ 2 × 5 orë × 12 muaj).
Ky financim i mundëson Qendrës të ofrojë shërbime gjithëpërfshirëse dhe të barabarta, në përputhje me standardet kombëtare dhe detyrimet për garantimin e aksesueshmërisë.

**Kujdesi për fëmijët dhe mbështetja arsimore**
Buxhetimi për fëmijët e përfitueseve është i domosdoshëm, pasi gratë që kërkojnë strehim shpesh mbërrijnë të shoqëruara nga fëmijët e tyre. Në raste të tilla, Qendra është përgjegjëse për të garantuar përmbushjen e përshtatshme të nevojave të fëmijëve.
Për këtë arsye, është përllogaritur një buxhet i posaçëm prej 420,000 lekësh në vit për të paktën dy fëmijë që qëndrojnë në Qendër. Ky buxhet përfshin:

- ushqimin: 360,000 lekë në vit;
- mjetet bazë shkollore: 24,000 lekë në vit;
- aktivitetet argëtuese dhe çlodhëse: 36,000 lekë në vit.

[78] The rate is determined in line with the prevailing costing practices applied by comparable service providers.
[79] Instruction No. 8 "On the Determination of Tariffs for the Provision of Official Translation and Sign Language Interpretation Services and the Rules for Exemption from Payment of Tariffs for Categories of Persons Benefiting from Legal Aid", 2022.

Këto shpenzime janë thelbësore për të garantuar ushqimin e përditshëm, për të lehtësuar aksesin në arsim dhe për të krijuar mundësi për socializim dhe mirëqenie emocionale. Duke trajtuar si nevojat e menjëhershme, ashtu edhe ato zhvillimore të fëmijëve, Qendra krijon një mjedis të sigurt dhe mbështetës, i cili u përgjigjet në mënyrë gjithëpërfshirëse realiteteve të përfitueseve që mbërrijnë së bashku me familjet e tyre.

**Kujdesi shëndetësor i specializuar (shërbime të jashtme)**

Të mbijetuarat kanë shpesh nevojë për shërbime që nuk mund të ofrohen brenda Qendrës, si vlerësimet psikiatrike dhe konsultat me mjekë specialistë. Mesatarisht, dy përfituese në muaj referohen për vizita mjekësore të jashtme dhe secila prej tyre ka nevojë për dy seanca. Kjo përllogaritet në rreth 48 seanca në vit.

Bazuar në tarifat zyrtare të aplikuara në spitalet universitare (3,000 lekë për vizitë), spitalet rajonale (2,000 lekë për vizitë) dhe spitalet bashkiake (1,500 lekë për vizitë), kostoja mesatare për një vizitë mjekësore përllogaritet në 2,167 lekë. Për rrjedhojë, kostoja e parashikuar vjetore arrin në 104,016 lekë (48 seanca × 2,167 lekë).

Nëse shteti nuk i heq tarifat për personat që kanë përjetuar dhunë, këto shpenzime janë thelbësore për të garantuar përmbushjen e standardeve të Konventës së Stambollit, të cilat kërkojnë që strehëzat t'u sigurojnë të mbijetuarave akses në kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës, duke përfshirë mbështetjen e specializuar mjekësore dhe psikologjike.

**Shërbimet noteriale dhe dokumentet ligjore**

Ndonëse ekziston tashmë një fond i vogël për dokumentacionin ligjor, Qendra ka evidentuar nevojën për një rritje të moderuar të tij, me qëllim mbulimin e rasteve shtesë. Mesatarisht, të paktën 5–6 të mbijetuara në vit kanë nevojë për disa dokumente ligjore, si karta identiteti, certifikata lindjeje ose dokumente të gjendjes civile.

Çdo e mbijetuar zakonisht ka nevojë për një paketë prej 3–4 dokumentesh, me kosto që variojnë nga 1,500 deri në 2,500 lekë për dokument, në varësi të llojit të dokumentit dhe shërbimit noterial.

Ndonëse në Shqipëri disa dokumente administrative ofrohen falas ose me tarifë të reduktuar për personat në kushte nevoje ekonomike, nuk ekziston një dispozitë e posaçme që garanton shërbime noteriale apo dokumentacion pa pagesë veçanërisht për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore. Në praktikë, të mbijetuarat përballen shpesh me pengesa administrative, procedura të paqarta për përcaktimin e përfitimit dhe zbatim të paqëndrueshëm të përjashtimit nga tarifat nga ana e autoriteteve vendore.

Për këtë arsye, strehëzat shpesh duhet t'i mbulojnë drejtpërdrejt këto shpenzime, për të garantuar pajisjen në kohë me dokumentacionin thelbësor. Duke përdorur një kosto mesatare prej 2,000 lekësh për dokument, kostoja shtesë vjetore përllogaritet në 36,000 lekë (6 të mbijetuara × 3 dokumente × 2,000 lekë).

Ky financim është i nevojshëm për të plotësuar buxhetin minimal ekzistues për këto shpenzime dhe për të garantuar që të mbijetuarat të pajisen në kohë me dokumentet ligjore thelbësore, të cilat janë të domosdoshme për ushtrimin e të drejtave, aksesin në shërbime dhe lehtësimin e riintegrimit.

**Mbështetja për pagesën e qirasë pas largimit nga strehëza**

Ndonëse strehëza ka alokuar disa fonde për subvencionimin e qirasë, është evidentuar nevoja për një rritje të moderuar të financimit, me qëllim mbulimin e rasteve shtesë përtej shpenzimeve të buxhetuara aktualisht, veçanërisht të rasteve që nuk mbështeten në mënyrë të mjaftueshme nga fondi ekzistues i bashkisë.

Kuadri i vetëm ligjor i zbatueshëm është Vendimi i Këshillit Bashkiak të Tiranës **"Për miratimin e procedurave për 'Subvencionimin e qirasë"**.[80] Sipas këtij Vendimi, mbështetja mund të mbulojë deri në 100% të qirasë së banesës sociale për familjet që përfitojnë ose plotësojnë kushtet për të përfituar ndihmë ekonomike, si dhe deri në 100% të qirasë mesatare të tregut në njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore për familjet që marrin banesë me qira në tregun e lirë.

Duke marrë parasysh ndryshimet në nivelin e qirave dhe mungesën e qartësisë lidhur me zbatimin praktik të subvencionit, nga intervistat me punonjësit e Bashkisë Tiranë rezultoi se për këtë mbështetje merren në konsideratë tri nivele të ndryshme të bonusit të qirasë:

- 33,619 lekë për Zonën A;
- 25,062 lekë për Zonën B;
- 19,800 lekë për Zonën C.

Për të garantuar një qasje të kujdesshme, është përdorur si supozim konservativ një vlerë mesatare prej 26,160 lekësh në muaj për çdo përfituese, me qëllim që të mbijetuarat të mos kthehen në mjedise të pasigurta ose të përballen me mungesën e strehimit pas largimit nga strehëza.

Për katër përfituese nevojitet një fond mujor prej 26,160 lekësh për person, për të lehtësuar kalimin e tyre drejt jetesës së pavarur për një periudhë tremujore. Kjo përbën 104,640 lekë në muaj dhe një shumë të përgjithshme prej 313,920 lekësh në vit.

### Përshtatja për aksesin e personave me aftësi të kufizuara (shpenzim kapital i njëhershëm)

Për të garantuar që Qendra përmbush standardet e miratuara të shërbimit dhe siguron akses të barabartë për të gjitha përfitueset, në buxhet janë përfshirë punime për përshtatjen e ambienteve për personat me aftësi të kufizuara. Këto punime janë thelbësore për të akomoduar të mbijetuarat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët me vështirësi në lëvizje, duke garantuar respektimin e parimeve të gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit.
Ndërhyrjet e parashikuara përfshijnë:

- ndërtimin e rampave, me një kosto të përllogaritur prej 50,000 lekësh, për të mundësuar hyrjen pa pengesa;
- vendosjen e sinjalistikës së aksesueshme në mjediset e brendshme dhe të jashtme, me një kosto të përllogaritur prej 20,000 lekësh, për të orientuar personat me vështirësi në lëvizje ose me dëmtime të shikimit;
- përshtatjen e dy tualeteve, me një kosto prej 100,000 lekësh, për të garantuar përdorimin e ambienteve sanitare nga personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet zgjerimit të dyerve, vendosjes së shufrave mbështetëse dhe instalimit të pajisjeve sanitare të aksesueshme.

[80] Decision of the Municipal Council of Tirana, No. 10 "On the approval of procedures for implementing the social housing program 'Rent Subsidy'", 2020.

Kostoja e përgjithshme e parashikuar për këto punime është 170,000 lekë. Ky përbën një investim të domosdoshëm për të garantuar që të mbijetuarat me aftësi të kufizuara të kenë akses në shërbimet e strehëzës në mënyrë të sigurt, dinjitoze dhe të pavarur.
Kostot shtesë të parashikuara për tre vitet e ardhshme paraqiten në mënyrë të detajuar në në tabelën më poshtë.

**Tabela 26. Kostot shtesë të parashikuara për organizatën "Të Ndryshëm & Të Barabartë" (2026–2028)**

| Shërbimi sipas Konventës së Stambollit | Zëri buxhetor (numri dhe emërtimi) | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|---|
| Punësimi i dy menaxherëve/eve të rasteve (ndjekja pas largimit nga strehëza) | Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore | 2,661,672 | 2,661,672 | 2,661,672 |
| Punësimi i një psikologu/eje | Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore | 1,330,836 | 1,330,836 | 1,330,836 |
| Supervizimi i stafit në grup | Shpenzime operative – Trajnime (llogaria nr. 602) | 390,000 | 390,000 | 390,000 |
| Shërbime interpretimi dhe përkthimi | Shpenzime operative – Shërbime përkthimi (llogaria nr. 602) | 151,200 | 151,200 | 151,200 |
| Kujdesi dhe mbështetja arsimore për fëmijët shoqërues | Shpenzime operative – Aktivitete arsimore (llogaria nr. 602) | 420,000 | 420,000 | 420,000 |
| Kujdes shëndetësor i specializuar (shërbime të jashtme) | Shpenzime operative – Shërbime mjekësore (llogaria nr. 602) | 104,016 | 104,016 | 104,016 |
| Fonde shtesë për shërbime noteriale dhe dokumente ligjore | Shpenzime operative – Shpenzime noteriale (llogaria nr. 602) | 36,000 | 36,000 | 36,000 |
| Mbështetje për pagesën e qirasë pas largimit nga strehëza | Shpenzime operative – Qira (llogaria nr. 602) | 313,920 | 313,920 | 313,920 |
| Përshtatje për përmirësimin e aksesueshmërisë (shpenzim kapital i njëhershëm) | Pajisje teknike (llogaria nr. 231) | 170,000 | – | – |
| **Gjithsej** | | **5,577,644** | **5,407,644** | **5,407,644** |

*Burimi: Përllogaritjet e RA-së.*

**Buxheti i përgjithshëm i parashikuar për periudhën 2026–2028, duke përfshirë kostot shtesë**

Kostot e përgjithshme të parashikuara për tre vitet e ardhshme, duke përfshirë kostot shtesë të nevojshme për forcimin dhe zgjerimin e ofrimit të shërbimeve gjatë periudhës 2026–2028, paraqiten në mënyrë të detajuar në në tabelën më poshtë.

**Tabela 27. Parashikimi i buxhetit për periudhën 2026–2028, duke përfshirë kostot shtesë, në lekë**

| Zëri buxhetor (numri dhe emërtimi) | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore | 21,184,992 | 22,044,616 | 22,947,222 |
| Shpenzime operative | 27,085,091 | 27,503,675 | 27,503,675 |
| Parandalim dhe ndërgjegjësim | 1,191,000 | 1,191,000 | 1,191,000 |
| Pajisje teknike | 542,314 | 372,314 | 372,314 |
| **Kostot gjithsej** | **50,003,397** | **51,111,605** | **52,014,211** |

*Burimi: Përllogaritjet e RA-së.*

**Sfidat dhe prioritetet**

Strehëza përballet me një sërë sfidash të ndërlidhura, të cilat ndikojnë si në cilësinë, ashtu edhe në qëndrueshmërinë e shërbimeve të saj. Kufizimet në burimet njerëzore janë ndër çështjet më urgjente. Ndonëse ekziston një ekip multidisiplinar, numri i punonjësve mbetet i pamjaftueshëm për t'iu përgjigjur kërkesës në rritje, veçanërisht për ndjekjen e rasteve, menaxhimin e rasteve në komunitet dhe kujdesin e specializuar psikologjik. Financimi i parregullt për supervizimin e stafit rrit më tej rrezikun e mbingarkesës profesionale dhe cenon vijimësinë e kujdesit.

Një sfidë e dytë lidhet me nevojat e të mbijetuarave të shoqëruara nga fëmijët. Ndonëse shumë nga përfitueset mbërrijnë me fëmijët e tyre, kostot për ushqimin, mjetet shkollore dhe aktivitetet argëtuese të fëmijëve nuk buxhetohen në mënyrë sistematike. Kjo krijon vazhdimisht detyrime të pafinancuara, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve. Cenueshmëria financiare përbën një kufizim strukturor për të gjithë sektorin e strehëzave të administruara nga organizatat jofitimprurëse dhe organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë" nuk bën përjashtim. Funksionimi i saj mbështetet pothuajse tërësisht në financimet e donatorëve të jashtëm, vetëm pak prej të cilëve ofrojnë kontribute të parashikueshme. Paqëndrueshmëria e cikleve të financimit nga donatorët, e ndërthurur me rritjen e çmimeve të ushqimeve, shërbimeve utilitare dhe furnizimeve bazë, ushtron trysni të konsiderueshme mbi buxhetin e strehëzës.

Kjo situatë pasqyron një mangësi sistemike në financim. Sipas neneve 22 dhe 23 të Konventës së Stambollit, shtetet duhet të garantojnë *financim publik të qëndrueshëm dhe afatgjatë* për shërbimet e specializuara. Megjithatë, në Shqipëri, as buxheti qendror dhe as buxhetet bashkiake nuk garantojnë vijimësinë e strehëzave të administruara nga organizatat jofitimprurëse. Mekanizmat e financimit rast pas rasti ose të kufizuar, si kontributet e parregullta të bashkive apo përfitimi i herëpashershëm nga Fondi Social, nuk përmbushin kërkesat e Konventës së Stambollit.

Kufizimet e shërbimeve shtrihen gjithashtu te mbështetja për shëndetin mendor dhe fizik. Strehëza nuk disponon shërbime të brendshme të specializuara psikiatrike ose psikologjike të përqendruara te trauma. Për këtë arsye, rastet referohen pranë ofruesve të jashtëm, kostot e të cilëve nuk mbulohen në mënyrë të qëndrueshme nga buxheti. Shërbimet publike të shëndetit mendor nuk ofrojnë në mënyrë të besueshme kujdes të informuar nga trauma për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, duke kufizuar mundësinë e përdorimit të tyre si alternativë.

Edhe kapacitetet strehuese mbeten një sfidë. Me 15 shtretër të shpërndarë në katër dhoma, strehëza është përballur me raste kur nuk ka mundur të akomodojë të mbijetuara, veçanërisht viktima të huaja të trafikimit. Organizimi me dhoma të përbashkëta ngre gjithashtu shqetësime lidhur me mundësinë e ndarjes së personave që kanë përjetuar forma të ndryshme dhune ose që kanë nevojë për masa shtesë sigurie dhe privatësie. Ky kufizim ndikon në përmbushjen e standardeve ndërkombëtare, të cilat theksojnë sigurinë, privatësinë dhe kushtet e strehimit të bazuara në një qasje të informuar nga trauma.

Në përgjigje të këtyre sfidave, strehëza ka përcaktuar disa prioritete të menjëhershme:

- *Forcimi i burimeve njerëzore*, nëpërmjet punësimit të menaxherëve/eve shtesë të rasteve dhe psikologëve/eve, si dhe garantimit të supervizimit të rregullt të stafit dhe trajnimeve mbi qasjen e informuar nga trauma.
- *Krijimi i një zëri të posaçëm buxhetor për nevojat e fëmijëve*, që të mbulojë ushqimin, mjetet shkollore dhe aktivitetet e përshtatshme për moshën.
- *Investimi në trajnime të specializuara dhe në zhvillimin e vazhdueshëm profesional*, përfshirë temat që lidhen me traumën, përdorimin e substancave, rreziqet digjitale dhe menaxhimin e rasteve komplekse.
- *Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare* nëpërmjet mbështetjes së parashikueshme dhe shumëvjeçare nga donatorët dhe, mbi të gjitha, integrimit gradual të financimit të strehëzës në buxhetet bashkiake dhe shtetërore, në përputhje me detyrimet e Konventës së Stambollit.
- *Zgjerimi i shërbimeve të riintegrimit pas largimit nga strehëza*, duke përfshirë strehimin kalimtar, subvencionimin e qirasë, dokumentacionin ligjor dhe shërbimet e interpretimit për të mbijetuarat migrante.

## Qendra kombëtare për trajtimin e viktimave të dhunës në familje në Kamëz

### Përgjegjësitë dhe kuadri ligjor

Qendra Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje (QKTVDHF) është përfshirë në studim sepse është e vetmja strehëz e specializuar emergjente shtetërore për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Shqipëri, me financim publik të vazhdueshëm dhe përgjegjësi referimi në nivel kombëtar. Për këtë arsye, ajo përbën shërbimin kryesor rezidencial shtetëror që ofron mbrojtje, ndërhyrje në krizë dhe mbështetje multidisiplinare për të mbijetuarat.

E vendosur në Kamëz, Qendra funksionon nën përgjegjësinë e ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale. Kuadri bazë është Ligji nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje", i cili shfuqizoi Ligjin nr. 9669/2006 dhe vendosi një sistem të integruar, me në qendër viktimën, për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin. Qendra rregullohet gjithashtu nga Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë". Mandati i saj kryesor është të ofrojë mbrojtje të menjëhershme, strehim, ndihmë psikosociale dhe mjekësore, këshillim ligjor dhe mbështetje

për riintegrim për viktimat e dhunës me bazë gjinore, përfshirë gratë, fëmijët dhe grupet e tjera të cenueshme.8182

Drejtoresha e Qendrës mban përgjegjësinë e përgjithshme për funksionimin e saj, e mbështetur nga drejtuesi përgjegjës në Shërbimin Social Shtetëror (SHSSH), menaxherët e rasteve, psikologët, punonjësit socialë dhe personeli administrativ e mbështetës.

Qendra ka 18 punonjës. Struktura përfshin drejtoreshën dhe një përgjegjës të SHSSH-së, të mbështetur nga një ekip bazë prej tetë specialistësh në fushat e punës sociale, psikologjisë, ndihmës ligjore, mbështetjes mjekësore dhe koordinimit të programeve. Funksionet operative kryhen nga katër kujdestarë, dy punonjës pastrimi, një kuzhinier dhe një shofer. Kjo strukturë siguron një bërthamë profesionale multidisiplinare prej dhjetë punonjësish dhe tetë punonjës operacionalë që mundësojnë funksionimin e përditshëm të institucionit.

Ndonëse modeli i personelit është në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 505, datë 13.7.2011, "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike", numri i profesionistëve mbetet i pamjaftueshëm kur Qendra funksionon me kapacitet të plotë ose pranë tij.83
Përgjegjësia për buxhetimin i takon drejtoreshës, me mbështetjen e specialistit të financës, i cili përgatit planin financiar vjetor. Plani paraqitet nëpërmjet drejtorisë mbikëqyrëse dhe miratohet më pas nga ministria përgjegjëse, si pjesë e integrimit të Qendrës në sistemin publik të kujdesit shoqëror.

**Kapacitetet për buxhetim të përgjigjshëm gjinor**
Punonjësit përgjegjës për buxhetimin në Qendër kanë njohuri të pjesshme për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor. Ata e njohin atë si detyrim ligjor të lidhur me Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe udhëzimet vjetore të ministrisë, por kuptimi teknik i dimensioneve analitike të tij mbetet i kufizuar. Stafi konfirmon se kërkesa formale zbatohet nëpërmjet hartimit fillestar të propozimeve buxhetore nga Qendra dhe konsolidimit të tyre në nivelin e SHSSH-së, brenda programit buxhetor të ministrisë për mbrojtjen sociale. Megjithatë, zbatimi është kryesisht procedural dhe kapacitetet për përkthimin e nevojave gjinore në zëra konkretë kostosh janë të pamjaftueshme.

Të dhënat për përfitueset mblidhen në një bazë të thjeshtë në Excel, ku regjistrohen gjinia, mosha dhe disa karakteristika social-demografike. Megjithatë, informacioni nuk ndahet në mënyrë të qëndrueshme sipas përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar ose origjinës rurale dhe urbane. Kjo kufizon analizën e nevojave të diferencuara të grupeve të cenueshme dhe parashikimin e saktë të kostove për këto grupe.

Megjithëse Qendra është institucion shtetëror, sistemi i saj i të dhënave nuk është ende plotësisht i integruar me Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror

81 Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
82 Ligji nr. 11/2026 "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje", miratuar më 28.1.2026 dhe shpallur me dekretin nr. 53, datë 10.2.2026. Shih veçanërisht nenet 1–4, 15–16 dhe 47–57. Neni 59 shfuqizon Ligjin nr. 9669/2006, ndërsa aktet nënligjore të tij mbeten në fuqi deri në zëvendësim. Teksti zyrtar: https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2026/02/Ligji-nr.11-2026-Per-parandalimin-dhe-mbrojtjen-nga-dhuna-ndaj-grave-dhe-dhuna-ne-familje.pdf
83 VKM nr. 505, datë 13.7.2011, "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike".

në Shqipëri (REVALB[84]). Sipas stafit, vazhdon të përdoret një bazë e vjetër dhe e pavarur, sepse REVALB-i është projektuar kryesisht për ndjekjen e rasteve nëpërmjet Mekanizmave të Koordinuar të Referimit në bashki dhe për monitorim administrativ, jo për administrimin e të dhënave të hollësishme rezidenciale që kërkohen nga strehëzat. Qendra nuk është pajisur me modulet teknike dhe trajnimet e nevojshme për sinkronizimin në kohë reale të informacionit dhe nuk është miratuar një procedurë standarde veprimi që ta detyrojë ose rregullojë këtë integrim. Për rrjedhojë, shkëmbimi i informacionit mbetet i pjesshëm dhe jo i njëtrajtshëm, duke kufizuar harmonizimin e të dhënave dhe lidhjen e profileve të përfitueseve me planifikimin buxhetor dhe rezultatet e shërbimeve.

Planifikimi buxhetor koordinohet kryesisht nga specialisti administrativ-financiar, ndërsa bashkëpunimi me stafin e programeve zhvillohet rast pas rasti. Takimet e përbashkëta formale për planifikimin buxhetor nuk janë institucionalizuar, çka zvogëlon mundësinë për të harmonizuar planifikimin financiar me nevojat e ofrimit të shërbimeve. Në ciklin buxhetor nuk angazhohet zyrtarisht një nëpunës/e për barazinë gjinore. Si rezultat, analiza gjinore shpesh mungon gjatë përllogaritjes së kostove të shërbimeve të specializuara.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit kryhet çdo katër muaj, por nuk ekzistojnë mekanizma të strukturuar për të vlerësuar ndikimin e shpenzimeve mbi treguesit e dhunës me bazë gjinore në PBA ose në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030. Kjo kufizon llogaridhënien dhe dobëson lidhjen ndërmjet burimeve të alokuara dhe rezultateve të shërbimeve.[85]

**Përfitueset dhe kërkesa për shërbime**

Si e vetmja strukturë e specializuar rezidenciale shtetërore për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, Qendra e Kamzës luan rol qendror në përgjigjen institucionale të Shqipërisë ndaj dhunës. Statusi i saj i veçantë, krahasuar me strukturat bashkiake të akomodimit dhe strehëzat e organizatave jofitimprurëse, e bën atë alternativën kryesore të financuar nga shteti për mbrojtje emergjente, mbështetje multidisiplinare dhe strehim të përkohshëm.

Qendra ka një kapacitet zyrtar prej 27 personash, të sistemuar në tetë dhoma, me përparësi për gratë e mbijetuara dhe fëmijët e tyre. Kur nënat mbërrijnë me fëmijë, numri i rasteve familjare të veçanta që mund të akomodohen zvogëlohet dhe Qendra shpesh arrin ose tejkalon kapacitetin e saj efektiv. Sipas stafit, kërkesa i tejkalon rregullisht vendet e disponueshme, veçanërisht gjatë periudhave me rritje të referimeve nga policia, Mekanizmat e Koordinuar të Referimit ose gjykatat.

Të dhënat për përfitueset ruhen në një sistem të brendshëm të bazuar në Excel. Informacioni ndahet rregullisht sipas gjinisë dhe moshës, ku gratë dhe fëmijët përbëjnë shumicën e rezidentëve, por nuk ndahet sistematikisht sipas përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar ose origjinës rurale dhe urbane. Kjo kufizon identifikimin e nevojave të ndryshme dhe përllogaritjen e burimeve për grupet më të cenueshme, si gratë rome dhe egjiptiane, gratë me aftësi të kufizuara dhe të mbijetuarat nga zonat e largëta. Mungesa e integrimit me REVALB-in kufizon më tej analizën në nivel sistemi dhe buxhetimin e koordinuar.

---

[84] REVALB is Albania's national electronic system for recording and managing data on beneficiaries of social care services, administered by the Ministry of Health and Social Protection. It is used to support case management, service coordination and planning across social services, including services addressing domestic and gender-based violence.

[85] Council of Ministers, DCM No. 400, "On the Approval of the National Strategy on Gender Equality 2021–2030." Official Gazette of Albania, 2021.

Ngarkesa e rasteve përfshin gra të mbijetuara, fëmijë shoqërues, të mitur që janë viktima të drejtpërdrejta dhe një numër më të vogël grash nga komunitetet rome dhe egjiptiane. Të mbijetuarat me aftësi të kufizuara dhe ato nga zonat rurale ose periurbane duket se janë të nënpërfaqësuara. Kjo nuk tregon domosdoshmërisht incidencë më të ulët, por lidhet me pengesa si stigma, transporti i pamjaftueshëm dhe informimi i kufizuar në komunitet.
Pavarësisht statusit publik, Qendra mbështetet në bashkëpunimin me aktorë të jashtëm për nevoja që tejkalojnë mandatin e saj bazë, përfshirë ndihmën juridike, trajtimin dentar, ekzaminimet e specializuara mjekësore dhe kujdesin psikiatrik. Këto përbëjnë "kosto të fshehura" që nuk mbulohen plotësisht nga pagat e stafit ose buxheti standard operacional dhe shpesh kërkojnë marrëveshje rast pas rasti me ofrues të jashtëm.

Strehëzat e specializuara të administruara nga organizatat jofitimprurëse plotësojnë sistemin shtetëror, por vetëm disa prej tyre marrin mbështetje të pjesshme dhe të parregullt nga shteti, zakonisht në formën e subvencioneve vjetore për pagat. Kjo ndihmë nuk mbulon kostot operative ose kostot e shërbimeve, duke lënë një pjesë të konsiderueshme të shërbimeve të specializuara të varura nga financimi i donatorëve.

**Përllogaritja e kostove dhe alokimet buxhetore 2022–2024**
Fondet për QKTVDHF-në alokohen nga buxheti i shtetit dhe miratohen çdo vit nga ministria përgjegjëse. Qendra e paraqet kërkesën e saj buxhetore nëpërmjet SHSSH-së, në zërin buxhetor nr. 1013142, dhe kërkesa konsolidohet në nivel ministrie. Alokimi i miratuar përfshihet në buxhetin vjetor të institucioneve të kujdesit shoqëror dhe mbulon pagat, sigurimet dhe shpenzimet operative, si ushqimi, shërbimet utilitare, pastrimi dhe siguria. SHSSH-ja zbaton zërat e miratuar buxhetorë, ndërsa drejtoresha e Qendrës dhe specialisti i financës mbikëqyrin shpenzimet dhe raportimin e përditshëm. Qeverisja vendore nuk përfshihet drejtpërdrejt në financim, por bashkitë bashkëpunojnë për referimet nëpërmjet Mekanizmave të Koordinuar të Referimit.

Buxheti nuk mbështetet në një përllogaritje sistematike të nevojave reale të shërbimit. Buxhetimi është historik, me përshtatje që pasqyrojnë ndryshimet në paga ose në kostot operative. Nuk zbatohet një metodologji e saktë dhe periodike e përllogaritjes. Në fund të çdo viti Qendra përllogarit në mënyrë të përafërt vlerën e shërbimeve ligjore, psikologjike, mjekësore dhe dentare, si dhe nevojat specifike të rasteve të trajtuara. Këto përllogaritje shërbejnë si pasqyra të brendshme financiare dhe jo si bazë zyrtare për alokimet shtetërore.
Financimi publik mbulon pagat, sigurimet dhe kostot kryesore operative, përfshirë ushqimin, higjienën, barnat, shërbimet utilitare, transportin dhe sigurinë. Megjithatë, ai nuk mbulon nevoja të specializuara si mbështetja afatgjatë për riintegrim, ndihma për pagesën e qirasë pas largimit nga Qendra ose trajnimi i vazhdueshëm profesional i stafit. Në praktikë, këto nevoja mbeten të paplotësuara ose adresohen nëpërmjet partneriteteve me institucione të tjera shtetërore, organizata jofitimprurëse ose projekte të financuara nga donatorët.

Gjatë viteve 2022–2024, buxheti i alokuar siguroi shërbimet bazë dhe funksionimin e pandërprerë 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Megjithatë, niveli i financimit ishte i pamjaftueshëm për t'iu përgjigjur plotësisht rasteve që kërkonin shërbime të specializuara mjekësore, psikologjike ose ligjore dhe nuk garantoi mbështetje të plotë për riintegrim. GREVIO ka vlerësuar se financimi publik i strehëzave dhe shërbimeve të specializuara në Shqipëri mbulon

relativisht në mënyrë të qëndrueshme kostot bazë, por mbetet i paplotë dhe shumë i varur nga donatorët[86].

Tabela 26 përmbledh shpenzimet e QKTVDHF-së për vitet 2022–2024. Gjatë intervistave, stafi i cilësoi alokimet si të pamjaftueshme, sepse ato mbulojnë vetëm funksionimin bazë dhe jo riintegrimin, shërbimet e specializuara shëndetësore ose trajnimin e stafit.

**Tabela 28. Shpenzimet e QKTVDHF-së për vitet 2022–2024 në lekë**

| Zëri buxhetor | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|
| **Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore** | 11,135,000 | 13,419,000 | 15,992,760 |
| **Shpenzime operative** | 10,917,000 | 12,015,000 | 11,363,823 |
| **Parandalim dhe ndërgjegjësim** | – | – | – |
| **Pajisje teknike** | – | – | 240,000 |
| **Gjithsej** | **22,052,000** | **25,434,000** | **27,596,583** |

*Burimi: Të dhënat për vitet 2022 dhe 2023 nga SHSSH-ja; të dhënat për vitin 2024 nga Qendra.*

Buxheti i QKTVDHF-së sigurohet nëpërmjet SHSSH-së, institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale. Shpenzimet e përgjithshme u rritën nga 22,052,000 lekë në vitin 2022 në 27,596,583 lekë në vitin 2024, ose me 25%. Faktori kryesor ishte rritja e pagave dhe kontributeve shoqërore nga 11,135,000 lekë në 15,992,760 lekë, ose me 43.6%. Shpenzimet operative u rritën nga 10,917,000 lekë në vitin 2022 në 12,015,000 lekë në vitin 2023, por ranë në 11,363,823 lekë në vitin 2024, rreth 5% më pak se një vit më parë. Pavarësisht rënies, ato mbeten komponenti i dytë më i madh i buxhetit. Në vitin 2024 u shfaq edhe zëri i pajisjeve teknike, me 240,000 lekë, ndërsa parandalimi dhe ndërgjegjësimi nuk patën alokim të posaçëm.

Struktura e buxhetit dominohet nga kostot e personelit, të cilat u rritën nga 50.5% e totalit në vitin 2022 në 58% në vitin 2024. Ndërkohë, pesha relative e shpenzimeve operative u zvogëlua. Kjo tregon se një pjesë në rritje e burimeve përthithet nga personeli, duke lënë më pak hapësirë për funksionimin, ndërgjegjësimin dhe masat parandaluese.

Të dhënat e detajuara për vitin 2024 mundësuan një analizë më të thelluar. Nga buxheti i përgjithshëm prej 27.6 milionë lekësh, shpenzimet operative përbënin 11.4 milionë lekë. Zëri më i madh ishte siguria dhe sistemet e sigurisë, me 6.3 milionë lekë, më shumë se gjysma e shpenzimeve operative. Zëra të tjerë të rëndësishëm ishin mirëmbajtja e godinës me 1.1 milionë lekë, energjia elektrike me 820,000 lekë, transporti dhe karburanti me 952,047 lekë dhe produktet e pastrimit me 560,000 lekë. Shpenzime të tjera përfshinin shërbimet financiare me 280,000 lekë, mirëmbajtjen e automjetit me 240,000 lekë, kancelaritë me 120,000 lekë dhe shpenzime të tjera me 750,000 lekë.

Në tërësi, struktura e kostove është e përqendruar te siguria dhe mirëmbajtja, duke treguar përparësinë që i jepet mbrojtjes dhe funksioneve bazë, por duke lënë burime të kufizuara për parandalimin, ndërgjegjësimin dhe ngritjen e kapaciteteve.

[86] GREVIO. *Baseline Evaluation Report: Albania*. Council of Europe, Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence, 2023. https://albania.un.org/en/download/174513/284898

**Parashikimi bazë i shpenzimeve për vitet 2026–2028**
Qendra përgatit rregullisht parashikime të shpenzimeve. Për këtë analizë, parashikimet për vitet pasuese janë përshtatur sipas metodologjisë së përshkruar në studim, duke përdorur si bazë buxhetin e vitit 2026 të paraqitur nga Qendra. Nënseksionet në vijim paraqesin parashikimin bazë për vitet 2026–2028, kostot shtesë për plotësimin e mangësive dhe përafrimin me Konventën e Stambollit dhe Ligjin nr. 11/2026, si dhe buxhetin e përgjithshëm që përfshin këto kosto.
Bazuar në shpenzimet e mëparshme, Qendra vlerëson se i nevojiten kostot e paraqitura në tabelën më poshtë për të vijuar funksionimin aktual.

**Tabela 29. Buxheti i parashikuar i QKTVDHF-së për vitet 2026–2028 në lekë**

| Zëri buxhetor | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore | 15,992,760 | 16,792,398 | 17,632,018 |
| Shpenzime operative | 11,363,823 | 11,932,014 | 12,528,615 |
| Parandalim dhe ndërgjegjësim | – | – | – |
| Pajisje teknike | 240,000 | 252,000 | 264,600 |
| **Gjithsej** | **27,596,583** | **28,976,412** | **30,425,233** |

*Burimi: QKTVDHF-ja dhe parashikimet e RA-së.*

**Kostot shtesë për vitet 2026–2028**
Përllogaritjet në vijim pasqyrojnë kostot shtesë të nevojshme për të adresuar mangësitë në shërbime dhe për të përmbushur standardet e Konventës së Stambollit dhe detyrimet e Ligjit nr. 11/2026. Ato mbështeten në gjetjet e intervistave me Qendrën.

**Mbështetja psikologjike dhe supervizimi i stafit**
Për të garantuar shërbime cilësore dhe me viktimën në qendër, mbështetja psikologjike dhe supervizimi duhet të shtrihen sistematikisht tek të gjithë punonjësit që trajtojnë drejtpërdrejt raste dhune. Përllogaritja mbulon tetë punonjës, me kosto për njësi prej 2,500 lekësh në muaj[87], ose 240,000 lekë në vit. Kjo siguron që supervizimi të përfshijë kategoritë kritike të stafit, duke marrë parasysh shpeshtësinë e angazhimit të tyre në raste dhe intensitetin e mbështetjes psikologjike të nevojshme.

**Kujdesi shëndetësor i specializuar nga ofrues të jashtëm**
Të mbijetuarat kanë shpesh nevojë për shërbime të specializuara që nuk mund të ofrohen brenda Qendrës, si vlerësimet psikiatrike dhe konsultat me mjekë specialistë. Mesatarisht parashikohen dy përfituese në muaj, me nga dy vizita secila, ose rreth 48 vizita në vit. Bazuar në tarifat zyrtare të spitaleve universitare, rajonale dhe bashkiake, kostoja mesatare e një vizite përllogaritet në 2,167 lekë. Kostoja vjetore arrin kështu në 104,016 lekë. Ligji nr. 11/2026 kërkon që viktimat të kenë akses falas në shërbime mjekësore, ekzaminime dhe mbështetje të specializuar; derisa këto shërbime të garantohen plotësisht nga sistemi publik, fondi i parashikuar mbetet i nevojshëm.

**Shërbimet noteriale dhe dokumentet ligjore**
Megjithëse Qendra ka një fond të kufizuar për dokumentacionin ligjor, nevojitet një shtesë për rastet e tjera. Mesatarisht, 5–6 të mbijetuara në vit kanë nevojë për disa dokumente, si karta identiteti, certifikata lindjeje ose deklarata noteriale. Çdo përfituese ka zakonisht nevojë

[87] The rate is determined in line with the prevailing costing practices applied by comparable service providers.

për 3–4 dokumente, me kosto nga 1,500 deri në 2,500 lekë për dokument. Me një kosto mesatare prej 2,000 lekësh, shtesa vjetore vlerësohet në 36,000 lekë për gjashtë përfituese dhe nga tre dokumente secila. Këto fonde mundësojnë pajisjen në kohë me dokumentet e domosdoshme për ushtrimin e të drejtave, aksesin në shërbime dhe riintegrimin.

**Mbështetja për qiranë pas largimit nga strehëza**
Qendra ka disa fonde për këtë qëllim, por nevojitet një rritje e moderuar për rastet që nuk mbulohen ose mbulohen në mënyrë të pamjaftueshme nga skema bashkiake[88]. Duke përdorur një vlerësim konservativ prej 26,160 lekësh në muaj për përfituese dhe duke parashikuar mbështetje tremujore për 12 përfituese, nevoja vjetore arrin në 941,760 lekë. Ky financim synon të parandalojë kthimin në mjedise të pasigurta ose rrezikun e pastrehësisë pas daljes nga Qendra.

**Informimi në komunitet dhe komunikimi**
Buxheti i propozuar është 20,000 lekë në muaj ose 240,000 lekë në vit. Prej tij, 8,000 lekë në muaj përdoren për fushata ndërgjegjësimi, përfshirë postera, broshura, mbulim mediatik dhe iniciativa informuese; 9,000 lekë në muaj për angazhim në komunitet, si takime me grupe vendore, shkolla dhe organizata; dhe 3,000 lekë në muaj për shtypje, identitet vizual dhe materiale komunikimi. Këto burime rrisin njohjen e shërbimeve dhe lehtësojnë aksesin e grupeve të nënpërfaqësuara.

**Kostot shtesë për tre vitet e ardhshme paraqiten në tabelën mw poshtw.**

**Tabela 30. Kostot shtesë të parashikuara për QKTVDHF-në 2026–2028 në lekë**

| Shërbimi | Zëri buxhetor | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|---|
| Supervizimi i stafit | Shpenzime operative – trajnime, llogaria 602 | 240,000 | 252,000 | 264,600 |
| Kujdes shëndetësor i specializuar | Shpenzime operative – shërbim mjekësor, llogaria 602 | 104,016 | 109,217 | 114,678 |
| Dokumente noteriale dhe ligjore | Shpenzime operative – shpenzime noteriale, llogaria 602 | 36,000 | 37,800 | 39,690 |
| Mbështetje për qiranë pas strehëzës | Shpenzime operative – qira, llogaria 602 | 941,760 | 988,848 | 1,038,290 |
| Informim dhe komunikim | Parandalim dhe ndërgjegjësim, llogaria 602 | 240,000 | 252,000 | 264,600 |
| **Gjithsej** | | **1,561,776** | **1,639,865** | **1,721,858** |

*Burimi: Përllogaritjet e RA-së.*

**Buxheti i përgjithshëm i parashikuar për vitet 2026–2028**
Buxheti i përgjithshëm përfshin kostot shtesë të nevojshme për forcimin dhe zgjerimin e shërbimeve, siç paraqitet në tabelën më poshtë.

[88] Decision of the Municipal Council of Tirana, No. 10, "On the approval of procedures for implementing the social housing program 'Rent Subsidy'", 2020.

**Tabela 31. Parashikimi i buxhetit me kostot shtesë në lekë**

| Zëri buxhetor | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| **Paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore** | 15,992,760 | 16,792,398 | 17,632,018 |
| **Shpenzime operative** | 12,685,599 | 13,319,879 | 13,985,873 |
| **Parandalim dhe ndërgjegjësim** | 240,000 | 252,000 | 264,600 |
| **Pajisje teknike** | 240,000 | 252,000 | 264,600 |
| **Gjithsej** | **29,158,359** | **30,616,277** | **32,147,091** |

*Burimi: Përllogaritjet e RA-së.*

**Sfidat dhe prioritetet**

Qendra i kryen në mënyrë të qëndrueshme funksionet e saj bazë, por mbetet e nënfinancuar për disa elemente thelbësore të një përgjigjeje gjithëpërfshirëse dhe me viktimën në qendër. Mangësitë kryesore përfshijnë riintegrimin pas daljes nga strehëza, trajnimin dhe supervizimin e vazhdueshëm të stafit, shërbimet e specializuara shëndetësore dhe ligjore, informimin proaktiv në komunitet dhe investimet kapitale në automjete, sisteme sigurie dhe pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Këto boshllëqe pengojnë përmbushjen e plotë të Konventës së Stambollit dhe të Ligjit nr. 11/2026, të cilat kërkojnë shërbime të përshtatshme, të specializuara, falas, të aksesueshme dhe të koordinuara[89].

Presioni mbi kapacitetet i thellon këto sfida. Qendra funksionon shpesh me kapacitet të plotë ose pranë tij dhe, kur pranohen nëna me fëmijë, numri i rasteve familjare që mund të strehohen zvogëlohet ndjeshëm. Rastet që nuk mund të akomodohen referohen zakonisht te strehëzat e organizatave jofitimprurëse. Në nivel kombëtar, kapaciteti i vlerësuar prej rreth 80–90 vendesh familjare mbetet dukshëm nën standardin orientues të Konventës së Stambollit prej një vendi familjar për çdo 10,000 banorë. Me një popullsi rreth 2.4 milionë banorë[90], nevoja orientuese është rreth 240 vende familjare, pra një mungesë prej rreth 150–170 vendesh[91].

Qëndrueshmëria financiare përbën një shqetësim tjetër. Qendra përfiton financim të qëndrueshëm për kostot bazë, por buxheti nuk mbulon mjaftueshëm shërbimet e specializuara ose nevojat individuale të të mbijetuarave. Strehëzat e organizatave jofitimprurëse që plotësojnë sistemin përballen me kufizime edhe më të mëdha. Vetëm disa marrin mbështetje të pjesshme shtetërore dhe kjo zakonisht kufizohet te pagat, pa mbuluar kostot operative dhe të shërbimeve. Ligji nr. 11/2026 forcon bazën ligjore për shërbime të përgjithshme dhe të specializuara, por zbatimi kërkon financim publik të parashikueshëm, afatgjatë dhe të lidhur me standardet e shërbimit.

Kufizimet e të dhënave pengojnë planifikimin e bazuar në prova. Informacioni sipas gjinisë dhe moshës është i disponueshëm, por aftësia e kufizuar, përkatësia etnike dhe origjina rurale ose urbane nuk regjistrohen në mënyrë sistematike. Kjo vështirëson identifikimin e pengesave që përballojnë gratë me aftësi të kufizuara, gratë rome dhe egjiptiane dhe të mbijetuarat nga zonat e largëta. Zgjerimi i fushave të të dhënave, shënjimi i llojeve të kostove dhe përdorimi

[89] Council of Europe. *Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence (Istanbul Convention)*. Strasbourg: Council of Europe Treaty Series No. 210, 2011. https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention

[90] INSTAT. *Population of Albania, 1 January 2024*. Tirana: Institute of Statistics. https://www.instat.gov.al.

[91] Council of Europe, *Istanbul Convention Explanatory Report*, para. 142, specifying one family place per 10,000 inhabitants as the recommended standard for shelter provision.

i treguesve të rezultateve do të forconin propozimet buxhetore dhe raportimin sipas kërkesave të ligjit të ri dhe rekomandimeve të GREVIO-s[92].

Prioritetet e menjëhershme janë:

- supervizimi i stafit dhe trajnimi i vazhdueshëm;
- shërbimet e specializuara shëndetësore dhe psikiatrike;
- dokumentacioni ligjor dhe noterial;
- aktivitetet e dedikuara për informim dhe ndërgjegjësim;
- një rezervë kapitale qarkulluese për sigurinë dhe nevojat e TIK-ut; dhe
- një paketë e strukturuar riintegrimi, përfshirë mbështetjen afatshkurtër për qiranë dhe lidhjen me skemat bashkiake.

Në periudhën afatmesme, përdorimi i të dhënave për planifikim dhe buxhetim mbetet i kufizuar, veçanërisht për normën e shfrytëzimit, rastet që nuk pranohen për mungesë kapaciteti dhe rezultatet e shërbimeve. Financimi aktual nuk pasqyron plotësisht shtrirjen dhe koston e shërbimeve. Kjo ndikon në aksesin e barabartë të grupeve të nënpërfaqësuara, mirëqenien dhe supervizimin e stafit, vazhdimësinë e funksionimit dhe ritmin e zgjerimit të kapaciteteve kombëtare.

## Kostot e ofrimit të shërbimeve të specializuara sipas kërkesave të Konventës së Stambollit 2026–2028

### Gjetjet ndërsektoriale

Analiza e gjashtë ofruesve përfaqësues të shërbimeve të specializuara evidenton kufizime sistemike që cenojnë qëndrueshmërinë, aksesueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve për dhunën me bazë gjinore në Shqipëri.

**Mungesa e financimit publik të parashikueshëm dhe të dedikuar.** Nuk ekzistojnë zëra të posaçëm dhe të qëndrueshëm në buxhetin e shtetit për shërbimet e specializuara. Shërbimet e ofruara nga organizatat e grave mbështeten kryesisht në financimin e donatorëve, ciklet afatshkurtra të projekteve dhe mbështetjen e fragmentuar bashkiake. Për rrjedhojë, financimi nuk pasqyron kërkesën reale dhe shërbimet përshtaten me burimet e disponueshme, jo me nevojat.

**Varësia e lartë nga donatorët dhe financimi me projekte.** Modeli afatshkurtër krijon pasiguri, cenon vazhdimësinë, kufizon planifikimin afatgjatë dhe pengon investimet në infrastrukturë, personel dhe cilësi. Ai ndikon edhe në mbajtjen, trajnimin dhe supervizimin e stafit.

**Integrimi i kufizuar në Programin Buxhetor Afatmesëm.** Shërbimet e specializuara, veçanërisht ato të ofruara nga organizatat jofitimprurëse, nuk janë integruar sistematikisht në PBA-në 2025–2028. Kjo kufizon planifikimin, zgjerimin dhe qëndrueshmërinë në periudhën afatmesme.

[92] GREVIO. *Baseline Evaluation Report: Albania*. Council of Europe, Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence, 2023. https://albania.un.org/en/download/174513/284898

**Mangësitë kronike të kapaciteteve dhe personelit.** Në të gjitha tipologjitë mungon personeli i mjaftueshëm multidisiplinar dhe ofrimi i plotë 24/7. Këto kufizime ndikojnë në cilësinë, aksesin dhe vijimësinë e kujdesit.

**Nënfinancimi i komponentëve kritikë.** Riintegrimi, shërbimet për fëmijët, supervizimi i stafit, informimi në komunitet, siguria dhe ndërhyrjet e specializuara financohen pamjaftueshëm ose rast pas rasti.

**Sisteme të dobëta të të dhënave dhe përdorim i kufizuar i përllogaritjes së kostove.** Sistemet e fragmentuara, mungesa e metodologjive standarde dhe ndarja e pamjaftueshme e të dhënave kufizojnë vlerësimin e kërkesës, monitorimin dhe alokimin efektiv.

**Mungesa e një kuadri të unifikuar për kostot dhe financimin.** Ofruesit veprojnë sipas modeleve të ndryshme, përfshirë buxhetin e shtetit, projektet e donatorëve dhe buxhetet e integruara institucionale, duke prodhuar struktura të pakrahasueshme kostosh.

**Kapacitet i pamjaftueshëm i strehëzave.** Kapaciteti aktual mbetet dukshëm nën standardin orientues prej një vendi familjar për çdo 10,000 banorë, duke krijuar boshllëqe të mëdha në disponueshmëri dhe mbulim gjeografik.

## Kostot e parashikuara

Gjetjet tregojnë se niveli aktual i shpenzimeve nuk mjafton për të përmbushur kërkesat e Konventës së Stambollit dhe të Ligjit nr. 11/2026. Përafrimi kërkon rritje të konsiderueshme dhe të qëndrueshme të financimit publik.
Analiza për gjashtë ofruesit jep vlerësime orientuese të burimeve financiare për shërbimet e dhunës me bazë gjinore gjatë viteve 2026–2028. Përllogaritjet ndërthurin shpenzimet bazë të parashikuara me kostot shtesë për plotësimin e mangësive dhe përmbushjen e standardeve. Në të gjitha tipologjitë, faktorët kryesorë të kostos janë personeli multidisiplinar 24/7, financimi i plotë operacional, programet e riintegrimit, kapacitetet mjekësore dhe mjekoligjore, aksesueshmëria, transporti, informimi, siguria, trajnimi, supervizimi dhe sistemet e të dhënave.
Parashikimet për Qendrën Lilium janë të pjesshme, sepse kostot operative janë të integruara në buxhetin e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe nuk mund të ndahen. Tabela më poshtë përmbledh buxhetet e gjashtë ofruesve.

**Tabela 32. Buxheti i përgjithshëm i parashikuar për ofruesit e studiuar në milionë lekë**

| Qendra | 2026 | 2027 | 2028 | Kostot shtesë të kërkuara |
|---|---|---|---|---|
| **Linja Kombëtare e Këshillimit për Gra dhe Vajza** | 44.8 | 46.0 | 48.0 | Personel shtesë; aksesueshmëri; mbështetje psikologjike; paketa emergjente; mirëmbajtje sistemi |
| **Qendra Lilium** | 6.39 | 2.02 | 1.91 | Zgjerim ambientesh; aksesueshmëri; menaxher/e rasti; trajnim; supervizim; interpretim dhe përkthim |
| **Gruaja te Gruaja** | 14.5 | 14.7 | 15.5 | Personel multidisiplinar; supervizim; kujdes shëndetësor; qira pas strehëzës; informim; siguri |
| **Qendra Vatra** | 74.5 | 75.2 | 76.5 | Menaxherë rastesh; supervizim; interpretim; dokumente ligjore; qira; aksesueshmëri |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Të Ndryshëm & Të Barabartë** | 50.0 | 51.1 | 52.0 | Menaxherë rastesh; psikolog/e; fëmijë; kujdes mjekësor; dokumente; qira; aksesueshmëri |
| **QKTVDHF** | 29.2 | 30.6 | 32.1 | Supervizim; kujdes shëndetësor; dokumente ligjore; qira pas strehëzës; informim |

## Interpretimi dhe kufizimet

Edhe me përllogaritjen e detajuar për gjashtë institucione, gjetjet nuk mund të përgjithësohen plotësisht për të prodhuar një vlerësim kombëtar gjithëpërfshirës për linjat telefonike, qendrat e krizës për rastet e përdhunimit, strehëzat afatshkurtra dhe strehëzat afatgjata. Analiza jep qasje dhe shembuj orientues, por pengesat strukturore nuk lejojnë ekstrapolim të besueshëm.

**Mbulim kombëtar i paplotë.**
Në vend funksionon vetëm një qendër krize për rastet e përdhunimit, Qendra Lilium. Studimi nuk përfshiu 13 strehëzat emergjente bashkiake. Intervistat me Bashkinë Tiranë dhe analiza e transaksioneve të thesarit për vitet 2021–2023 treguan se bashkitë nuk mbajnë të dhëna të veçuara për shpenzimet e strehëzave emergjente dhe nuk kanë zëra të posaçëm për akomodimin emergjent ose shërbimet e dhunës me bazë gjinore. Shpenzimet përthithen nga buxhetet më të gjera të shërbimeve sociale, duke e bërë të pamundur nxjerrjen e kostove specifike dhe përfshirjen e tyre në metodologji.

**Struktura jo të standardizuara të kostove.**
Strehëzat funksionojnë sipas sistemeve thelbësisht të ndryshme të buxhetimit. Organizatat jofitimprurëse mbështeten pothuajse tërësisht në projekte të donatorëve; institucionet shtetërore përdorin zëra thesari të miratuar çdo vit sipas rregullave të financave publike; ndërsa kostot e Qendrës Lilium janë të integruara në strukturën financiare të QSUT-së. Për shkak të këtyre dallimeve, nuk ekziston një strukturë e unifikuar dhe nuk mund të përllogariten mesatare të besueshme sipas tipologjisë.

**Kontribute në natyrë të pavlerësuara.**
Bashkitë shpesh vendosin në dispozicion godina dhe mbulojnë disa shpenzime mirëmbajtjeje ose utilitare, por këto kontribute nuk monetizohen në buxhete. Mospërfshirja e tyre nënvlerëson nevojat reale për burime.

**Buxhetim historik dhe jo i bazuar në nevoja.**
Buxhetet shtetërore, veçanërisht për QKTVDHF-në dhe Qendrën Lilium, ndërtohen kryesisht mbi shpenzimet historike dhe jo mbi përllogaritjen sistematike të shërbimeve që kërkojnë Konventa e Stambollit, Ligji nr. 11/2026 dhe nevojat e parashikuara të përfitueseve.

## Përputhshmëria me studime të tjera

Buxhetet e parashikuara për vitet 2026–2028 janë përgjithësisht në përputhje me intervalet e kostove të identifikuara në raportin e Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) për ofrues të krahasueshëm[93]. Të dyja analizat tregojnë se personeli, vazhdimësia e shërbimit 24/7 dhe shpenzimet bazë operative janë faktorët kryesorë. Për strehëzën afatshkurtër "Gruaja te Gruaja", raporti i AWEN-it paraqet kosto vjetore prej 14–14.7 milionë lekësh, ndërsa ky studim parashikon rreth 14.7–15.5 milionë lekë për vitet 2027–2028. Përputhshmëria

[93] Costing of Specialist Services for Survivors of Gender-Based Violence in Albania. Tirana: AWEN, 2024.

sugjeron se metodologjitë pasqyrojnë realitete dhe presione të ngjashme, përfshirë inflacionin, mbajtjen e stafit të specializuar dhe rritjen e intensitetit të shërbimeve.

## REKOMANDIME

Rekomandimet u drejtohen ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, SHSSH-së, bashkive dhe ofruesve jofitimprurës. Ato synojnë të jenë të zbatueshme, me kosto të arsyeshme dhe në përputhje me Ligjin nr. 11/2026, Konventën e Stambollit dhe strategjitë kombëtare.

**Burimet njerëzore dhe mirëqenia e stafit**

Kuadri ligjor përcakton standardet minimale të personelit për qendrat rezidenciale të specializuara, përfshirë ekipet multidisiplinare dhe mbështetjen 24/7. Megjithatë, mbeten mangësi në kufijtë e ngarkesës së rasteve, supervizimin dhe trajnimin sistematik të informuar nga trauma. Mungesa e supervizimit klinik të strukturuar ndikon në mirëqenien, mbajtjen e stafit dhe cilësinë e shërbimeve. Ministria, SHSSH-ja dhe ofruesit duhet të:

- punësojnë menaxherë/e shtesë të rasteve, psikologë/e dhe specialistë të tjerë për të ulur ngarkesën dhe forcuar ndjekjen e rasteve;
- institucionalizojnë supervizimin klinik dhe mbështetjen psikologjike të rregullt për stafin;
- ofrojnë programe të vazhdueshme dhe të akredituara për traumën, mbrojtjen e fëmijëve, përdorimin e substancave dhe rreziqet digjitale, me zë buxhetor të përvitshëm.

**Zgjerimi i kapaciteteve dhe përmbushja e standardeve**

Kapaciteti aktual i strehëzave është dukshëm nën standardin orientues prej një vendi familjar për çdo 10,000 banorë. Me një popullsi rreth 2.4 milionë banorë, nevojiten afërsisht 240 vende familjare. Kapaciteti i vlerësuar prej 80–90 vendesh lë një mungesë kombëtare prej rreth 150–170 vendesh. Tabela më poshtë paraqet një vlerësim rajonal orientues; shifrat duhet të harmonizohen me të dhënat më të fundit të INSTAT-it dhe me një inventar të verifikuar të vendeve familjare, jo vetëm të shtretërve[94].

**Tabela 33. Nevojat rajonale për kapacitet strehimi sipas standardit orientues**

| Bashkia ose rajoni | Popullsia 2024 | Vende të nevojshme | Vende ekzistuese të vlerësuara | Vende shtesë |
|---|---|---|---|---|
| **Qarku Tiranë** | 925,198 | 90 | rreth 20 | 70 |
| **Durrës** | 289,987 | 26 | rreth 10 | 16 |
| **Fier** | 270,655 | 26 | rreth 5 | 21 |
| **Elbasan** | 254,084 | 27 | rreth 10 | 17 |
| **Shkodër** | 187,801 | 19 | rreth 10 | 9 |
| **Korçë** | 193,325 | 20 | rreth 10 | 10 |
| **Vlorë** | 182,278 | 18 | rreth 5 | 13 |
| **Rajonet e tjera së bashku** | rreth 140,000 | 14 | rreth 5 | 9 |

*Burimi: Përllogaritje orientuese e studimit. Shënim: shifrat rajonale kërkojnë validim me të dhënat më të fundit të INSTAT-it dhe inventarin kombëtar të vendeve familjare.*

[94] Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023 i INSTAT-it regjistroi rreth 2.4 milionë banorë. Përpara përdorimit të Tabelës 37 për vendimmarrje buxhetore, shifrat rajonale dhe inventari i vendeve familjare duhet të përditësohen e verifikohen me burimet zyrtare më të fundit.

Zonat me përparësi për zgjerim janë Tirana, Durrësi, Fieri, Elbasani, Vlora dhe Korça, ku popullsia dhe të dhënat e referimeve tregojnë nevojën më të lartë të paplotësuar. Ministria dhe bashkitë duhet të:

- zgjerojnë gradualisht kapacitetet në rajonet prioritare, nëpërmjet ngritjes së strukturave të reja bashkiake ose rajonale dhe kontraktimit shumëvjeçar të ofruesve të kualifikuar jofitimprurës;
- financojnë investimet kapitale për rikonstruksionin e ambienteve, automjetet, sistemet e TIK-ut dhe infrastrukturën fizike e digjitale të sigurisë;
- garantojnë aksesueshmërinë në çdo strukturë të re ose të zgjeruar, me ambiente të përshtatura, pajisje ndihmëse dhe subvencione transporti për gratë me aftësi të kufizuara, gratë rome dhe egjiptiane, të moshuarat dhe banoret e zonave rurale.

## Qëndrueshmëria financiare dhe buxhetimi

### Institucionalizimi i përllogaritjes së kostove në ciklin buxhetor

Përllogaritja e kostove duhet të bëhet pjesë sistematike e buxhetimit publik për shërbimet shtetërore dhe kërkesë kontraktuale për shërbimet e ofruara nga organizatat jofitimprurëse. Ministria, SHSSH-ja, Ministria e Financave dhe bashkitë duhet të:

- krijojnë zëra të posaçëm në buxhetet qendrore dhe vendore për strehëzat emergjente, qendrat rezidenciale afatgjata, shërbimet për dhunën seksuale dhe programet e riintegrimit;
- miratojnë dhe standardizojnë modelet e përllogaritjes të zhvilluara nga studimi për përdorim të detyrueshëm nga institucionet shtetërore dhe organizatat që marrin fonde publike;
- kërkojnë që bashkitë të përdorin të njëjtën metodologji kur kontraktojnë shërbime jofitimprurëse, për të siguruar qëndrueshmëri dhe krahasueshmëri;
- harmonizojnë përllogaritjen me kërkesat e Konventës së Stambollit dhe Ligjit nr. 11/2026, duke përfshirë kështillimin për traumën, mbështetjen mjekoligjore, përshtatjet për aftësinë e kufizuar, njësitë lëvizëse dhe rrugët afatgjata të riintegrimit;
- zbatojnë indeksim vjetor për inflacionin, për shembull një indeks të përkohshëm prej 5%, kur mungojnë deflatorët specifikë të PBA-së;
- shoqërojnë strategjitë kombëtare dhe vendore me kosto dhe alokime buxhetore të përcaktuara qartë.

### Kalimi në financim shtetëror programor dhe të parashikueshëm

Ofruesit bashkiakë dhe rajonalë nuk njihen si njësi shpenzuese dhe nuk mund të përgatisin buxhete të veçanta. Kostot e tyre përthithen nga buxhetet e përgjithshme të kujdesit shoqëror, duke kufizuar transparencën dhe vlerësimin e saktë. Në të njëjtën kohë, modeli i Fondit Social me bazë projektesh krijon financim afatshkurtër dhe favorizon bashkitë me kapacitet administrativ më të lartë. Qeveria duhet të:

- shndërrojë Fondin Social nga financim me projekte në financim programor, për të mundësuar shërbime të qëndrueshme shumëvjeçare;
- zëvendësojë grantet vjetore me kontrata shumëvjeçare shërbimi për ofruesit shtetërorë dhe jofitimprurës;

- lidhë financimin publik me përmbushjen e standardeve për raportin staf-përfituese, mbulimin 24/7, sigurinë dhe riintegrimin.

**Forcimi i REVALB-it si instrument për kostot dhe planifikimin**
REVALB-i mund të shërbejë si sistemi qendror i Shqipërisë për planifikimin e bazuar në prova. Ministria, SHSSH-ja, Ministria e Financave dhe bashkitë duhet të:

- adresojnë raportimin e paqëndrueshëm bashkiak, regjistrat e paplotë të organizatave dhe boshllëqet e të dhënave, duke forcuar lidhjen ndërmjet REVALB-it dhe QKTVDHF-së dhe duke miratuar procedura standarde për hedhjen dhe validimin e të dhënave;
- garantojnë trajnim të detyrueshëm dhe periodik për të gjithë punonjësit që hedhin të dhëna;
- krijojnë kapacitet të posaçëm mbikëqyrës në ministri për cilësinë dhe njëtrajtshmërinë e të dhënave;
- zgjerojnë ndërveprueshmërinë që REVALB-i të mbështesë parashikimin e kostove, buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe planifikimin kombëtar e vendor.

**Cilësia e shërbimeve dhe mbështetja e specializuar**
Ministria, SHSSH-ja, bashkitë dhe ofruesit jofitimprurës duhet të bashkëpunojnë për të:

- rritur financimin për shërbimet mjekësore, psikiatrike dhe ligjore të specializuara, duke garantuar akses dhe jo mbështetje rast pas rasti;
- alokuar fonde të synuara për informim, ndërgjegjësim dhe komunikim, veçanërisht për gratë rome dhe egjiptiane, gratë me aftësi të kufizuara, gratë rurale dhe viktimat e huaja të trafikimit;
- zbatuar buxhetim dhe planifikim ndërsektorial, me ambiente të përshtatura, interpretim, përkthim dhe programe gjithëpërfshirëse;
- alokuar fonde të posaçme për fëmijët shoqërues, përfshirë ambiente miqësore për fëmijët, ushqim, materiale arsimore, mbështetje psikosociale dhe aktivitete argëtuese.

**Të dhënat monitorimi dhe llogaridhënia**
Ministria, SHSSH-ja dhe bashkitë duhet të:

- përmirësojnë bazat e të dhënave me ndarje sipas aftësisë së kufizuar, përkatësisë etnike dhe origjinës rurale ose urbane dhe t'i integrojnë plotësisht në REVALB;
- vendosin monitorim të rregullt të shpenzimeve të buxhetuara kundrejt atyre faktike në nivel shtetëror dhe jofitimprurës;
- miratojnë tregues kyç të performancës për normën e shfrytëzimit, rastet e papranuara, suksesin e riintegrimit dhe qarkullimin e stafit, në përputhje me GREVIO-n dhe PBA-në;
- porosisin vlerësime të pavarura çdo tre vjet për rezultatet e shërbimeve, alokimet e ardhshme dhe llogaridhënien.

## PËRFUNDIME

Ky studim tregon se shërbimet e specializuara në Shqipëri për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) mbeten strukturalisht të nënfinancuara, të shpërndara në mënyrë të pabarabartë dhe shumë të varura nga donatorët e huaj. Megjithëse vendi ka bërë përparim të rëndësishëm në zhvillimin e një kuadri ligjor në përputhje me Konventën e Stambollit (KS), praktikat aktuale të financimit nuk garantojnë ende disponueshmërinë, aksesueshmërinë apo qëndrueshmërinë e shërbimeve të kërkuara sipas neneve 20–25 të saj. Mangësitë e evidentuara nga analiza e kostove përfshijnë kapacitetin e pamjaftueshëm të strehimit, varësinë nga financimi i bazuar në projekte, integrimin e kufizuar të shërbimeve të specializuara në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe mungesën e sistemeve të unifikuara të të dhënave. Këto problematika sistemike kërkojnë veprim të bashkërenduar nga shteti.

Gjetjet nga strehëzat e organizatave jofitimprurëse dhe nga Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje në Kamëz përforcojnë të njëjtën tablo: burimet e akorduara aktualisht nuk pasqyrojnë koston reale të ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të përqendruara tek e mbijetuara, duke përfshirë kujdesin psikologjik të informuar mbi traumën, ndihmën juridike, nevojat e fëmijëve dhe riintegrimin pas daljes nga strehëza. Të dhënat e përllogaritjes së kostove tregojnë gjithashtu se Shqipëria aktualisht siguron vetëm një pjesë të vendeve familjare që kërkohen sipas standardit orientues të KS-së prej një vendi familjar për çdo 10 000 banorë. Ky hendek kapacitetesh, i ndërthurur me financimin e fragmentuar, bën që të mbijetuarat të përballen me akses të pabarabartë, shërbime të mbingarkuara dhe mbështetje jo të njëtrajtshme në të gjithë vendin.

Për këtë arsye, kalimi drejt një qasjeje financimi më të qëndrueshme dhe të udhëhequr nga shteti është thelbësor. Kjo kërkon institucionalizimin e metodologjive transparente të përllogaritjes së kostove, krijimin e zërave buxhetorë shumëvjeçarë dhe të parashikueshëm, si dhe forcimin e integrimit ndërmjet ofruesve të shërbimeve dhe sistemeve kombëtare, si REVALB. Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave, veçanërisht për aftësinë e kufizuar, përkatësinë etnike, origjinën rurale ose urbane dhe rezultatet e shërbimeve, do të jetë i domosdoshëm për ta përshtatur financimin me nevojat e diferencuara dhe për të përmbushur rekomandimet e GREVIO-s për një monitorim kombëtar koherent[95].

Një kuadër i modernizuar financimi duhet të njohë gjithashtu rolin thelbësor të strehëzave të administruara nga organizatat jofitimprurëse, të cilat aktualisht ofrojnë një pjesë të konsiderueshme të kujdesit të specializuar. Krijimi i mekanizmave të qartë të kontraktimit, marrëveshjeve shumëvjeçare të financimit dhe modeleve të bashkëfinancimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bashkive dhe ofruesve jofitimprurës do të jetë i domosdoshëm për të garantuar vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimeve. Po kështu, investimet kapitale në infrastrukturë, sistemet e sigurisë, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit dhe automjetet për shërbimet në terren nuk janë përmirësime fakultative, por kërkesa themelore për sigurimin e mbrojtjes dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë.

Në përfundim, të dhënat e paraqitura në këtë studim ofrojnë një udhërrëfyes për kalimin nga një sistem i fragmentuar dhe i varur nga donatorët drejt një arkitekture financimi të shërbimeve për DHBGJ-në, e cila udhëhiqet nga shteti, është koherente dhe mbështetet në të dhëna. Përmirësimi i praktikave të përllogaritjes së kostove, zgjerimi i kapaciteteve të strehëzave, forcimi i infrastrukturës së të dhënave dhe përfshirja e shërbimeve të specializuara për DHBGJ-në në PBA do ta ndihmojnë Shqipërinë të përmbushë standardet ndërkombëtare dhe, çka është më e rëndësishmja, të garantojë që çdo e mbijetuar, pavarësisht vendndodhjes

[95] Council of Europe. *Explanatory Report to the Istanbul Convention.* Paragraph 142. Strasbourg: Council of Europe, 2011.

gjeografike, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar apo statusit social-ekonomik, të ketë akses në kohë në mbështetje të sigurt, cilësore dhe të qëndrueshme.

## BIBLIOGRAFIA DHE BURIMET


1. Arqimandriti, Mirela. *Country Report: Albania – SDG Indicator 5.c.1.*
2. Arqimandriti, Mirela. *Monitoring of Financial Allocations and Actual Expenditures for Gender-responsive Budgeting Programmes*. 2026.
3. Arqimandriti, Mirela. *Gender-responsive Budgeting in Albania's EU Growth Plan*. 2026.
4. Avokati i Popullit. *Rekomandim për Qendrën LILIUM*. Dokumenti.
5. Banka Botërore. *Albania BOOST Platform: Data Catalog*.
6. Dika, Q., M. Duli, G. Burazeri, R. Çumashi, R. Hala, E. Agolli dhe G. Qirja. "Prevalence of Child Maltreatment in Albania." *Eastern Mediterranean Health Journal* 30, nr. 12 (2024): 821–828.
7. Farnsworth, Nicole, dhe Eleta Shala. *How Much Does Protection Cost? Costing Services Provided by the Albanian Women's Empowerment Network for Addressing Gender-based Violence in Albania*. Rrjeti i Grave të Kosovës, me kërkesë të AWEN, mars 2025.
8. Fondi Monetar Ndërkombëtar. "Fiscal Decentralization and the Budgetary System in Albania." *IMF eLibrary*. Burimi.
9. Gender Alliance for Development Center. *Raport mbi zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi në Shqipëri*. Tiranë: GADC, 2019.
10. Gender Alliance for Development Center and AWEN. *Raport monitorimi mbi zbatimin e ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"*. Tiranë: GADC dhe AWEN, 2021.
11. INSTAT. *Popullsia e Shqipërisë, 2023*. Tiranë: INSTAT, 2023.
12. INSTAT. *Raporti i cilësisë për burimet administrative të të dhënave*. Tiranë: INSTAT, 2022.
13. Këshilli i Evropës. *Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)*.
14. Këshilli i Evropës, GREVIO. *Raporti i vlerësimit bazë mbi masat legjislative dhe masat e tjera për zbatimin e dispozitave të Konventës së Stambollit – Shqipëria*. GREVIO/Inf(2017)13. Strasburg: Këshilli i Evropës, 2017.
15. Këshilli i Evropës, GREVIO. *Building Trust by Delivering Support, Protection and Justice: Albania — First Thematic Evaluation Report*. GREVIO(2024)6. Strasburg: Këshilli i Evropës, 17 shtator 2024. Raporti.
16. Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme. *Transformimi i botës sonë: Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm*. A/RES/70/1. Nju-Jork: Kombet e Bashkuara, 2015.
17. Kombet e Bashkuara. *Konventa për të Drejtat e Fëmijës: statusi i Shqipërisë*. Koleksioni i Traktateve të Kombeve të Bashkuara. Burimi.
18. Komisioni Evropian. *Raporti për shtetin e së drejtës: Kapitulli për Shqipërinë*. Bruksel: Komisioni Evropian, 2024.
19. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). *Vërejtjet përmbyllëse mbi raportin e katërt periodik të Shqipërisë*. CEDAW/C/ALB/CO/4. Kombet e Bashkuara, 2016.
20. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). *Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 35 për dhunën me bazë gjinore ndaj grave, që përditëson Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 19*. CEDAW/C/GC/35. Kombet e Bashkuara, 2017.
21. Komiteti për të Drejtat e Fëmijës. *Vërejtjet përmbyllëse mbi raportet periodike të bashkuara, nga i dyti tek i katërti, të Shqipërisë*. CRC/C/ALB/CO/2–4. Gjenevë: Kombet e Bashkuara, 2012.
22. Ministria e Financave. *Udhëzimet standarde dhe vjetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm*.

23. Ministria e Financave dhe Ekonomisë. *Tabela 4 – Treguesit fiskalë 2022–2027*. Tiranë, 2024. Tabela.
24. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. *Plani i veprimit për shëndetin seksual dhe riprodhues 2022–2030*. Tiranë, 2022.
25. UNDP. *Hartëzimi i shërbimeve sociale në Shqipëri*. Tiranë: UNDP, 2023.
26. UNICEF. *Analiza e situatës së fëmijëve dhe adoleshentëve në Shqipëri*. Tiranë: UNICEF, 2021.

**Legjislacioni dhe politikat kombëtare**

27. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 64/2025, datë 6.11.2025, "Për barazinë gjinore".
28. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 11/2026, datë 28.1.2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje".
29. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 92/2025, "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë".
30. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
31. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 22/2018, "Për strehimin social", i ndryshuar. Akti.
32. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 35/2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, 'Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar". Fletorja Zyrtare nr. 97/2017.
33. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 35/2020, "Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar". Akti.
34. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Akti.
35. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 65/2016, "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë". Akti.
36. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar.
37. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Versioni i konsoliduar deri më 17.5.2021.
38. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 104/2012, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës 'Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje'". Fletorja Zyrtare nr. 151/2012.
39. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", i ndryshuar. Akti.
40. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Akti.
41. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 10 221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, përfshirë ndryshimet me ligjin nr. 124/2020. Ligji ndryshues nr. 124/2020.
42. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 10 296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. *Fletorja Zyrtare*, nr. 111, 2010.
43. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 10 383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
44. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përfshirë ndryshimet me ligjet nr. 114/2012 dhe nr. 57/2016.
45. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 101, datë 4.2.2015, "Për miratimin e paketës së shërbimeve shëndetësore në kujdesin shëndetësor parësor publik, që financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor". Akti.
46. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 136, datë 7.3.2018, "Për funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror". Akti.

47. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 150, datë 20.3.2019, "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror". Akti.
48. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 152, datë 13.3.2024, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj". Akti.
49. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 195, datë 11.4.2007, "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në qendrat rezidenciale për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi". Akti.
50. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 327, datë 28.5.2014, "Për përcaktimin e formatit dhe mënyrës së mbledhjes e të raportimit të të dhënave nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor publik ose privat". Akti.
51. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 327, datë 2.6.2021, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës". Akti.
52. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 400, datë 30.6.2021, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe të planit të saj të veprimit".
53. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 430, datë 8.6.2016, "Për miratimin e standardeve të shërbimit të linjës kombëtare të këshillimit për viktimat e dhunës në familje". Akti.
54. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 505, datë 13.7.2011, "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale publike dhe jopublike". Akti.
55. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 518, datë 4.9.2018, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar". Akti.
56. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 572, datë 24.6.2015, "Për miratimin e standardeve të shërbimit në Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencës". Akti.
57. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 578, datë 3.10.2018, "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes". Akti.
58. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 597, datë 4.9.2019, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", e ndryshuar.
59. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 692, datë 26.10.2022, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe të planit të veprimit 2022–2029".
60. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 729, datë 13.12.2023, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030, të planit të saj të veprimit dhe pasaportës së treguesve". Akti.
61. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 772, datë 19.12.2025, "Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit".
62. Republika e Shqipërisë. Udhëzim nr. 8, datë 19.7.2022, "Për përcaktimin e tarifave për ofrimin e shërbimeve të përkthimit zyrtar dhe interpretimit në gjuhën e shenjave dhe rregullat për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategoritë e personave që përfitojnë ndihmë juridike".
63. Republika e Shqipërisë. Udhëzim nr. 354, datë 2.6.2022, "Për miratimin e standardeve të shërbimit të strehimit emergjent të sigurt". Akti.
64. Republika e Shqipërisë. Udhëzim nr. 744, datë 15.11.2019, "Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të kujdesit shoqëror për viktimat/të mbijetuarat

e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, në qendrat rezidenciale emergjente publike dhe jopublike (strehëzat emergjente)". Akti.
65. Republika e Shqipërisë. Udhëzim nr. 816, datë 27.11.2018, "Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale". Akti.
66. Republika e Shqipërisë. Udhëzim i përbashkët nr. 9, datë 17.6.2020, "Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre".
67. Republika e Shqipërisë. Udhëzim i përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018, "Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje".
68. Republika e Shqipërisë. Udhëzim i përbashkët nr. 912, datë 27.12.2018, "Për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme".
69. Republika e Shqipërisë. Udhëzim i përbashkët nr. 132, datë 8.9.2023, "Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit". Akti.
70. Republika e Shqipërisë. Urdhër i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 817, datë 27.11.2018, "Për ngritjen dhe funksionimin e qendrës për menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale".
71. Republika e Shqipërisë. Urdhër nr. 100, datë 21.2.2020, "Për procedurat standarde të veprimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore nga punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si pjesë e mekanizmave të koordinuar të referimit". Akti.
72. Republika e Shqipërisë. Urdhër nr. 101, datë 21.2.2020, "Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore nga profesionistët e kujdesit shëndetësor, si anëtarë të mekanizmave të koordinuar të referimit". Akti.
73. Republika e Shqipërisë. Urdhër nr. 102, datë 21.2.2020, "Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për punonjësit e kujdesit shëndetësor për uljen e riskut të përjetimit të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në situata të emergjencave civile". Akti.
74. Republika e Shqipërisë. Urdhër nr. 5398/3, datë 31.7.2025, "Për indeksimin e kuotës ushqimore për vitin 2025".
75. Këshilli Bashkiak i Tiranës. Vendim nr. 10, datë 5.2.2020, "Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit të strehimit social 'Subvencionimi i qirasë'".

**Akte për analizën e periudhave të mëparshme**

76. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, përfshirë ndryshimet me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020. Ligji bazë.
77. Republika e Shqipërisë. Ligj nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri". *Fletorja Zyrtare*, nr. 125, datë 1.8.2008. Akti.
78. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 465, datë 16.7.2012, "Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm". *Fletorja Zyrtare*, nr. 107, 2012.
79. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 499, datë 29.8.2018, "Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit". Akti.
80. Republika e Shqipërisë. VKM nr. 955, datë 7.12.2016, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike". Akti.

## Annex 1. List of Research Participants

- Ministry of Health and Social Welfare (MHSP) – Central-level institution
- State Social Service (SSS) – National supervisory and service authority
- Tirana Municipality – Social Services Directorate
- Counselling Line for Ëomen and Girls - National hotline and specialised counselling service for survivors of GBV
- Edlira Haxhiymeri Centre – Long term emergency shelter
- Kamza Shelter – Long-term emergency shelter
- Vatra Centre, Vlora – Long-term emergency shelter
- Te ndryshem dhe te barabarte - Long-term emergency shelter
- Lilium Centre - Rape crisis 182,278
- Women to Women (*Gruaja te Gruaja*) – Short-term emergency shelter
- Residential Social Care Centre, Elbasan – Short-term emergency shelter